

FGJH

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS



7 / 2023

Botohet për herë të parë në dhjetor 2019

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia_fgjh@fgjh.edu.al

www.fgjh.edu.al

©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, në bazë të ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 të shtetit shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, transmetohet apo përdoret me asnjë formë a mjet pa lejen me shkrim të botuesit. Punimet e paraqitura në këtë botim shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve. Redaksia nuk mban përgjegjësi për pikëpamjet e autorëve në shkrimet e tyre.

ISSN 2664-7346

BORDI EDITORIAL

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Dr. Saverina PASHO (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Mirela PAPA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Maks DAIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Elida TABAKU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikena KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Lindita SEJDIU-RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Prof. Enrico LUSSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

Prof. Dr. Giorgos KENTROTIS

(Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Ionian, Greqi)

Arti grafik: petanidesign

Shtypi u realizua nga: petanidesign

PËRMBAJTJA

ARTIKUJ

5

Estudio y clasificación de errores ortográficos
de aprendientes de Español en Albania

Nuria díaz rodríguez

13

Aspekte të përvetësimit të ndërgjuhës dhe ndikimet nga gjuha mëmë

Msc. Ingrit Tirana

28

“Larg turmës së çmendur”: mes romantizmit
dhe realizmit viktorian

Msc Enkelejda Malaj

43

Roli i aftësive me shkrim në gjuhën e huaj për qëllime profesionale

Msc. Megi Plaku

Dr. Albana Avrami

53

Figura e Gjergj Kastriotit në poemat e At Bernardin Palajt

Dr. Karmen Lazri

Dr. Irena Ndreu

63

Vlerësimi dhe rëndësia e metodës së rivlerësimit në procesin e
mësimdhënies së gjuhës gjermane në shkollat shqiptare

Msc. Arsilda Aliaj

82

Komunikimi si mjet mirëqenieje në kompani
rast studimi optima Albania
Msc. Sabina Sitaj

95

Challenges of the 21st century education, especially during times of a
global pandemic
Enkela Binaj

104

Rruga drejt ekspertizës: zhvillimi i aftësive
në fushën e përkthimit
Dr. Adelina Albrahimi
Prof. Assoc. Dr. Ogerta Koruti Stroka

RECENCA

117

Quels outils linguistiques et stratégies de communication pour une
valorisation du patrimoine culturel matériel et immatériel national?
Prof. Dr. Saverina Pasho

120

Shpjegim i soneteve të zgjedhura të Shekspirit
përmes analizës krahasuese përkthimore
e autorit Ukë Zenel Buçpapaj
Prof. Dr. Elida Tabaku

123

LIBRA TË RINJ SHKENCORË

124

AKTIVITETE SHKENCORE NË FGJ

ESTUDIO Y CLASIFICACIÓN DE ERRORES ORTOGRÁFICOS DE APRENDIENTES DE ESPAÑOL EN ALBANIA

Msc. Nuria Díaz Rodríguez

Departamenti i Gjuhës Spanjolle
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: nuria.rodriguez@unitir.edu.al

ABSTRACT

The present study consists of the analysis of the most frequent spelling errors in Spanish of a group of Albanian university students who study this language. The research has been carried out in the Faculty of Foreign Languages through a text task dictated by the teacher. Subsequently, the written texts have been analysed and a total of 61 errors have been identified, which have been classified according to their typology. The results reveal that the most recurring misspellings are linked to the separation and union of words, as well as to the arbitrariness due to the concurrence of graphemes. After its evaluation, it has been concluded that we must pay more attention to errors related to the spelling. Moreover, practical activities to avoid spelling confusion should be encouraged, as well as those with a communicative function. Finally, students, helped by the teacher, should understand the importance of writing correctly.

Keywords: misspelling, Spanish language, Albanian students, dictation.

1. Introducción

El término competencia comunicativa, según el Diccionario de términos clave de ELE, se define como “la capacidad de una persona para comportarse de manera eficaz y adecuada en una determinada comunidad de habla”. Dell Hymes es el primer autor que, reaccionando a la opinión de Chomsky (Cenoz Iragui, 2016), en 1972, hace referencia a este concepto considerando no solo la precisión en el uso de la gramática, sino también la adecuación al contexto social en que se produce el acto de comunicación (Martín Peris, 2008).

En los últimos años del siglo XX, otros autores como Canale y Swain, Bachman, Celce-Murcia, Dörnyei y Thurrell desarrollan también sus modelos de competencia. En el primero de ellos, se establecen como elementos de la competencia comunicativa la gramatical, la sociolingüística y la estratégica, a las que, más tarde, Canale incluye la competencia discursiva.

Por su parte, el Consejo de Europa (2001) sostiene en el Marco Común Europeo de Referencia para las lenguas (MCER) que cada una de las competencias que poseen los hablantes contribuye, en mayor o menor medida, en el proceso comunicativo. No obstante, conviene, en este caso, destacar la lingüística, la sociolingüística y la pragmática, ya que son aquellas que tienen mayor relación con la lengua en sí y han sido determinadas como constituyentes de la competencia comunicativa.

Conocer cómo se estructura una lengua y poder elaborar y entender mensajes siguiendo las normas establecidas es a lo que nos referimos cuando hablamos de competencia lingüística (Méndez Santos, 2021).

De un modo más concreto, el MCER propone la subcompetencia ortográfica como una de las constituyentes de la lingüística, junto con la léxica, la gramatical o la fonológica, entre otras; y se refiere a ella como la capacidad de conocer, percibir y producir los símbolos integrados en textos escritos (Consejo de Europa, 2002).

Si ponemos el foco de atención en los contenidos ortográficos, el dictado ha sido siempre una de las tareas más productivas en el aula, especialmente para el reconocimiento de errores en la escritura. Igualmente, el dictado ayuda al estudiante a desarrollar la comprensión oral. Cassany (2004) menciona diferentes tipos de dictado. Entre ellos se encuentran el tradicional, el colectivo, el telegráfico, el de dibujos o el que se realiza en parejas.

Considerando el trabajo de Sánchez Jiménez (2010) realizado en el Instituto Cervantes de Manila y en la Universidad de Filipinas, es posible clasificar los errores en tres grupos principales:

- Ortografía de la letra o grafemática:
 - Errores en el origen debido a la gramática o por interferencia;
 - Errores contra el sistema, concretamente contra la fonética natural vocálica o consonántica, en el uso de grafías complementarias, grafías castellanicas con valores fonéticos de otras lenguas o grafías que no corresponden a la lengua española.
 - El tercer subgrupo se refiere a los errores por arbitrariedad en el uso de la h o por concentración de grafemas.
 - Y, por último, el cuarto comprende los errores por desatención.

- Ortografía de la palabra o lexicológica: errores en siglas y abreviaturas, acentuación, signos diacríticos, separación y unión de palabras, uso de minúsculas y mayúsculas.
- Ortografía de la frase o sintagmática: en este grupo encontramos los errores relacionados con signos de puntuación, de entonación y signos auxiliares.

Con el fin de realizar un análisis exhaustivo y detectar las necesidades de manera precisa, debemos tener en cuenta las características de los sistemas ortográficos que nos atañen. En nuestro caso, el alfabeto albanés consta de 36 grafemas, de los cuales 29 son consonantes y 7 vocales (Hoxhallari, Van Daal & Ellis, 2004) y siempre hay correlación entre sonido y grafía (Beci & Bruçi, 2011). En contraste, el alfabeto español lo forman 27 grafemas; 22 consonantes y 5 vocales. En ambas lenguas podemos encontrar dígrafos; nueve en albanés (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh) y cinco en español (ch, ll, gu, qu, rr).

2. Objetivos

- Identificar faltas de ortografía en la transcripción de un texto oral en lengua española.
- Llevar a cabo una clasificación tipológica de estos errores con el fin de facilitar al docente la determinación de necesidades del alumnado en cuanto al desarrollo de la competencia ortográfica.
- Fomentar la práctica del dictado en el aula de español.
- Aprovechar la corrección de errores como método de reflexión.

3. Materiales y métodos

En el estudio participaron 18 estudiantes albaneses que cursaban el 2º año de Grado en Lengua, Literatura y Civilización Hispánicas en la Facultad de Lenguas Extranjeras de la Universidad de Tirana. Todos ellos, por tanto, habían cursado al menos 240 horas de lengua práctica en su primer año de universidad, además de 160 horas correspondientes a las asignaturas de Introducción a la Lingüística, Sintaxis, Morfología y Fonética. Un aspecto a tener en cuenta en la presente investigación es que todos los participantes estudiaban inglés, italiano o turco paralelamente al español.

Para llevar a cabo la investigación, se seleccionó un texto breve acorde al nivel lingüístico del grupo de alumnos y se siguieron los pasos

propuestos por Cassany (2004). Antes de comenzar a dictar el texto, se preguntó a los estudiantes sobre las excursiones que ellos hacen al campo (dónde, con qué frecuencia, con quién, etc.). De esta manera, se facilitó la comprensión del vocabulario.

A continuación, la profesora leyó el texto completo, sin pausas. El alumnado durante este proceso se dedicó solamente a escuchar. Después, se dictó cada uno de los sintagmas a un ritmo normal y tantas veces como fueron necesarias. Al finalizar, se volvió a leer el texto completo.

Por último, se recopilaron las tareas de todos los participantes y se comentaron en grupo las dificultades ortográficas que habían experimentado en mayor medida. Posteriormente se escribió el dictado (texto a continuación) en la pizarra.

Una bonita caminata

Hoy hemos salido al campo. Quisimos llegar a un lago que estaba bastante lejos. Al principio íbamos deprisa, pero enseguida aminoramos la marcha. Yo casi estaba a punto de rendirme, y Marta también, pero no lo hicimos. Quizá nos mantuvo la ilusión de bañarnos.

La identificación de errores individual se llevó a cabo corrigiendo cada uno de los textos por la profesora y anotándolos para su posterior análisis.

4. Resultados y discusión

Tras el análisis de la tarea realizada por los participantes, se obtienen los resultados presentados en las tablas 1 y 2. En las primeras filas de ambas tablas aparecen los números de los participantes, mientras que en las primeras columnas se han indicado las palabras del texto dictado escritas correctamente en las que los estudiantes han cometido errores. 61 errores en total. Debajo de cada número de participante se puede observar las faltas ortográficas extraídas. Los datos se exponen de esta forma debido a la falta de espacio.

ESTUDIO Y CLASIFICACIÓN DE ERRORES ORTOGRÁFICOS

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
caminata						caminada	caminada		
quisimos	quicimos								
estaba				estava					
lejos									
íbamos			ivamos					ivamos	
deprisa	de prisa	de prisa	de prisa	lepisa	de prisa			de prisa	de prisa
enseguida	en següda							enserida	
aminoramos		abinoramos							
marcha				marancha					
a punto		apunto							
hicimos		icimos							
mantuvo	mantubo						mantubo		
ilusión									
bañamos									

Tabla 1

	10	11	12	13	14	15	16	17	18
caminata		caminada		caminada		caminada	caminada		
quisimos	cisimos		quizimos		quizimos		quizimos		
estaba									
lejos			lehos						
íbamos			y vamos						
deprisa	de prisa	de prisa		de prisa	de prisa	de prisa	deprica	de prisa	de prisa
enseguida		enserida	enserrida	enserida	enserida	enserida	enserida		
aminoramos									
marcha			marca						
a punto	apunto								
hicimos	isimos				icimos				
mantuvo	mantubo	mantubo		mantubo	mantubo	mantubo	mantubo		
ilusión	iluzion	iluzion		iluzion	iluzion	iluzion			
bañamos	baniamos								

Tabla 2

Del mismo modo, se ha considerado necesario incluir el siguiente gráfico con el fin de facilitar la comprensión del análisis de datos de manera visual. En él se indica el porcentaje y número de errores que se han identificado en cada uno de los términos. Las palabras *deprisa*, *mantuvo*, *enseguida* y *caminata* son las que han provocado mayor confusión con 15, 8, 8 y 6 faltas respectivamente.

Las equivocaciones en los términos *deprisa* sospechamos que pueden ser debidas a la confusión con la preposición *de*. Por otra parte, la alternancia de b y v en español es muy común debido a la pronunciación idéntica de ambos grafemas. En albanés sí que existen diferencias fonéticas entre ambas. El fonema de la letra b en albanés es como en español b y v. Sin embargo, el fonema /v/ en albanés se clasifica como fricativo. En la palabra *mantuvo* en nuestro análisis es un ejemplo de este tipo de error.



Teniendo en cuenta la clasificación de errores¹ que se ha mostrado en el apartado anterior, podemos decir que, en cuanto a la tipología grafemática, en el presente estudio se ha encontrado seis veces un error en el origen *-*caminada (caminata)-* causado por la gramática. Probablemente provenga del participio *caminado*. Sin embargo, no se ha extraído ninguno provocado por interferencias.

1 Tipología de errores aportada por Sánchez Jiménez (2010).

Por otro lado, errores como *abinoramos (aminoramos) y *enserida (enseguida o en seguida) han sido clasificados como aquellos contra la fonética natural consonántica. Cabe destacar la recurrencia de *enserida.

Se ha detectado asimismo el uso de grafías complementarias en *baniarnos (bañarnos), probablemente por la no consolidación del grafema ñ. No obstante, no existen errores por grafías impropias del castellano.

*Lehos (lejos), identificado en un único caso, es un error por uso de grafías castellanas con valores fonéticos ajenos. El grafema h en albanés se aspira y puede causar confusión con el fonema /x/ en español.

Atendiendo a los errores por arbitrariedad, se han registrado del tipo:

- Arbitrariedad por concurrencia de grafemas: 1 caso de *quicimos (quisimos), 3 casos de *quizimos (quisimos), 1 caso de *cisimos (quisimos), 1 caso de *estava (estaba), 1 caso de *ivamos (íbamos), 8 casos de *mantubo (mantuvo) y 5 casos de *iluzion (ilusión).

Tanto en *ilusión* como en *quisimos* observamos que existe confusión en la transcripción del fonema /s/, ya que es representado con la grafía z.

*Marancha (marcha) puede ser señalado como un error por desatención.

Respecto a la ortografía lexicológica o de la palabra cabe destacar que no se han tenido en cuenta los errores de acentuación, ya que se dedicará a ellos otro estudio en el futuro.

No se han percibido faltas en el uso de mayúsculas y minúsculas. No obstante, los errores de unión y separación de palabras, en concreto *de prisa (deprisa), han sido los más frecuentes. Otros que pertenecen a este grupo son: y vamos (íbamos) y apunto (a punto).

Por último, señalamos un único error en cuanto a signos diacríticos: *en següda (enseguida o en seguida).

5. Conclusiones

Los resultados obtenidos nos hacen pensar que el dictado puede convertirse en una actividad muy eficiente para que la corrección sirva como un instrumento de aprendizaje lingüístico y de reflexión crítica sobre los errores cometidos.

Percibimos, además, que es fundamental la corrección de manera personal, ya que cada estudiante presenta unas necesidades propias. En nuestro caso, consideramos relevante hacer hincapié en las normas ortográficas relativas a los grafemas b y v, así como a la transcripción de palabras que contienen los fonemas /s/ o /θ/. Es decir, prestar especial atención a los errores de tipología grafemática.

Como ya hemos mencionado, es necesario fomentar practicas ortográficas, pero que al mismo tiempo sean comunicativas y que permitan al estudiante percatarse de la importancia de la corrección lingüística para alcanzar un nivel competente de la lengua.

BIBLIOGRAFÍA

- BECCI B. & BRUCI M. (2011), «TË MËSOJMË SHPEJT GJUHËN SHQIPE. METODË PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NGA TË HUAJT», EDFA, TIRANA.
- CANALE M. (1983), «DE LA COMPETENCIA COMUNICATIVA a LA PEDAGOGÍA COMUNICATIVA DEL LENGUAJE». EN LLOBERA ET AL. (1995). COMPETENCIA COMUNICATIVA. DOCUMENTOS BÁSICOS EN LA ENSEÑANZA DE LENGUAS EXTRANJERAS, F. 63-83, EDELSA, MADRID.
- CASSANY D. (2004), EL DICTADO COMO TAREA COMUNICATIVA, NË «TABULA RASA: REVISTA DE HUMANIDADES DE LA UNIVERSIDAD COLEGIO MAYOR DE CUNDINAMARCA», N. 2, F. 229-250.
- CENOZ IRAGUI J. (2016), EL CONCEPTO DE COMPETENCIA COMUNICATIVA, NË «VADÉMÉCUM PARA LA FORMACIÓN DE PROFESORES. ENSEÑAR ESPAÑOL COMO L2/LE», F. 449-465, SGEL.
- CONSEJO DE EUROPA, (2002), MARCO COMÚN EUROPEO DE REFERENCIA PARA LAS LENGUAS: APRENDIZAJE, ENSEÑANZA, EVALUACIÓN, MECD Y ANAYA, MADRID.
- HOXHALARI L., VAN DAAU V. H. P. & ELLIS N. C. (2004), LEARNING TO READ WORDS IN ALBANIAN: A SKILL EASILY ACQUIRED, NË «SCIENTIFIC STUDIES OF READING», N. 8, 2, F. 153-166.
- LACORTE M. & REYES-TORRES, A. (2021), DIDÁCTICA DEL ESPAÑOL COMO 2/L EN EL SIGLO XXI, ARCO/LIBROS, MADRID.
- MARTÍN PERÍS E. ET AL. (2008), DICCIONARIO DE TÉRMINOS CLAVE DE ELE, SGEL, MADRID.
- MÉNDEZ M. C. (2021), 101 PREGUNTAS PARA SER PROFE DE ELE. INTRODUCCIÓN A LA LINGÜÍSTICA APLICADA PARA LA ENSEÑANZA DEL ESPAÑOL. EDINUMEN.
- MOLINA GARCÍA, A. (2019), PERCEPCIÓN Y DISTANCIA ACÚSTICA: LA VARIACIÓN PARAMÉTRICA INDIVIDUAL EN LA ESCISIÓN FONEMÁTICA DE /θ/ EN EL ESPAÑOL ANDALUZ. DATOS DE LA CIUDAD DE MÁLAGA, NË «ELUA», N. 33, F. 111-140.
- REAL ACADEMIA ESPAÑOLA (2002), ORTOGRAFÍA DE LA LENGUA ESPAÑOLA, ESPAÑA, MADRID.
- SÁNCHEZ JIMÉNEZ D. (2010), EL ANÁLISIS DE ERRORES ORTOGRÁFICOS DE ESTUDIANTES FILIPINOS EN EL APRENDIZAJE DEL ESPAÑOL COMO LE Y SU APLICACIÓN DIDÁCTICA, NË «I CONGRESO DE ESPAÑOL COMO LENGUA EXTRANJERA EN ASIA-PACÍFICO (CE/LEAP)», CUNY NEW YORK CITY COLLEGE OF TECHNOLOGY.
- TORIJANO PÉREZ J. A. (2002), ANÁLISIS TEÓRICO PRÁCTICO DE LOS ERRORES GRAMÁTICALES EN EL APRENDIZAJE DEL ESPAÑOL, L-2: EXPRESIÓN ESCRITA (TESIS DOCTORAL), UNIVERSIDAD DE SALAMANCA, SALAMANCA.

ASPEKTE TË PËRVETËSIMIT TË NDËRGJUHËS DHE NDIKIMET NGA GJUHA MËMË

Msc. Ingrit Tirana

Departamenti i Romanistikës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja,
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
E-mail :imgrittirana@unishk.edu.al

PËRMBLEDHJE

Gjatë procesit të përvetësimit të një gjuhe të huaj është i pashmangshëm ndikimi që ushtron gjuha amtare. Për mësimdhënësit kjo përbën një sfidë më vete, e cila kërkon kujdesin e duhur për t'u trajtuar. Gjithashtu, ndikime të tilla duhen parë në aspektin pozitiv, pasi shërbejnë si tregues dhe na bëjnë të qartë nevojën për t'i ardhur në ndihmë nxënësit gjatë procesit të gjuhënxënies.

Pikërisht, nën vazhden e procesit të ndërtimit dhe zhvillimit dhe të ndërgjuhës, gjurmimi i tipologjisë së gabimeve dhe kategorizimi i tyre përbën një fushë të rëndësishme studimi, si dhe ofron një gamë të gjerë reflektimesh teorike e praktike mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës së huaj. Në rastin konkret po shqyrtojmë mënyrën e përfimit në gjuhën italiane. Ky punim sjell në vëmendje jo vetëm rastet e interferencave gjuhësore dhe rolin e *transferit* gjuhësor në përvetësimin e gjuhës, por edhe aspekte teorike të saj.

Fjalët çelës: përvetësimi i gjuhës, gjuhësi e zbatuar, gabime gjuhësore, interferenca gjuhësore, gjuha mëmë, Gj1/Gj2/L1/ L2.

ABSTRACT

During the process of acquiring a foreign language, the influence exerted by the native language is inevitable. For teachers, this constitutes a challenge, which requires to be carefully handled. Also, such influences should be seen in a positive aspect, as they serve as indicators and make it clear to us the need to help pupils during the language learning process.

Precisely, even during the process of construction and development the interlanguage, tracking the typology of errors and their categorization constitutes an important field of study, as well as offers a wide range of theoretical and practical reflections on teaching and learning a foreign language. In this case, we are considering the method of obtaining it in the Italian language. This paper brings to attention not only cases of linguistic interference and the role of linguistic transfer in language acquisition, but also its theoretical aspects.

Key words: language acquisition, applied linguistics, linguistic errors, linguistic interferences, native language, L1/L2/L1/L2.

1. Objektivi dhe metodologjia e punimit

Dukuria e interferencës shfaqet që në hapat e parë të përvetësimit të gjuhës së huaj, sidomos në rastet kur dy sisteme gjuhësore paraqesin karakteristika tipologjike të ndryshme. Atëherë, folësi shfaq tendencën për të transferuar fjalë apo ndërtime gjuhësore nga njëra gjuhë në tjetrën. Ajo çfarë e bën akoma edhe më të vështirë procesin e të nxënës të gjuhës së huaj është fakti i të mësuarit të shumë gjuhëve, të cilat sjellin në mënyrë të pashmangshme ndikimin e tyre në përvetësimin gjuhësor. Njohja e një gjuhe të huaj ndikon në nxënien e një gjuhë tjetër të huaj pasardhëse, me anë të së cilës nxënësi vepron duke i krahasuar dhe asimiluar rregullat e mësuara në një sistem tjetër gjuhësor.

Duke u nisur nga këto vëzhgime, është interesante të kuptojmë se si nxënësi kërkon të vlerësojë të njëjtat rregulla gjuhësore në gjuhën tjetër dhe në rastet kur kemi interferenca mes gjuhëve të huaja të tjera të studiuara, në ç'mënyrë mbivendosin rregullat dhe si ndikojnë mbi njëra-tjetrën.

Objekt i këtij studimi është klasifikimi dhe analiza e tipologjive të gabimeve të bëra në aspektin gjuhësor (morfosintaksor dhe semantik) nga nxënësit e klasave të gjashta dhe të shtata, në ciklit e arsimit të mesëm të ulët. Si korpus studimor do të shërbejnë materialet shkrimore të këtyre klasave, tetë dokumente në total. Përmes metodës së vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave nga materialet shkrimore, do të interpretojmë dhe klasifikojmë tipologjitë e gabimeve gjuhësore.

2. Çfarë kuptojmë me termin “ndërgjuhë”.

Ky studim merr në shqyrtim tipologjinë e gabimeve apo të interferencave gjuhësore gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj. Interferencat përbëjnë një objekt studimi shumë të rëndësishëm në fushën e didaktikës që merret me përvetësimin e gjuhëve.

Studimet e para të kësaj natyre fillojnë që në vitin 1967 dhe klasifikohen si studime që kanë në përmbajtje analizimin e gabimeve. Ishte Pit Corder, me artikullin e tij *The singificance of learner's errors*, që u bë pikënisje e një perspektive të re studimi. Sipas tij, “të bësh gabime është një mënyrë për të vënë në provë supozimet e tua mbi natyrën e gjuhës që po mëson” (cit.Pallotti, 2014).¹

1. Vepër.cit, Pallotti G, (2014), “*La seconda lingua*”, Strumenti Bompiani, fq 10, kapitulli I. (Ebook)

Corder (1997), i cituar nga Pallotti, thekson faktin se “gabimet” duhen patjetër të sqarohen dhe të parashikohen dhe jo thjesht të vendosen si krahasim i dy sistemeve gjuhësore. Nga ana tjetër ai nuk e mohon faktin se disa gabime shkaktohen si pasojë e interferencës nga gjuha amtare². Vetë Corder (Corder, 1981 në *Error in analisis and interlanguage*) nënvizonte se tri ishin natyrat e gabimeve të kryera:

1. “gabime transferimi”
2. “gabime analogjie”
3. “gabime të shkaktuara gjatë mësimi”

Përkufizimin e “ndërgjuhës” si koncept teorik më pas e sjell Selinker, sipas të cilit, ndërgjuha është një sistem që ka dy baza, gramatikën universale, gjuhën mëmë, si dhe gjuhën që po mëson. Sipas tij “ndërgjuha” ka strukturë të sajën, mekanizmat e së cilës lejojnë komunikimin sa më efikas pavarësisht gabimeve që prodhohen gjatë përvetësimit të gjuhës së huaj (Selinker 1972).³

Po ashtu, edhe G. Freddi risjell pak a shumë të njëjtin koncept të Corder, ku sipas tij:

[Ndërgjuha do të ishte në fakt një sistem gjuhësor i përkohshëm, një lloj gramatike operacionale, të cilën nxënësi e ndërton për të kuptuar, manipuluar dhe organizuar format e reja gjuhësore, si në kahun përceptues edhe atë produktiv. Ajo është e ndërtuar me lëndë dhe rregulla të gjuhës mëmë dhe me elemente të gjuhës tjetër përbri].⁴

Kur flasim për përvetësim të “gjuhës së dytë” (Gj2/L2), kemi parasysh çdo gjuhë që mësohet pas gjuhës amtare. Ky term shpesh ngatërrohet me gjuhën e huaj: me termin “Gj2/L2” kuptojmë atë gjuhë të mësuar në vendin ku ajo flitet zakonisht, ndërsa me gjuhë të huaj kuptojmë atë gjuhë të mësuar në kontekste shkollore, në një vend ku nuk flitet (Pallotti 2014).⁵

Në kuadër të këtyre studimeve mbi përvetësimin e gjuhëve të huaja si

Po aty.

2

3. Selinker, (1972), *Interlanguage* (përkth.it Matarese Perazzo, 1983), f. 214.

4. Freddi G, (1995), *Glottodidattica, fondamenti, metodi e tecniche*, Torino, UTET, f.55.

5. Pallotti G, (2014), *La seconda lingua*, Strumenti Bompiani, Milano, Kap 1.1.2, f.3. (ebook)

gjuhë e parë apo e dytë, flitet shpesh edhe për përvetësimin e gjuhëve në mjedisë mësimore, si dhe në ambiente të ashtuquajtura “natyrore”. Në rastin e parë kemi të bëjmë me të nxënit e gjuhës së huaj drejtuar nga vetë mësuesi brenda një strukture të posaçme për këtë lloj veprimtarie. E kemi fjalën për mësimin e një gjuhe në institucione shkollore dhe këtu i referohemi didaktikës së përfimit të gjuhëve (Vedovelli, 2002; *Didattica acquisizionale*).⁶

Në rastin e dytë kemi të bëjmë me të nxënit e gjuhës në mënyrë spontane ose natyrore, kjo mund të ndodhë nëpërmjet ndërveprimit bisedor me një folës të lindur të asaj gjuhe; falë kontaktit të vazhdueshëm me gjuhën; duke luajtur; duke punuar në një vend të huaj; duke qenë në të shumtën e kohës në kontakt me kanale audio-vizive, siç janë televizioni, mediat e tjera elektronike dhe rrjetet sociale. Këtij rasti i referohemi pikërisht kur gjuha e huaj përftohet në mënyrë krejtësisht natyrore, pa mund e sforcime (Pallotti, 2014; Krashen 1980)⁷.

Me studime të këtij lloji merret Gjuhësia e përvetësimit⁸ duke dhënë një kontribut të madh sidomos nga perspektiva e gjuhës së dytë (GJ2/L2), por duke lënë mënjanë gjuhën e huaj (LS).

Vetë Paolo Balboni thekson faktin që studimet të këtij lloji janë shumë të rëndësishme dhe duhet të shihen nga perspektiva e gjuhës së huaj. Ai shprehet se:

[...është pikërisht tek gjuha e huaj që kontributi i gjuhësisë së përvetësimit mund të jetë më i rëndësishëm dhe i nevojshëm ...për të provuar në mënyrë eksperimentale vlefshmërinë e ndërtimit të gjuhës së ndërmjetme dhe është befasues fakti që ky sektor ka mbetur ende i huaj dhe i paeksploruar.]⁹

6. Vepër.cit, Vedovelli, M, (2003), *Verso l'italiano. Percorsi e strategie di acquisizione*, Roma, Carocci, 2003, fq. 270-304.

7. Pallotti G, (2014), *La seconda lingua*, Strumenti Bompiani, Milano, Kap 6, f. 1-4. (ebook)

8. Gjuhësia që merret me përvetësimin e gjuhëve (Linguistica Acquisizionale ose *SLA research*): nënkupton atë sektor të gjuhësisë që merret me proceset që i lejojnë një folësi që të përftojë kompetencat e një gjuhe tjetër të ndryshme nga ajo e gjuhës mëmë. Zakonisht ajo merret me përfitim të gjuhëve në mënyrë spontane dhe jo të drejtuar, por vitet e fundit po i kushtojnë vëmendje rëndësishme dhe mënyrës së përfimit të gjuhës si gjuhë e huaj. Më saktë është një fushë e gjuhësisë së aplikuar që studion jo përfitim të gjuhës mëmë, por bazohet në studime mbi përfitim të gjuhës së dytë. Si një disiplinë e re, ajo studion jo vetëm faktorët gjuhësorë, por edhe ato jashtëgjuhësorë (cit.Chini 2005).

9. Balboni.P, (2008), *Linguistica acquisizionale e glottodidattica*, GRASSI R., BOZZONE

Duke i qëndruar të njejtit mendim, edhe Gracci pohon se natyra e këtyre studimeve dhe raporti mes tyre ndihmon për të verifikuar ato hipoteza dhe studime në lidhje me gjuhësinë e zbatuar dhe përvetësimin e gjuhëve të huaja nëpërmjet glotodidaktikës.

Duke cituar Ramat, ajo sqaron një element të rëndësishëm që duhet marrë si faktor kyç: bëhet fjalë për “kohën” që duhet për të përfutur një gjuhë të huaj. Kjo gjë i ndihmon mësuesit të identifikojnë vështirësitë që hasin nxënësit apo të identifikojnë interferencat e mundshme nga gjuha mëmë, duke hartuar materiale të posaçme për t’i përmirësuar “gabimet” që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme.¹⁰

Mëdyshja që në të shumtën e rasteve vihet në qendër të diskutimeve apo debateve të vazhdueshme mbi përmirësimin e cilësisë së metodave të mësimdhënies apo qasjeve të duhura, është, nëse dukuria e të nxëniet në shkollë mbetet apo jo një mjedis artificial i përfutimit gjuhësor, apo duhet akoma edhe më shumë, *-pra të krijojmë situata të të nxëniet sa më autentike dhe reale, në mënyrë që të arrijmë të zhvillojmë tek nxënësi kompetenca dhe aftësi gjuhësore sa më të mira.*

Një nga pyetjet që shumë studiues të kësaj fushe shtrojnë është: *“A mundet shkolla të krijojë kontekstin e duhur social për të zhvilluar kompetencat dhe aftësitë gjuhësore tek çdo nxënësi?”*¹¹

Sipas Pallotti-t, edhe pse mes këtyre dy llojeve të procesit të gjuhënxënies ekzistojnë diferenca të rëndësishme, të dyja karakterizohen thelbësisht nga procese të përbashkëta. Shkolla mbetet një kontekst i përdorimit të gjuhës me karakteristika të veçanta, por nxënësit, pak a shumë të drejtuar, mbeten të gjithë qenie njerëzore me karakteristika të përbashkëta.¹²

Prandaj si të mësuarit pasiv të një gjuhe, ashtu edhe të nxëniet e gjuhës me rregullat bazë të një procesi të orientuar dhe të programuar, plotësojnë njëra-tjetrën. Përse themi kështu? Edhe pse gjatë gjithë orës së mësimit mundohemi t’i japim përparësi qasjes së komunikimit, dhe bëjmë sikur

COSTA R., GHEZZI C. në *Dagli studi sulle sequenze di acquisizione alla classe di italiano L2*, Perugia, Guerra, f. 12-13.

10. Sandra Gracci, (2004), *Linguistica acquisizionale e glottodidattica*, në *Italiano LS nel Mondo: L’Italiano da Pietroburgo ai Balcani*, viti IV, nr.13, f. 15-16.

11. Ramat G & Vedovelli M, (1994), *Italiano lingua secondall’lingua straniera*, Atti del XXVI congresso della Società Linguistica Italiana, 5-7 novembre 1992, Bulzoni, Roma.

12. Pallotti G, (2014), *La seconda lingua*, Strumenti Bompiani, Milano, f.60-64.

shmangim pjesët e gramatikës, lexojmë pjesë të ndryshme, diskutojmë, zgjidhim ushtrime që në fund të fundit kanë si qëllim përvetësimin e gjuhës me të gjitha elementet e saj. Nga ana tjetër, një folës shumë i mirë i gjuhës italiane, arrin të përdorë dhe të komunikojë, pa patur nevojë të mësojë rregullat e gramatikës në mënyrë eksplicite.

Nxënësi, gjatë procesit të ndërtimit të ndërgjuhës në gjuhën mbërritëse, krijon kodin e tij gjuhësor të thjeshtëzuar, duke përdorur mekanizmat gramatikore të gjuhës amtare.

Në këtë punim do të analizojmë tipologjitë e gabimeve nga materiale të shkruara të nxënësve që i përkasin grupmoshave nga 10-12 vjeç, përkatësisht klasat e gjashta dhe të shtata të shkollave 9-vjeçare publike "Ismail Qemali" e "Ndre Mjeda", ku studiohet si gjuhë e huaj e parë gjuha italiane.

Nga një pyetësor i bërë paraprakisht, rezulton se 78% e nxënësve kanë mësuar paralelisht gjuhën angleze në kurse dhe aktualisht e kanë në programin mësimor si gjuhë të dytë të huaj. Nga këto të dhëna, kuptojmë arsyen përse nxënësit, pavarësisht ndikimit të gjuhës amtare, kanë ndikim edhe nga gjuha angleze. Ky ndikim nuk vjen thjesht si pasojë e të mësuarit të gjuhës, por sepse tashmë është gjuha angleze ajo mbizotëruese dhe siç pohon Balboni, ne po shkojmë tashmë drejt monolingvizmit gjuhësor¹³. Shembuj tipik janë: *"Io ho una blue matita"*; *"la rossa macchina è bella"*; *"ho un part- time lavoro"*, etj.

Tendenca për të përdorur mbiemrin përpara emrit nuk vjen nga gjuha shqipe, por nga anglishtja. Sigurisht që kjo është një dukuri e pranishme për të gjitha ata që mësojnë një gjuhë tjetër të huaj dhe që në hapat e parë ngatërrohen lehtësisht, mirëpo, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se fëmijët e kësaj grupmoshe, tashmë, janë të "sulmuar" nga të gjitha anët me informacione, lajme, muzikë, filma, lexime në gjuhën angleze. Globalizimi dhe digjitalizimi i kanë sjellë tashmë pasojat e tyre.

Duke u gjendur në këtë situatë, mësimi i gjuhës italiane përbën një sfidë. Nga eksperiencia jonë si mësimdhënës apo si studiues, jemi të ndërgjegjshëm që kontakti gjuhësor me italishten është bërë më i rrallë. Këtu nuk po ndalemi tek statistikat apo tek numri i nxënësve të gjuhës italiane në sistemin tonë arsimor, por po ndalemi në një reflektim të

13. Vepër.cit. Mezzadri M, (2016) *Le politiche linguistiche europee: tra continuità e cambiamento*, në Studi sull'apprendimento e l'insegnamento linguistico, Edizioni Ca'Foscari, Venezia, f. 12.

domosdoshëm për të kuptuar se çfarë duhet të përmirësojmë dhe çfarë strategjish duhen ndërtuar për të arritur në një përvetësim sa më të mirë dhe më të shpejtë të gjuhës. Në gjendjen e sotme, gjuha italiane e mësuar në ambientet shkollore mbetet në kornizat e dikurshme dhe mungon kontakti më gjuhën përmes kanaleve të tjera alternative të cilat mund të jenë vetëm sporadike.

Përgjithësisht thuhet se sa më i madh të jetë ndryshimi në mes gjuhëve, aq më i vështirë bëhet të mësuarit e tyre dhe aq më i fortë është ndikimi i interferencave. Ky koncept ka edhe këndvështrime të tjera. Nicola Grandi, profesor i gjuhësisë, shprehet se jo gjithmonë është e vështirë të mësohet një gjuhë që është e ndryshme nga të tjerat. Përkundrazi, shprehet ai: *“ka raste që, edhe pse në mënyrë paradoksale, mund të jenë ngjashmëritë që mund të përbëjë në vështirësi.”*¹⁴

Grandi sqaron faktin se jo gjithmonë, të mësuarit të një gjuhe arrihet lehtësisht, kur gjuhët kanë ngjashmëri apo i përkasin të njëjtës pemë gjenealogjike, sepse sipas tij, krijohen gabime interferencash të ngurtësuar të cilat janë shumë të vështira për t’u rralluar dhe mbeten të ngulitura në kujtesën e nxënësit. Ai shton se kur dy sisteme gjuhësore, edhe pse janë të ndryshme, në fillim paraqesin vështirësi, por më pas, me kalimin e kohës dhe me një studim të mirëfilltë, pasiguritë e mundshme dhe interferencat kanë tendencë që të zhduken.¹⁵

Sipas tij, gabimet e transferimit janë ato më të shpeshta, të cilat mund të përbëjnë një faktor shqetësues, pasi, gabime të këtij lloji mbeten të ngulitura në gjuhën e ndërmjetme, gjë që ngadalëson procesin e të nxënit.

Po ashtu, ai sqaron:

[... duket normale që, pasi të jenë përvetësuar kategoritë e duhura të njohurive, të jetë më i lehtë mësimi i përdorimit të strategjive gjuhësore që parashikojnë përdorimin e parimeve organizuese jo shumë të largëta nga Gj1 vetjake.]¹⁶

Duhet të marrim në konsideratë që ky fenomen ndodh edhe në komunikim, jo vetëm në përdorimin e drejtë të gjuhës.

14. Grandi N, (2020), *La classe plurilingue*, Bononia University Press, fq 15.

15. Po aty.

16. Grandi N, (2019), *Ti je gjuha që flet. Baza të tipologjisë gjuhësore*, botimet Çabej, f.148.

[Dukuria e interferencës shfaqet që në fazat e para të përvetësimit kur nxënësi nuk arrin të gjejë fjalën e duhur në gjuhën e huaj. Për të dalë nga situata ai përdor elemente të gjuhës së tij amtare, çka nuk e pengon komunikimin, por nganjëherë mund të krijojë probleme në të kuptuarin e mesazhit që dy bashkëbiseduesit përcjellin.]¹⁷

Mirëpo, nuk duhet të mendojmë që gabimet e transferimit të shihen si një dukuri negative. Gjuha mëmë luan në fakt një rol të rëndësishëm në mësimnxënien e gjuhës së dytë. (Pallotti, 2014; Selinker, 1972, f.172; Bartlet, 1997). Sipas Pallotti-t, gjuha mëmë lehtëson formimin e ndërghjuhës, në rastet kur nxënësi bën krahasime dhe gjen korrespondenca mes dy gjuhëve. Këto identifikime gjuhësore i përdor si strategji bazë për të ndërtuar sistemin gjuhësor të gjuhës së dytë (Pallotti, f. 47). Sipas tij, tre janë faktorët që shkaktojnë interferencat: konteksti gjuhësor, social dhe tipologjia e ushtrimit.¹⁸

Sigurisht, me kalimin e kohës, interferencat gjuhësore rrallohen, sidomos pas një studimi të thelluar të gjuhës, por ajo çka na intereson në këtë studim është të shohim dhe të studiojmë tipologjinë e gabimeve përgjatë këtij procesi, gjë që na ndihmon të reflektojmë mbi natyrën e gabimit. Çfarë mund të bëjmë për të përmirësuar arritjet tek nxënësit? Si të identifikojmë vështirësitë që hasin me shpesh dhe çfarë duhet të konsiderojmë “gabim”?

Disa studiues e konceptojnë krejt ndryshe “gabimin” në aspektin didaktik. Balboni shprehet se “gabimi” duhet të trajtohet si një dukuri normale. Le të marrim një shembull tipik që hasim shpesh në hapat e parë të të mësuarit të gjuhës italiane: një nxënës kur përdor foljen *andare* në kohën e tashme të mënyrës dëftore dhe shkruan ose thotë *io ando*, nuk mund të konsiderohet një gabim, pasi ai ka dëshmuar se e njeh rregullin e zgjedhimit të grupit të parë të foljeve dhe mbaresat përkatëse përpiket t’i zbatojë saktësisht. Nuk është faji i tij që sistemi foljor në gjuhën italiane paraqet parregullsi. Gabime gjuhësore në përvetësimin e gramatikës së gjuhës së huaj vihen re edhe tek folje të tjera si p.sh : *Io capo- capisco; io prefero- preferisco*.

17. Nenshtati A, (2012), *Interferencat gjuhësore dhe ndikimi i tyre në aftësinë komunikuese në gjuhë të huaj*, Aktet e Konferencës Ndërkombëtare Shkencore: *Sfida dhe Perspektiva të Mësimdhënies së gjuhës së huaj*, Univesiteti i Shkodrës, f. 85.

18. Pallotti G, (2014), *La seconda lingua*, Strumenti Bompiani, Kap I. f. 10, 47, 58-94.

2. Raste të interferencave

Ndër gabimet që hasim shpesh dhe që vijnë si rrjedhojë e interferencës së jashtme apo të brendshme, janë në nivel morfologjik dhe leksikor.¹⁹

Siç përmendëm edhe më parë, disa shembuj të interferencave janë nxjerrë nga materialet e shkruara të nxënësve që studiojnë gjuhën italiane si gjuhë të huaj të parë. Nga rezultatet e arritura, vihet re ndikimi i gjuhës amtare në nxënien e gjuhës italiane dhe jo vetëm, por edhe prania e interferencave të ndryshme nga gjuha angleze. Bëhet fjalë më shumë për transfertat negative (*negative transfers*) të cilat ndikojnë në përvetësimin korrekt të strukturave gjuhësore duke vështirësuar mësimin e gjuhës së huaj. Përsa i përket rasteve të interferencave, vlen të përmendim edhe gjuhëtarin tonë të mirënjohur, Ledi Shamku:

[...një nxënës mes moshës 6 deri në 12 vjeç, që ka mësuar të shprehet plotësisht në gjuhën e tij (Gj1) dhe po fillon të mësojë një gjuhë të dytë (Gj2), për t'iu afruar asaj do të përdorë ato që di nga sistemi gjuhësor i gjuhës së parë (Gj1). Duke qenë se çdo gjuhë ka karakteristika specifike, fëmija ndonjëherë do të “gabojë”, pasi do të tentojë, do të themi, të hapë dyert e gjuhës së dytë (Gj2) me çelësat e gjuhës mëmë (Gj1); Kjo gjë vërehet mbi të gjitha në rregullat morfosintaksore të gjuhës së dytë]²⁰

Zakonisht tek nxënësi interferenca mund të jetë e vetëdijshme ose e pavetëdijshme, me vetëdije ndodh kur nxënësi bën hipoteza për të gjetur disa zgjidhje gjuhësore, ndërsa me pavetëdije kur nuk arrin të kuptojë që veçoritë gjuhësore mund të jenë të ndryshme, duke iu rikthyer kështu shembullit të gjuhës së parë të huaj të mësuar.²¹

Le të analizojmë disa prej tyre:

2.1) Prania e interferencave në nivel morfosintaksor

Një ndër gabimet klasike dhe lehtësisht i parashikueshëm nga vetë mësuesit është përdorimi i foljes ndihmëse *kam* në vend të foljes *jam*. Prirja për të gabuar është më e madhe për arsye se vërehet ndikimi i gjuhës mëmë: sistemi foljor i gjuhës italiane parashikon që foljet në kohët e përbëra të marrin foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, ku disa folje

19. Interferenca e jashtme ushtrohet nga gjuha mëmë, por edhe nga një gjuhë tjetër. Interferenca e brendshme shkaktohet nga mungesa e përvetësimit të rregullave të gjuhës së dytë apo si pasojë e analogjisë së gabuar.

20. Shamku L, (2020), *L'Albanese*, në “*La classe Plurilingue*”, Illaria Fiorentini, Chiara Gianollo, Nicola Grandi, Bononia, University Press, Bologna, Shtator, 2020, f. 45.

21. Ceruti, (2012), *La linguistica contrastiva e didattica di lingue affini: insegnamento dell'italiano ad un pubblico ispanofono*, f. 7.

që tregojnë lëvizje ose gjendje (*andare, venire, uscire, stare, rimanere* etj) marrin foljen *jam* në zgjedhimin e kohëve të përbëra, ndryshe nga shqipja. Një pjesë e tyre vazhdon të bëjë të njëjtin gabim në mënyrë të pavetëdijshme:

a) Folja

Ho andato- kam shkuar

Ho leggiuto/ ho leggato- kam lexuar

Ho stato- kam qenë

Ho venuto- kam ardhur

Ho uscito- kam dalë

Pra, këto zgjedhje vijnë si pasojë e përdorimit të foljes *kam*+pjesore në gjuhën shqipe.

Ndërsa *ho cominciata /ho finita* (shohim tendencën për të ruajtur përshtatjen e gjinisë dhe numrit me pjesoren edhe me foljen *kam*)

Raste të tjera me folje:

Mi è dovuto studiare

Abbiamo andato a casa

Ho restato per due ore

Io ho piacerei / mi piacerei

Tu amato

Përdorimi i pjesoreve të parregullta:

morito- morto

leggiuto-leggere

prenduto-presò

faciuto- fatto

Me foljen *jam* dhe *kam* hasim gabime në të shumtën e rasteve me format e para të prezantimit në fjalitë klishe si:

-*Quanti anni hai?*

-*Sono 10 anni.*

-*Quanti anni sei?*

-*Io ho 12 anni hai.*

Ose me shprehjet "*come sei?*" në vend të "*come stai?*";

b) Mbiemri

Ndër dukuritë më të zakonshme të përdorimit të mbiemrave gjatë ndërtimit të fjalive të thjeshta apo edhe në materiale të shkruara, ajo çka është domethënëse është pikërisht vendosja e tij para emrit. Ky fenomen ndodh sidomos në hapat e parë, kur nxënësi ndërton krijimet e para gjuhësore. Në rastet e mëposhtme vërehet ndikimi i gjuhës angleze dhe ndikimet nga ana morfo-sintaksore:

*Io ho una **blue** matita.*²²

*Carlo ha comprato una **rossa** matita.*

*Io ho **neri** occhi.*

*Il mio **preferito** libro è Harry Potter.*

***Estive** vacanze*

***Amichevoli** persone*

Vërejmë fjalitë:

*Oggi, **I** vado a scuola alle 07.30;*

***I** ho un cane;*

***Tu** hai una penna e **Io** ho una matita.*

Siç mund të vëmë re, përemri vetor “*Io*” është me shkronjë të madhe, ai përdoret në vend të përemrit të vetës së parë “*I*” në anglisht. Edhe në fjalinë *Chiara e Io siamo amici*, është krejt e qartë influenza e gjuhës angleze pasi përdoret shkronja e madhe.

Ndërtimet gjuhësore “origjinale” nga ana e nxënësve janë shumë të pranishme për shkak të përgjithësisht që u bëjnë rregullave gramatikore, tashmë të përvetësuara më parë. Në të shumtën e rasteve, nxënësit përdorin strukturat e gjuhës së dytë duke pasur në mendje shumë nga strukturat e përvetësuara nga gjuha e parë.

Ky ndikim vihet re edhe në aspekte të tjera gramatikore si për shembull me shumësin e emrave, të cilat, në mënyrë të pavetëdijshme, dalin me “s” në fund:

blues- blu

ristorants -ristorante

22. Në rastin e parë vërehet jo vetëm pozicioni, por edhe përdorimi i mbiemrit në gjuhën angleze, *blue*.

gelats- gelati

pennes -penne

fioris- fiori

persones- persone

colours- colori

parents- genitori, parenti

Ndikimet nga anglishtja i gjejmë edhe në nivel leksikor ; disa prej tyre madje konsiderohen si « miq të rremë » ose ndryshe *falsi amici* dhe disa fjalë të tjera që ngjajnë të miksuara mes anglishtes dhe italishtes.

Parents- genitori, parenti

library- biblioteca

Actually/ actualmente- attualmente (do të ishte in realtà)

Colours- colori; Noisy –noioso

Finalment/finally- finalmente

Succesfull- successo; Prise-prezzo

Influence –influenza; Stupid-stupido

May- maggio; August-agosto

Octobero- Ottobre in general-in generale;

Exercise- esercizio; texto-testo-test

Redo –rosso; solution- soluzione

Blue – blu; England –Inghilterra

Example/exempio- esempio; phrase/ frase

c) Gjinia

Përgjithësisht, emrat të gjinisë mashkullore në gjuhën italiane përfundojnë me « o », emrat të gjinisë femërore përfundojnë me « a » janë, ndërsa disa emra që përfundojnë me « e » u përkasin të dyja gjinive. Megjithatë, ekziston një numër i madh përjashtimesh, si: il poeta, il cinema, il problema, la mano, l'opinione etj. Disa nga këto emra në gjuhën shqipe kanë gjini të kundërt dhe si pasojë përdorin gabim nyjën e shquar në italisht. Le të listojmë disa prej tyre:

Il mio opinione la problema

La pane la cinema

Il montagna *la piede*

la naso *il moto*

la tavolo/lo tavolo *la zaino*

la giorno *la fiore*

il carne *il chiave*

il gente/le genti

Le personi /Il persone/i personi (tutti le personi che conosco)

d) Përemrat

Ndër gabimet më klasike për shkak të interferencës nga gjuha mëmë është forma “*a me mi piace/a me non mi piace*”; “*a te ti*” dhe “*a noi ci*”, ku sipas Ledi Shamkut gjen legjitimitet në përdorimin e përditshëm, por çertifikohen nga të gjitha gramatikat zyrtare.²³ Kjo strukturë, sipas normës gjuhësore italiane, konsiderohet e gabuar, edhe pse është e pranishme tek folësit, mirëpo, në gramatikën tonë, jo. Kësisoj gabimi mbetet shumë i shpeshtë tek nxënësit apo folësit e zakonshëm të gjuhës italiane.

Le të vërejmë një rast tjetër të përdorimit të pronorëve në fjalinë *Io ho preso mia borsa, mio capello e mie scarpe*. Edhe këtu kemi një ndërtim fjalie që ndikohet nga gjuha mëmë, duke shmangur përdorimin e nyjës së shquar *la, il, le*.

e) Forma e mirësjelljes

Ndër rastet që i duhet kushtuar rëndësi është forma e mirësjelljes, pra “*Ju*” në vend të “*Lei*”, forma e mirësjelljes italiane, që si pasojë ndryshon edhe përdorimin e vetës së foljes.

-Di dove siete, professor Bianchi?

-E Lei maestro, di dove siete?

Pavarësisht përdorimit të gabuar, në një kontekst bashkëbisedimi italian, është e kuptueshme, pasi edhe në krahina të jugut në Itali, përdoret kështu. Megjithatë, norma gjuhësore dikton përdorimin e vetës së tretë, formën “*Lei*”.

23. Shamku L, (2020), L’Albanese në La classe Plurilingue, Illaria Fiorentini, Chiara Gianollo, Nicola Grandi, Bononia, University Press, Bologna, Shtator, 2020, f. 44.

3. Prania e interferencave në nivel leksikor

Në aspektin leksikor, interferencat janë të shpeshta, tek e fundit përmes leksikut ndodhin shkëmbimet ndërgjuhësore, nëpërmjet të cilëve, disa terma të huaja apo përdorimi i disa shprehjeve idiomatike nguliten fort në sistemin e një gjuhe ashtu siç janë (procesi i fosilizimit apo kalkeve) dhe është vështirë të përshtaten. Le të shohim disa shembuj:

libero-libro

Fisicalmente-fisicamente

Come sei? Come stai?

Io vado bene.

Mi piaccio/ mi piace

A me mi piace /tu ti piaci il pesce

Insegnare në vend të imparare: io insegno velocemente.

Vedere në vend të guardare: Noi vediamo la tv.

Buono në vend të bravo: lui è un buono ragazzo

Buona amica- migliore amica

La tua più buon decisione – La migliore decisione

Riempire il buco

Nel mio opinione

Mangio colazione- fare colazione

Mangio pranzo

Giocare a lettere (carte)

Architectto- architetto

Telefhonare-telefonare/ Ti prendo al telefono

Përfundime

Studimi i gjuhës italiane paraqet disa probleme të cilat evidentohen në performancën e nxënësve dhe nivelin e tyre gjatë procesit të përvetësimit. Shembuj të interferencave na shërbejnë për të pasur një panoramë më të gjerë dhe orientuese rreth tipologjive të gabimeve që janë më të pranishme tek nxënësit dhe shërbejnë si tregues për të reflektuar mbi strategji dhe përmirësime të mundshme në metodat e mësimdhënies.

Ajo çfarë konsiderohet e domosdoshme për mësimdhënësit ka të bëjë me rëndësinë që duhet t'i kushtojnë reflektimit mbi tipologjitë e gabimit. Analiza e tyre dhe veprimtaritë didaktike të mësuesit janë

thelbësore, dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e aftësive gjuhësore tek nxënësit, duke rritur performancën e tyre. Vënia e nxënësve në situata autentike dhe kontakti i vazhdueshëm gjuhësor me italishten shihet si një mundësi përvetësimi e gjuhës me shumë efikasitet. Sigurisht, aspekte të tjera që duhen të merren parasysh janë faktorët jashtëshkollorë të cilët ndërhyjnë në procesin e gjuhënxënies; niveli socio-ekonomik familjar; aspekti socio-kulturor dhe kontakti gjuhësor, të cilët justifikojnë praninë e interferencave.

Gjatë hulumtimit vihet re ndikimi i gjuhës mëmë që është një dukuri e pashmangshme, por duhet të jemi të vetëdijshëm për faktin se herë pas herë duhet t'i referohemi asaj. Gjatë procesit të gjuhënxënies, duhet ta kemi të qartë se nxënësit arrijnë të bëjnë deduktime rregullash gramatikore duke i krahasuar ato me gjuhët e tjera, madje, siç vihet re tek shembujt e mësipërm, ato vetë shpesh gjejnë diferenca dhe analogji mes tyre. Prandaj ky proces kërkon kohën e mjaftueshme dhe strategjitë e duhura për t'u asimiluar.

BIBLIOGRAFIA

- Balboni.P, (2008), *Linguistica acquisizionale e glottodidattica*, in GRASSI R., BOZZONE COSTA R., GHEZZI C. (a cura di), *Dagli studi sulle sequenze di acquisizione alla classe di italiano L2*, Perugia, Guerra, f. 12-13.
- Balboni P, (1994), *Didattica dell'italiano a stranieri*, Bonacci editore.
- Ceruti E, (2012), "La linguistica contrastive e didattica di lingue affini: insegnamento dell'italiano ad un pubblico ispanofono", f. 7.
- I konsultueshëm në: https://www.researchgate.net/publication/41392113_Linguistica_contrastiva_e_didattica_di_lingue_affini_l%27insegnamento_dell%27italiano_ad_un_publico_ispanofono
- Freddi G, (1995), *Glottodidattica, fondamenti, metodi e tecniche*, Torino, UTET, p.55.
- Gracci S, (2004), *Linguistica acquisizionale e glottodidattica*, në *Italiano LS nel Mondo: L'Italiano da Pietroburgo ai Balcani*, viti IV, nr.13, f. 15-16.
- Grandi N, (2020a), *La classe plurilingue*, Bononia University Press, f.15.
- Grandi N, (2019), *Ti je gjuha që flet. Baza të tipologjisë gjuhësore*, perk.në shqip Ledi Shamku,Çabej, f.148.
- Mezzadri M, (2016), *Le politiche linguistiche europee: tra continuità e cambiamento në Studi sull'apprendimento e l'insegnamento linguistico*, Edizioni Ca'Foscari, Venezia, f. 12.
- Nenshtati, A (2012), *Interferencat gjuhësore dhe ndikimi i tyre në aftësinë komunikuese në gjuhë të huaj*, në Aktet e Konferencës Ndërkombëtare Shkencore: *Sfida dhe Perspektiva të Mësimdhënies së gjuhës së huaj*, Univesiteti i Shkodrës, f. 85.
- Pallotti G, (2014), *La seconda lingua*, Strumenti Bompiani, f. 3,10,45,47,60-64
- Ramat G & Vedovelli. M, (1994), *Italiano lingua seconda/lingua straniera*, Atti del XXVI congresso della Società Linguistica Italiana, 5-7 novembre 1992, Bulzoni, Roma.
- Selinker L, (1972), *Interlanguage* (trad.it in Matarese Perazzo, 1983), f. 214.
- Shamku L, (2020), *L'Albanese në La classe Plurilingue*, Illaria Fiorentini, Chiara Gianollo, Nicola Grandi, Bononia, University Press, Bologna, Shtator, 2020, f. 44-45.
- Vedovelli. M, (2003), *Verso l'italiano. Percorsi e strategie di acquisizione*, Roma, Carocci, 2003, f. 270-304.

“LARG TURMËS SË ÇMENDUR”: MES ROMANTIZMIT DHE REALIZMIT VIKTORIAN

Msc. Enkelejda Malaj

Departamenti i Gjuhës Angleze

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

E-mail: enkelejda_malaj.doktorantfgjh@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Tomas Hardi është një shkrimtar i madh anglez, një nga ata romancierë, që tejkaluan romantizmin, për të përqafuar realizmin dhe natyralizmin letrar, si formë rebelimi ndaj hipokrizisë morale dhe sociale të kohës.

“Larg turmës së çmendur”, romani i tij i katërt, shpalos më së miri kalimin e tij nga ndikimet poetike dhe romantike tek tiparet më prozaike, realiste dhe natyraliste. Ndikimet romantike i vërejmë në admirimin e veçantë për jetën fshatare dhe përshkrimet e shkëlqyera të natyrës, ndërsa tiparet realiste dhe natyraliste i gjejmë në përzgjedhjen e temave, portretizimin e gruas si protagoniste, realitetin e ashpër të jetës, lojërat e fatit, dhe fatalizmin, që përndjekin disa nga personazhet e romaneve, duke çuar në pashmangshmërinë e tragjedisë së pafajësisë dhe mirësisë njerëzore.

Në krahasim me romanet e tij të mëvonshme, si “Tesi i D’Erbervilëve” dhe “Juda i paemër”, vërejmë se “Larg turmës së çmendur” është romani, ku zënë fill disa nga temat ngacmuese letrare, politike dhe shoqërore, të cilat Hardi i përforcoi më tej në veprat e mëvonshme.

Fjalët çelës: *Tomas Hardi*, romantizmi, realizmi, natyralizmi letrar, feminizmi.

ABSTRACT

Thomas Hardy is a great English writer; one of those novelists who outthought Victorian Romanticism to embrace literary Realism and Naturalism, as a form of rebellion against the moral and social hypocrisy of his times.

“Far from the madding crowd”, his fourth novel, demonstrates his transition from the poetic and romantic influences to the more prosaic, realistic and naturalist traits. Romantic influences are noticed in his particular admiration of rural life and splendid descriptions of nature, while realistic and naturalistic traits can be observed in his choice of themes, representation of the female protagonist, harsh reality of life, games of destiny, and fatalism, which persecute some of the novel’s characters, leading to the inescapable tragedy of human innocence or decency.

Compared to later novels, such as “Tess of the D’Urbervilles” and “Jude the Obscure”, we notice that “Far from the madding crowd” is the novel, where Hardy planted several of the controversial literary, political and social themes, further accentuated in later works.

Key words: *Thomas Hardy*, Romanticism, Realism, Literary Naturalism, Feminism.

Tomas Hardi¹ (1840-1928) është një nga personalitetet më të mëdha të letërsisë angleze dhe botërore, poet dhe prozator romantik, por edhe realist e natyralist, njohës i psikologjisë dhe shpirtit njerëzor, mendimtar që sfidoi kohën dhe konvencionalen, një arkitekt që u bë shkrimtar i madh për të ndërtuar kështjella letrare dhe mendimi, që kapërcejnë shekujt dhe mbeten universale ndër breza.

Në vendin tonë ai njihet kryesisht si autori i “*Tesit të D’Erbervilëve - Tess of the D’Urbervilles*” (1891) – **një nga kryeveprat e tij**, e njohur edhe për shkak të filmit me të njëjtin titull, i cili pati fatin t’i shpëtonte censurës komuniste. Në këtë punim do të përqendrohemi tek romani “*Larg turmës së çmendur – Far from the Madding Crowd*”² (1874), romani i katërt i Hardit, por i pari që i dha sukses si romancier. Botuar fillimisht në vitin 1874, ky roman është një ndalesë e rëndësishme në krijimtarinë e Tomas Hardit dhe një pikë referimi për të analizuar kalimin e tij nga ndikimet e hershme poetike dhe romantike tek tiparet më prozaike, realiste dhe natyraliste, që i vërejmë në mënyrë më të theksuar në romanet e mëvonshme, si “*Tesi i D’Erbervilëve*”, “*Kryebashkiaku i Kasterbrixhit – The Mayor of Casterbridge*” (1886), dhe veçanërisht “*Juda i Paemër – Jude the Obscure*” (1895).

Një perandori koloniale, Anglia viktoriane (1837 – 1901) përjetonte kulmin e begatisë, zhvillimit industrial dhe tregtisë, lulëzim të arkitekturës, pikturës, letërsisë dhe botimeve. Në mes të kësaj energjie zhvillimi e krijimi, lindja dhe përhapja e rrymave të ndryshme intelektuale e letrare, si romantizmi, realizmi, natyralizmi, estetizmi, dekadentizmi, darvinizmi, racionalizmi, etj., mbivendoseshin dhe mbarsnin një terren idesh e kundërshtish filozofike, teologjike, artistike e letrare, në të cilin nuk është e çuditshme që shkrimtari dhe mendimtari të gjenden **në udhëkryq**. “Larg turmës së çmendur” është, në **shumë aspekte**, një roman që mishëron pikërisht këtë mozaik intelektual e letrar, ideor dhe shpirtëror të kohës kur u shkrua, por edhe të vetë autorit. Në këtë punim do të përpiqemi të kuptojmë sesi ky roman është një produkt i udhëtimit intelektual dhe letrar të autorit dhe një rrugë e mesme për **të përçuar ide** sfiduese për kohën dhe shoqërinë viktoriane, të cilat hasen edhe më të theksuara në romanet e mëvonshme të tij.

1. Në këtë punim emrin e autorit Thomas Hardy do ta gjeni në trajtën e pranuar tashmë në shqip, Tomas Hardi; ndërsa për të gjithë emrat e tjerë do të shënojmë variantin në gjuhën origjinale.

2. Në shqip romani ka ardhur nga botimet “Living” në vitin 2021, me titullin “Larg turmës së çmendur”.

Poeti romantik brenda romancierit të ardhshëm

Poet në shpirt dhe ambicie, në **moshën 22 vjeçare**, **Hardi** i drejtohet Londrës, i vendosur për të lënë gjurmën e tij në shoqërinë dhe jetën intelektuale londineze. *Claire Tomalin*-i një ndër biografet më të njohura të tij, pohon se **Hardi**: “bleu libra...shumë vëllime me poezi. Shkruante poezi vetë, gjithnjë e me më shumë dëshirë e vetëbesim”³. *Baladat Lirike (1798)* të *William Wordsworth*-it dhe *S. T. Coleridge*-it, të shndërruara me kohë në **manifestin e romantizmit** në Angli, kishin shtruar udhën për lulëzimin e romantizmit në **poezi**, duke arritur kulmin me *John Keats*-in, *Percy Bysshe Shelley*-in e *Lord Byron*-in⁴. Shkëlqimi i poezisë romantike deri në mesin e shekullit të XIX, me gjuhën adhuruese për natyrën, apo romanet historike të *Walter Scott*-it, për heronj dhe shembuj të gjenialitetit njerëzor, për ekzotiken, të përtejmen, për imagjinatën dhe përjetimet shqisore, kishin zënë rrënjë në **shpirtin poetik të djaloshtit Hardi**. Burimet biografike na dëshmojnë se gjatë viteve 1864-1865, **Hardi** mbante një libër shënimesh “*Studime, shembuj, etj.*”⁵, ku vargjet e *Byron*-it, *Shelley*-it, *Keats*-it, *Tennyson*-it, shënoheshin shpesh, duke pohuar atë që po formësohej në mendjen dhe shpirtin e djaloshtit të ri. Koncepti romantik i poetit, si ‘rojtësi i çelësit të të fshehtave të zemrës së njeriut dhe të vetë jetës’⁶, që u kërkonte njerëzve t’i riktheheshin imagjinatës, mistikës së natyrës, legjendares dhe pastërtisë së zemrës, duhet të ketë pushtuar **ëndrrat e** të riut. Poezitë e *Wordsworth*-it, gjatë orëve vetmitare në Londër, e ndillnin drejt qetësisë ngushëlluese të natyrës dhe gëzimeve të ngrohta të familjes e miqve, që kishte lënë pas⁷.

Realiteti larg romantikes

Ashtu si protagonistin në romanin “**Juda i paemër**”, djaloshi nga *Dorchester*-i do të gjente në Londër një realitet fort larg idealeve të romantizmit. E rrëmujshme, e ndotur, me tym e pluhur qymyri,

3. Tomalin, Clare, *The Londener*, Thomas Hardy: The Time-Torn Man, Penguin Books, 2006, fq. 68.

4. Britannica, The Editors of Encyclopaedia, “Romanticism”, Encyclopedia Britannica, 25 Apr. 2023, <https://www.britannica.com/art/Romanticism>. Accessed 10 June 2023.

5. Pite, Ralph, “If but some vengeful god would call to me”, “Thomas Hardy: The Guarded Life”, Picador, 2006, fq. 114.

6. Burgess, Anthony, *The Romantics*, English Literature, Longman Group, 1981, fq. 166.

7. Pite, Ralph, “If but some vengeful god would call to me”, “Thomas Hardy: The Guarded Life”, Picador, 2006, fq. 115, Wordsworth: ‘Even as a dragon’s eye, that feels the stress’.

Londra ishte kryqëzimi i më shumë se tre milionë banorëve rreth viteve 1860⁸. Këtë realitet viktorian të urbanizimit të vrullshëm dhe ndryshimeve shoqërore si pasojë e industrializimit⁹, e gjejmë në disa romane shoqërore të Charles Dickens-it, që nga “*Shtëpia e Zymtë*¹⁰” (1852), “*Nikolas Nikelbi*¹¹” (1839), e “*Kohë të vështira*”¹² (1854), apo “*Veriu dhe Jugu*¹³” (1855) i Elisabeth Gaskell-it, e “*Qyteti Midëllmarç*¹⁴” (1872) i George Eliot-it.

Londra ziente nga ide reformuese e progresiste, mendimtarë e artistë, që kritikonin romantizmin dhe hipokrizinë viktoriane, e me gra si Emmeline Pankhurst-i, që frymëzonin lëvizje politike për të drejtën e votës së grave, duke kërkuar përmbyesje të roleve në jetën politike dhe shoqërore të vendit. Larmia e mendimit filozofik, politik, letrar e shoqëror krijonte një terren, ku tradicionalja dhe konvencionalja bashkë-ekzistonin me të reën, ku rolet e vjetra sfidoreshin nga dinamika të reja ekonomike, politike dhe shoqërore. Pesë vitet e qëndrimit në Londër, të rënduara nga zhgënjimet e një realiteti të hidhur, ishin vitet e formimit dhe ekspozimit me ide e teori të reja, ndër të cilat edhe ato të socializmit utopik¹⁵ e darvinizmit¹⁶. Romani si gjini letrare, veçanërisht *romani social*, dhe *realizmi* si bindje estetike u ushqyen nga ky mjedis, sepse ndryshe nga poezia, romani ofronte mundësinë e portretizimit të jetës¹⁷, duke hapur udhën për një erë dhe frymë të re në **letërsinë viktoriane**.

Pikërisht këtu gjejmë ngjizjen e romancierit që e sheh botën me sy vëzhgues, dyshues e protestues. Romani i tij i parë¹⁸ rrëfente historinë e një studenti të vetmuar e pa përkrahje **në Londër**, ku satirizoheshin shtresat e larta, vulgariteti i klasave të mesme, politika, morali, feja,

8. https://www.digitalpanopticon.org/London_1780-1900

9. Brantingler, Patrick, “Dickens and the Factories”, 1971, University of California Press, fq. 270; <https://www.jstor.org/stable/2933206>

10. Original: Dickens, Charles, “Bleak House”, 1852.

11. Original: Dickens, Charles, “Nicholas Nickleby”, 1839.

12. Original: Dickens, Charles, “Hard Times”, 1854.

13. Originali: Gaskell, Elizabeth, “North & South”, 1855.

14. Originali: Eliot, George, “Middlemarch”, 1872.

15. Widdowson, Peter (2018), Thomas Hardy, Oxford University Press, fq. 27.

16. Tomalin, Clare, The Blighted Star, Thomas Hardy: The Time-Torn Man, Penguin Books, 2006, fq. 220.

17. Henneman, John Bell. “The British Novel in the Nineteenth Century.” The Sewanee Review, vol. 12, no. 2, 1904, fq. 168. JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/27530621>. Accessed 9 June 2023.

18. “The Poor Man and the Lady” është titulli në original i romanit të parë të Hardit, shkruar në 1868, i cili nuk e pa kurrë dritën e botimit.

ndotja e **rrëmuja** urbane¹⁹. Refuzimi nga disa botues dhe këshilla nga miku i tij *George Meredith*, që të mos e botonte, sepse do të shkatërronte të ardhmen e tij si shkrimtar²⁰, flasin qartë për mesazhet e forta reformuese, që përçonte romani, mesazhe që autori i ruajti brenda vetes, për t'i rishprehur në mënyra të tjera, në vepra të ardhshme.

“Larg turmës së çmendur” të qyteteve mes romantizmit dhe realizmit

Vetë titulli *“Larg turmës së çmendur”* është një paralajmërim që autori dëshiron të largohet nga çmenduria e qyteteve, vorbulla e shkaktuar nga revolucioni industrial dhe rendja e harbuar pas parasë. Titulli na sjell në mendje vargun *“far from the madding crowd”* të elegjisë së Thomas Gray-it²¹ - një poezi lirike, që përkujton kotësinë e ambicieve dhe arritjeve të jetës përballë fundit të njëjtë e të pashmangshëm të gjithë njerëzimit, atë të *“grumbullit të mykur të dheut”* në oborrin e një kishe fshati. Ndryshe nga melankolia lirike e Gray-it, *“Larg turmës së çmendur”* është kryesisht një romancë e gëzueshme, një roman me histori njerëzore në kërkim të dashurisë, në një mjedis pastoral, që Hardi e përshkruan me nota romantike e gati-gati magjike, por me personazhe të zakonshme e me shqetësime të përditshme të jetës fshatare.

Ngjarjet zhvillohen në Anglinë jugore, në Wessex-in letrar të Hardit, një krahinë mes realitetit dhe imagjinatës, ashtu si vetë autori pohon në parathënien e romanit *“është hera e parë që guxoj të përdor fjalën “Wessex”, të nxjerrë nga faqet e hershme të historisë Angleze dhe t'i jap një domethënie imagjinare”*²², me gjasë si një mënyrë për të shkruar ‘një autobiografi të trilluar’ dhe për të evokuar të shkruarën nostalgjike²³. Si një romantik i mirëfilltë, që në faqet e para autori e fut lexuesin në një parajsë tokësore, të përshkruar me romantizëm e lirizëm, duke shtuar elementë magjikë e Biblikë të Edenit. Miriam Sette shprehet se *“...‘Larg turmës së çmendur’ është shembulli përfaqësues i stilit romantik në prozën letrare”* dhe se me këtë vepër *“Hardi i jep formë një lirizmi të ri në prozë”*²⁴. Ndërsa

19. Tomalin, Clare, *The Clever Lad’s Dream*, The Londener, Thomas Hardy: The Time-Torn Man, Penguin Books, 2006, fq. 64 dhe fq. 88.

20. Pite, Ralph, *“Thomas Hardy: The Guarded Life”*, Picador, 2006, fq. 290.

21. Originali: Gray, Thomas, *“Elegy on a Country Churchyard”*, <https://www.poetryfoundation.org/poems/44299/elegy-written-in-a-country-churchyard>

22. Hardy, Thomas, *“Far from the madding crowd”*, Preface, <https://gutenberg.net.au/ebooks/fr100056.html#ch0>

23. Yeazell, Ruth Bernard, *“Art of the everyday: Dutch painting and the realist novel”*, United Kingdom, Princeton University Press, 2008, fq. 162.

24. Sette, Miriam. *“Thomas Hardy, ‘Far from the madding crowd’ and the turn of the lyric.”* *The Hardy Review*, vol. 19, no. 1, 2017, fq. 52, JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/45301707>. Accessed 9 June 2023.

Martin Seymour-Smith mendon se romanet e Hardit duhej të ishin **poezi, dhe do të ishin të tilla nëse nuk do të ishte nevoja për para, që do ta shtynte drejt romanit**²⁵.

Me një gjuhë të pasur e të bukur, kapitulli 2²⁶ i romanit, nis me një natë nga jeta e Gabriel Oak-ut, menjëherë pasi Bathsheba ka mbërritur **në fshat dhe** ata janë takuar rastësisht. Është nata e Shën Thomait, dita më e shkurtër e vitit. Hardi na përshkruan një natë përrallore, një qiell të kthjellët, shkëlqimin e Siriusit dhe yllit polar, - “*poezia e lëvizjes*” thotë Hardi për pozicionimet e yjeve në qiell, një spektakël që kushdo që qëndron mbi një kodër, në një orë të caktuar të natës, ka luksin ta shijojë, teksa “*pjesa më e madhe e njerëzimit të qytetëruar është e mbështjellë në ëndrra, në shpërfillje të tij*”. Kaq mahnitës është ky takim me qiellin, sa që Hardi thotë: “*Pas këtij takimi nokturn vështirë të kthehesh në tokë*”. Dhe spektakli vijon. Notat nga flauti i Gabrielit, që vijnë të largëta nga kasollja e këtij bariu me shpirt muzikanti, na paraqesin “*një imazh si ai i Arkës së Noas, në një Ararat të vogël*” – një botë, që ashtu si Perëndia me Noan, duket se edhe autori dëshiron ta shpëtojë nga prishja. Në disa faqe të para të romanit, Hardi na përshkruan një moment hyjnor dhe jetën e një bariu, **që jo rastësisht ka emrin e kryeëngjëllit Gabriel, që luan flaut**, këndon në kishë dhe shijon mrekullinë e natyrës, ashtu të qashtë e të pafajshme. Admirimi i Hardit për natyrën, mjedisin baritor dhe thjeshtësinë e lakmueshme të jetës larg zhvillimit është i qartë në çdo fjalë, në ndërthurjen e bukurisë së universit, me energjinë, thjeshtësinë, pozitivitetin e Gabrielit dhe shpirtin e tij muzikor, edhe pse vetëm një bari, me tufën dhe kasollen e tij të thjeshtë **në mes të natyrës**.

Por në mes të romantizmit të Hardit, nuk është e vështirë të vërejmë bashkëvendosjen e të kundërtave. Bashkëvendosja e imagjinare me realen, e faktit me trillimin, të dukshmes me të përtejmen, shprehin njëfarë dualizmi të Hardit, bashkekzistencën e ndikimit romantik dhe atij realist tek autori, i cili teksa kupton dhe përjeton realitetin e kohës dhe zhvillimit, ndjen nostalgji për një botë të shkuar, më të pafajshme dhe më të mirë, duke e tërhequr lexuesin drejt një botë ndjellëse. Vetë Gabriel Oak është ndërthurja e qiellores me tokësoren, e romantikes me realisten; Gabriel është emri i kryeëngjëllit, por mbiemri i tij është Oak (*shqip* ‘lis’). Ai është një fshatar e një blegtor duarartë, që ngrihet

25. Seymour-Smith, Martin, “Introduction to Hardy’s “The Mayor of Casterbridge”, Penguin Classics, 1988, fq. 13.

26. Hardy, Thomas, “Far from the Madding Crowd”, 2022, Wordsworth Editions Ltd, Kap. 2, “Night-the flock-an interior-another interior”, fq. 14 – 22.

me natë, jo fort besimtar, që përballon vështirësitë dhe dështimet e jetës fshatare me mund e djersë të ndershme, për çka 'krijuesi', Hardi, do ta shpërblejë me fundin e gëzueshëm të romanit.

Vlerësimi i personazheve në terma moralistë është një tipar i njohur i letërsisë romantike viktoriane, në përputhje me mendimin teologjik të krishterë, që virtyti shpërblehet dhe mëkatin e pret vetëm ndëshkimi shoqëror dhe hyjnor. Tek romani "*Larg turmës së çmendur*" autori deri diku e ndjek **këtë linjë**, por nuk mbetet peng i saj. Pavarësisht kthesave të fatit dhe vendimeve të papjekura të Bathshebës, historia e dashurisë së Gabrielit me Bathshebën shpërblehet me një bashkim **të lumtur, që e gëzon lexuesin** - një shpërblim që Hardi nuk ia rezervon Tesit, as Judës, me gjithë mirësinë dhe idealizmin, që ata përfaqësojnë. Por edhe brenda "*Larg turmës së çmendur*", Hardi e kundërshton qasjen viktoriane të lidhjes mes virtytit dhe fatit. Fundi tragjik i Boldwood-it na thotë tjetër gjë, e po ashtu edhe Fanny Robin, e cila është një 'Tes' e lindur më herët.

Përtej realizmit: ajo që sheh secili

Përtej romantizmit dhe adhurimit të natyrës, kapitull pas kapitulli, Hardi e njeh lexuesin me vështirësitë e jetës fshatare dhe e përgatit atë për filozofinë letrare dhe sociale, me tipare realiste e natyraliste, të cilat do të shpërthejnë në mënyrë shumë më qendrore dhe të dukshme në romanet e mëvonshme. Natyralizmi i Hardit i ka rrënjët tek teoritë e Charles Darwin-it, të cilat kishin shkundur dhe ndezur debatin shkencor, politik, fetar e shoqëror **në mbarë Europën**, por edhe përtej oqeanit, që prej botimit të veprës së tij "*Mbi origjinën e specieve*" në vitin 1859.

George Levine argumenton se Darwin-i dhe teoritë e tij 'patën një ndikim të jashtëzakonshëm në letërsi, duke ndryshuar mënyrën sesi njerëzimi do ta shihte botën që prej asaj kohe. Pranimi ose mospranimi i qëndrimit se sublimja nuk gjendej vetëm tek madhështia e natyrës, *një tipar i letërsisë romantike*, çoi në një ndarje mes atyre që ngurruan të studionin anën tjetër të natyrës: prishjen, kalbjen, humbjen²⁷.

Tek Hardi teoritë e Darwin-it krijuan bindjen racionale, por ngjizën edhe një dyzim, që e shoqëroi gjithë jetën. Hardi racional bindej nga argumentimet shkencore të Darwin-it dhe shprehej se me botimin e teorisë mbi origjinën e specieve kishte ardhur edhe rrënimi i besimit

27. Levine, George, "Darwin and the art of paradox", "Darwin, Tennyson and Their Readers: Explorations in Victorian Literature and Science", Anthem Press, 2013, fq. 109-34. JSTOR, <https://doi.org/10.2307/j.ctt1gxpwb0.11>. Accessed 9 June 2023.

fetar²⁸ dhe bashkë me të një botë e tërë. Parë nga ky këndvështrim, mund të themi se nostalgjia e Hardit për fshatin është nostalgji për fëmijërinë e tij, për një botë më të hershme, më të pafajshme, për Edenin para kafshimit të “pemës së njohjes”. Për fat të keq, megjithëse Darwinizmi hapte një dritare të pamenduar më parë për njerëzimin dhe njohjen e botës, ai vërtetonte se përparimi ishte sa frymëzues, aq edhe i pamëshirshëm²⁹, sepse “...shohim fytyrën e natyrës që shkëlqen nga gëzimi....por nuk shohim ose harrojmë se edhe zogjtë që këndojnë janë duke shkatërruar jetë të tjera³⁰.”

Nëse Gabriel Oak është personazhi më fatlum e romantik i “Larg turmës së çmendur”, Boldwood-i është njëri nga personazhet më tragjikë dhe natyralistë të tij³¹. Këtu Hardi na shfaqet si natyralist, sepse fataliteti, që e ndjek Boldwood-in është i atillë, saqë ai nuk është tjetër veçse marionetë e personazheve të tjera, e kthesave të fatit dhe forcave të padukshme kozmike, që vulosin fundin e tij tragjik. Boldwood-i është shembull i respektueshmërisë, një koncept dhe standard i lartë shoqëror në Anglinë viktoriane, që përmbledh një tërësi virtytesh, e megjithatë fundi i tij është tejet tragjik. Ai është një fermer i suksesshëm dhe i ndershëm, një zotëri në sjellje dhe një beqar i përkorë në çdo aspekt të jetës. Një rreng i pamend i Bathshebës i ndez atij shpresën e rreme për një lidhje dashurore dhe martesë. Pavarësisht paqëndrueshmërisë emocionale të Bathshebës, ai pret me vite, me një durim tragjik, duke përfunduar përjetë në qeli, pasi ka qëlluar për vdekje Troy-in, bashkëshortin e Bathshebës, i cili rishfaqet në fshat, atëherë kur Boldwood-i mendon se martesë e tij me Bathshebën, më në fund, do të bëhej realitet.

Vëzhgimi është një tipar dallues i qasjes realiste dhe natyraliste. E vërteta ekzakte për Hardin pushon së qeni interesante në art, nëse nuk bashkohet me të vërtetat e tjera, që gjenden diku atje, gjysmë të fshehura³². Në këtë frymë, për Hardin realizmi dhe pasioni për hollësitë nuk duhet të zbehin thelbin e së vërtetës dhe të vetë jetës;

28. Pite, Ralph, “If but some vengeful god would call to me”, “Thomas Hardy: The Guarded Life”, Picador, 2006, fq. 109.

29. Pite, Ralph, “Thomas Hardy: The Guarded Life”, United Kingdom, Yale University Press, 2007, fq. 26.

30. Darwin, Charles, “The Origin of Species by means of Natural Selection”, 1859, fq. 44, <https://charles-darwin.classic-literature.co.uk/the-origin-of-species-by-means-of-natural-selection/ebook-page-44.asp>

31. Personazhi tjetër tragjik i romanit është Fanny Robin, por për shkak se Boldwood-i zë një pozicion më qendror në roman, ne do të trajtojmë këtë të fundit.

32. Draper, Ronald, “Introduction to the casebook: Thomas Hardy: three pastoral novels.”, The Thomas Hardy Journal, vol. 4, no. 1, 1988, fq. 47 dhe 48, JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/45273862>. Accessed 12 June 2023.

është shkrimtari ai që shkon përtej asaj që shohin të gjithë, duke e pasuar me këndvështrimin e tij subjektiv, i cili depërton përtej sipërfaqes. Natyralizmi i Hardit studion pikërisht marrëdhënien mes njeriut thelbësisht të mirë dhe mjedisit të kalbur, ndryshe nga Emile Zola në romanin “*Thérèse Raquin*” (1868), ku autori francez synon të **nxjerrë në pah përmasat e frikshme të kalbjes së zemrës njerëzore. Nëse për lexuesin anglez, Hardi ishte i ngjashmi i Gustave Flaubert-it, Leon Tolstoy-it, Henrik Ibsen-it apo Emile Zola-së, vetë Hardi ishte ‘tejet kritik ndaj teorive bashkëkohore të realizmit’³³. Ai shprehej se: “...materialja nuk është e vërteta – ajo është vetëm e dukshmja, e vërteta është ajo që nuk e kap syri”³⁴, duke i vënë theksin vëzhgimit dhe interpretimit krijues e subjektiv të shkrimtarit. Vetëm përmes këtij të fundit mund të arrihet tek e vërteta, që i fshihet syrit.**

Boldwood-i është një personazh që mishëron tipare *romantike* dhe *natyraliste*; ai është **romantik në formimin dhe sjelljen e tij prej kalorësi, por natyralist në thelb**. Ka diçka naive në mirësinë dhe respektueshmërinë e tij, çka bëhet shkak për fundin e tij tragjik, si përforsim i filozofisë natyraliste të Hardy-it, i cili ndryshe nga natyralizmi i *Emile Zola-së*, na flet për njerëz të mirë në një mjedis armiqësor. Kenneth Marsden vëren se “*Hardi shfaq ndjesinë që njeriu është i huaj për Universin, i cili me gjasë është armiqësor dhe padiskutim shpërfillës ndaj tij*”³⁵ – e njëjta filozofi natyraliste që e gjejmë tek poezia “*Një njeri i tha Universit*”³⁶. Në shpërfillje të tiparit romantik të vlerësimit të karakterit të personazheve në terma moralistë, Hardi thekson ndërveprimin e tekave të fatit, nga njëra anë, me armiqësinë dhe shpërfilljen e mjedisit kozmik dhe shoqëror, i cili shpesh përcakton fatin e keq të palës më të dobët, më naive, më të mirë. Ky është një tipar që e largon Hardin nga romanticizmi, edhe pse ai vazhdon të ruajë një bërthamë romantizmi edhe brenda filozofisë natyraliste.

Jo vetëm tek romani në fjalë, por tek të gjitha romanet e Hardit gjejmë gjithmonë një takim fatal, një person fatal, që përcakton rrjedhën tragjike të personazheve. Tek romani “*Larg turmës së çmendur*”, Troy

33. Allen, Walter, “The Later Victorians”, “The English Novel, A short critical history”, Penguin books, 1991, fq. 244.

34. Hardy, Florence, “The Early life of Thomas Hardy”, Delphi Classics, 2017, fq. 243, Original: “The material is not the real – only the visible, the real being invisible optically”.

35. Seymour-Smith, Martin, “Introduction to Hardy’s “The Mayor of Casterbridge”, Penguin Classics, 1988, fq. 16, & Marsden, Kenneth “The Poems of Thomas Hardy”, “A Critical Introduction”, 1969, Oxford University Press.

36. Crane, Stephen, “A man said to the Universe”; <https://poets.org/poem/man-said-universe>

është mishërimi i personazhit fatal **për Fanny Robin**, por edhe për Boldwood-in, apo edhe Bathsheba për Boldwood-in, të ngjashëm me Alekun tek “*Tesi i D’Erbervilëve*”, apo Arabelën tek “*Juda i Paemër*”. Ai bëhet shkak i fatkeqësive në jetën e disa personazheve **të romanit** – Fanny Robin vdes, bashkë me foshnjën e saj dhe të Troy-iy, për shkak të sëmundjes dhe kushteve të vështira, pasi Troy e ka lënë dhe është martuar me Bathshebën; fermeri Boldwood përfundon tragjikisht **në burg, pasi ka vvarë Troy-in**, dhe është pikërisht vdekja e supozuar e Troy-it dhe më pas rishfaqja e tij në momentin e shumëpritur nga Boldwood, që shkakton tronditjen e madhe mendore të këtij të fundit, - pa harruar Bathshebën, pavarësisht se në fund autori i rezervon asaj një fat më të mirë.

Një femër larg idealit të gruas viktoriane

Shoqëria viktoriane krijoi idealin e saj femëror, sipas të cilit vajzat dhe gratë rriteshin dhe edukoheshin sipas një protokollit të rregulluar sjelljeje, dhe në rolet e tyre, si vajza, nëna dhe bashkëshorte, ato i përkushtoheshin modestisë, përlësisë, ndershmërisë dhe sakrificës për familjen. Shumë viktorianë, edhe më të hershëm, kishin përshkruar në romanet e tyre personazhe femërore, emocionale, sipërfaqësore, lojcake dhe mendjehëta, si Lidia tek “*Krenari dhe Paragjykim*”³⁷, Mariana tek “*Arsyeja dhe Ndjeshmëria*”³⁸ të Jane Austen-it, apo Cynthia tek “*Gra dhe Bija*”³⁹ të Elizabeth Gaskell-it. Përveç kësaj tipologjie sjelljeje femërore, e pritshme për perceptimin e përgjithshëm viktorian, gjithnjë e më shumë autore femra sjellin një tipologji tjetër femërore, personazhe që i kundërvihen profilit të femrës së bindur, të urtë, që lexonte poezi, luante **në piano dhe shprehte** botën e saj femërore në qëndisimat e përditshme, duke shpërfaqur një mendje dhe vullnet të fortë femëror, të gatshme për t’u paraprirë roleve më qendrore **në familje dhe shoqëri**, dhe duke shprehur **të drejtën për edukim dhe mendim politik**.

Mund të përmendim këtu, Mollin tek “*Gra dhe Bija*”, Margareta Heil te “*Veriu dhe Jugu*” të Elizabeth Gaskell-it, apo Dorothea Brooke te “*Qyteti Midëllmarç*” i George Eliot-it. Tek këto personazhe femërore **vërejmë gra që mishërojnë**, ato ide feministe që kishin filluar të qarkullonin në Anglinë viktoriane nga mesi i shekullit të XIX. Për shembull, Mollie Gibson tek romani “*Gra dhe Bija*” shfaq interes për ekspeditat shkencore në Afrikë të Roxherit, ndërsa tek romani tjetër i Gaskell-

37. Origjinali: Austen, Jane, “*Pride and Prejudice*”, 1813.

38. Origjinali: Austen, Jane, “*Sense and Sensibility*”, 1811.

39. Origjinali: Gaskell, Elizabeth, “*Wives and Daughters*”, 1866.

it, *“Veriu dhe Jugu”*, Margareta Heil kundërshton trajtimin e padrejtë dhe shfrytëzues ndaj punëtorëve në fabrikat e pambukut në Veriun e Anglisë dhe mbështet të drejtat e tyre për grevë dhe paga më të mira. Edhe George Eliot te *“Qyteti Midëllmarç”* na jep një Dorothea Brooke, që **është një bashkëbiseduese intelektuale e doktor** Lydgate-it, një grua që beson te shkenca dhe mbështet financiarisht eksperimentet mjekësore të doktorit, duke arritur pjekuri në mendimet e saj dhe fituar pavarësi në qëndrime dhe vendime.

Nëse Gabrieli është personazhi që mishëron tiparet më romantike në këtë roman, e Boldwood-i ato më natyraliste, Bathsheba është personazhi ku Hardi shfaqet realist e modernist. Bathsheba e Hardit **është edhe Marianë**, në aspektin e papjekurisë emocionale dhe impulsivitetit të pakontrolluar nga arsyeja dhe vetëpërmbajtja, por ajo është edhe Margareta Heil apo Dorothea Brooke. Në **kapitullin e parë**, ajo vjen si një vashë mendjemadhe, dhe ka raste që vërejmë se Hardi e konsideron atë *“sipërfaqësore”*, veçanërisht për vendimet e pamenduara e të nxituara që merr, që nga kartolina për Shën Valentin që i dërgon Boldwood-it, tek lidhja e shpejtë me rreshterin Troy. E megjithatë, Bathsheba është një femër, që na mahnit, në disa aspekte. Ajo është moderne dhe e freskët për mjedisin fshatar, në të cilin e takojmë. Hardi na përshkruan një vajzë të re me vetëbesim, të pavarur, që vesh xhakëtë të kuqe, që kalëron si burrë, që nuk ka frikë të spikasë dhe të tërheqë vëmendjen mashkullore. Në komunikimet e para me Gabrielin, Hardi shkruan: *“E megjithatë, ishte burri ai që u skuq, kurse vasha aspak⁴⁰”*.

Kur trashëgon fermën, ajo tregon që nuk ka frikë nga administrimi i saj, shkarkon nga detyra administratorin dhe urdhëron me qartësi e vendosmëri. Ajo e shpreh publikisht vendimin e saj se do të merrte përsipër administrimin e fermës, kur paraqitet vetë në tregun e produkteve bujqësore, ku nuk shkelte këmbë femre dhe *“betohet se do bëjë gjithçka vetë”*. Kështu, Bathsheba vjen te lexuesi si një vajzë e re, e vendosur dhe e gatshme për të sfiduar mjedisin dhe afirmuar veten të barabartë me çdo burrë, si në administrim dhe në punët e fushës, përmes së cilës Hardi i komunikon shoqërisë viktoriane një femër të së ardhmes, larg pritshmërive shoqërore të kohës. Kjo vajzë e re habit, kur deklaron: *“Ja kështu, do të keni një zonjë në krye dhe jo një zotëri... Unë do të ngrihem në mëngjes, para se ju të zgjoheni, do të jem në fushë, para se ju të jeni ngritur... me një fjalë, do t’ju habis të gjithëve⁴¹”*.

40. Hardy, Thomas, *“Far from the Madding Crowd”*, 2022, Wordsworth Editions Ltd, Kapitulli 3, fq. 24.

41. Hardy, Thomas, *“Far from the Madding Crowd”*, 2022, Wordsworth Editions Ltd, Kapitulli 10, fq. 87; - Shënim: përkthimet janë të autores së punimit nga origjinali.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i figurës së Bathshebës, që i flet një kohe tjetër, është komunikimi i saj me meshkujt dhe për më tepër, fakti që autori i jep luksin të flirtoje e të zgjedhë mes disa propozimesh mashkullore. Në mes të Anglisë viktoriane, ku femra u nënshtrohet vendimeve që merren për të, Bathsheba na shfaqet si një femër, që e shijon pushtetin që i jep gjinia, bukuria dhe statusi, krejt në kundërshtim me hipokrizinë e kohës, sipas rregullave të së cilës femra duhej të ishte e përkorë, madje krejt e paprekur nga fantazitë, lojërat dhe dëshirat seksuale. Ajo përzgjedh Troy-in, si për të na thënë se femra me mendjelehtësinë e saj, bën gjithmonë zgjedhjen e gabuar, sepse bazohet tek sipërfaqësorja; - por ajo luan me Boldwood-in, madje edhe me Gabrielin. Këtë të fundit e refuzon, e urdhëron, e vë në lojë, e sfidon, flirton dhe në fund është ajo që i shkon për vizitë në kasolle, kur mendon se mund ta humbasë përgjithmonë, çka krijon mundësinë për përsëritje të propozimit për martesë dhe pranimit të tij.

Paragjykimiviktorianimendjelehtësisëfemëroredhepaqëndrueshmërisë së saj emocionale është e dukshëm tek Bathsheba, por krejt e kundërta tek Gabrieli. Ai mbetet besnik, i palëkundur në ndjenjat dhe qëllimet e tij ndaj Bathshebës, duke i bërë nder gjinisë që përfaqëson. Siç e pranon vetë Bathsheba në kapitullin 56: *“Ai, që kishte besuar te ajo dhe i kishte dalë në krah, kur e gjithë bota i kish dalë kundër”⁴²*. Në kapitullin 24 të romanit, Hardi shkruan: *“Femrat nuk lodhen kurrë duke vajtuar për paqëndrueshmërinë e burrit në dashuri, por duket se ato vetëm e shpërfillin qëndrueshmërinë e tij”⁴³*. Me gjithë këtë qasje më pozitive të Hardit ndaj personazhit mashkullor, kjo nuk e ul autorin në sytë e lexuesit femëror, përkundrazi këtu mund të qëndrojë edhe një tjetër tipar i realizmit dhe modernizmit të tij. Për Hardin edhe protagonistët janë personazhe realiste, me të meta dhe virtyte dhe jo thjesht personazhe pozitive apo negative, të parapëlqyer ose jo nga krijuesi i tyre.

Vetë dashuria mes Gabrielit dhe Bathshebës është moderne. Hardi na përshkruan një udhëtim emocional dhe shpirtëror të dy personazheve, që kapërcen pabarazinë shoqërore dhe ekonomike, refuzimin dhe egon e lënduar mashkullore, martesën dhe rivalët e mëparshëm të Bathshebës, marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës, duke i ofruar lexuesit konceptin e tij për dashurinë dhe martesën. Nëse në konceptin

42. Hardy, Thomas, “Far from the Madding Crowd”, 2022, Wordsworth Editions Ltd, Kapitulli 56: Beauty in Loneliness – After All, fq. 388.

43. Hardy, Thomas, “Far from the Madding Crowd”, 2022, Wordsworth Editions Ltd, Kapitulli 24: The Same Night – The Fir Plantation; fq. 161.

viktorian, martesë është një institucion dhe konvencion, një kontratë për përparim shoqëror, siguri dhe mirëqenie ekonomike, për Hardin martesë është një bashkim mes dy njerëzve, një afërsi dhe miqësi e sprovuar, që kapërcen emocionin apo pasionin e çastit, duke shpërfillur dallimet klasore, pabarazinë ekonomike dhe çdo paragjykim tjetër.

Përfundime

I njohur për pesimizmin e tij të theksuar, “Larg turmës së çmendur” është romani më i gëzueshëm i Hardit. Njëherazi, romani ku autori përpiqet më shumë se në asnjë vepër tjetër të gjejë barazpeshën në disa nivele.

Së pari, brenda vetes. Dyzimi i skalitur në qenien e tij, në intelektin dhe shpirtin e shkrimtarit, prej racionalitetit, nga njëra anë, dhe nevojës së brendshme e të përjetshme të njeriut për të besuar tek e mira, e larta dhe idealja, në anën tjetër, **është përcaktues në zgjedhjen e Hardit për të bashkëvendosur imagjinaren me realen, të dukshmen me të përtëjmen, tokësoren me qielloren, njerëzoren me kozmiken**, duke e tërhequr lexuesin drejt një bote ndjellëse e duke na lënë të kuptojmë se autori ndjen nostalgji për një botë të shkuar, më të pafajshme dhe më të mirë, larg urbanizimit dhe zhvillimit marramendës e shpirtbjerrës. Ndaj në këtë roman, Hardi vjen herë si romantik, herë si realist e natyralist, duke përshkruar edhe thjeshtësinë e bukurinë e jetës larg zhvillimeve të zhurmshe të kohës, edhe triumfin e një dashurie moderne, por edhe realizmin dhe tragjizmin e jetës njerëzore.

Së dyti, me botuesit dhe lexuesit e kohës. I refuzuar nga botuesit në rastin e romanit të tij të parë, për shkak të qëndrimeve të forta e gati-gati revolucionare, Hardi është i detyruar të përdorë teknika të tjera në këtë roman, ku mesazhet e forta qëndrojnë nën hijen e notave romantike, idilike e të gëzueshme, për t’u dalluar dhe vlerësuar nga lexuesi i vëmendshëm, që shkon tej sipërfaqes **së ndritshme. Ndaj, romani “Larg turmës së çmendur” dallon nga romanet e mëvonshme të Hardit dhe na dëshmon një fazë të evoluimit të tij drejt realizmit dhe natyralizmit të theksuar**, ose është vetëm një ndalesë e përshtatshme për të fituar popullaritetin e nevojshëm para se të guxojë të përcjellë mesazhet thellësisht provokuese, pesimiste e tragjike **të romaneve të mëvonshme.**

Së treti, me veten dhe botën. Hardi donte të shkruante romane që ishin më të vërteta se e vërteta’. Ai e vlerësonte të vërtetën në art, por besonte

se shkrimtari duhej të “shihte në zemër të gjësë”⁴⁴, duke nënkuptuar domosdoshmërinë e përfytyrimit artistik, subjektivizmin e krijuesit dhe aftësinë e tij për të rrënuar në thellësi të njeriut dhe të jetës. Ndaj në këtë roman, Hardi sjell një mozaik realitetesh, personazhesh dhe filozofish për jetën. Gabrieli është mishërim i rrymës romantike, me mirësinë dhe virtytet e tij; Bathsheba është pararendëse realiste e femrës së një kohe tjetër, e nevojës për ndryshim dhe barazi shoqërore; ndërsa Boldwood-i është personazhi që nxjerr në pah dinamikat natyraliste e tragjike të marrëdhënies mes njeriut thelbësisht të mirë dhe mjedisit armiqësor ose shpërfillës, kozmik e shoqëror, ndaj tij. Të tre personazhet plotësojnë njëri-tjetrin, ashtu si jeta është e plotë vetëm në larminë e saj.

Në veprën e tij “*Romani anglez: Një histori e shkurtër kritike*”, Walter Allen vëren se *letërsia viktoriane nuk përbën një trup të qëndrueshëm logjik dhe estetik, por prapë ata i bashkon një tërësi qëndrimesh, mendimesh... dhe fakti se ata e konsideronin veten e tyre si përfaqësues të asaj epoke*⁴⁵. Tomas Hardi është përfaqësues i asaj kohe dhe mishërim i asaj larmie letrare, ideore e shpirtërore, ndërsa romani “Larg turmës së çmendur”, megjithë kundërshtitë që mbart, është produkt i udhëtimit intelektual e letrar të autorit, si një rrugë e mesme për të arritur tek e vërteta, siç e shikonte ai.

BIBLIOGRAFIA

Allen, Walter, “The English Novel, A short critical history”, Penguin books, 1991

Austen, Jane, “Pride and Prejudice”, Penguin Classics, 1996

Austen, Jane, “Sense and Sensibility”, Penguin Classics, 2003

Burgess, Anthony, “English Literature”, Longman Group, 1981

Clark, Indy, “Thomas Hardy’s Pastoral: An Unkindly May”, United Kingdom, Palgrave Macmillan, 2016

Dickens, Charles, “Bleak House”, Heron Books, 1970

Dickens, Charles, “Hard Times”, Heron Books, 1970

Dickens, Charles, “Nicholas Nickleby”, Penguin Books, 1999

Eliot, George, “Middlemarch”, Oxford University Press, 1998

Gaskell, Elizabeth, “North & South”, Wordsworth Classics, 1993

Gaskell, Elizabeth, “Wives and Daughters”, Wordsworth Classics, 1993

Hardy, Florence, “The Early life of Thomas Hardy”, Delphi Classics, 2017

Hardy, Thomas, “Far from the Madding Crowd”, Wordsworth Editions Ltd, 2022

Hardy, Thomas, “Jude the Obscure”, Penguin Books, 1994

Hardy, Thomas, “Tess of the d’Urbervilles”, Wordsworth Classics, 2000

44. Hardy, Florence, “The Early life of Thomas Hardy”, Delphi Classics, 2017, fq. 190.

45. Allen, Walter, “The English Novel, A short critical history”, Penguin books, 1991, fq. 134.

- Hardy, Thomas, "The Mayor of Casterbridge", Penguin Books, 1988
- Levine, George, "Reading Thomas Hardy", Cambridge University Press, 2017.
- Marsden, Kenneth "The Poems of Thomas Hardy", "A Critical Introduction", Oxford University Press, 1969
- Pite, Ralph, "Thomas Hardy: The Guarded Life", Picador, 2006
- Seymour-Smith, Martin, "Introduction to Hardy's "The Mayor of Casterbridge", Penguin Classics, 1988
- Thomas Hardy in Context", N.p., Cambridge University Press, 2013
- Tomalin, Clare, "Thomas Hardy: The Time-Torn Man", Penguin Books, 2006
- Widdowson, Peter, "Thomas Hardy", Oxford University Press, 2018
- Yeazell, Ruth Bernard, "Art of the everyday: Dutch painting and the realist novel", United Kingdom, Princeton University Press, 2008
- Page online*
- Brantlinger, Patrick, Dickens and the Factories, 1971, University of California Press, fq. 270; <https://www.jstor.org/stable/2933206>
- Britannica, The Editors of Encyclopaedia, "Romanticism", Encyclopedia Britannica, 25 Apr. 2023, <https://www.britannica.com/art/Romanticism>. Accessed 10 June 2023.
- Crane, Stephen, "A man said to the Universe"; <https://poets.org/poem/man-said-universe>
- Darwin, Charles, "The Origin of Species by means of Natural Selection", 1859, fq. 44, <https://charles-darwin.classic-literature.co.uk/the-origin-of-species-by-means-of-natural-selection/ebook-page-44.asp>
- Draper, Ronald, "Introduction to the casebook: Thomas Hardy: three pastoral novels.", The Thomas Hardy Journal, vol. 4, no. 1, 1988, fq. 47 dhe 48, JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/45273862> Accessed 12 June 2023.
- Gray, Thomas, "Elegy on a Country Churchyard", <https://www.poetryfoundation.org/poems/44299/elegy-written-in-a-country-churchyard>
- Hardy, Thomas, "Far from the madding crowd", Preface, <https://gutenberg.net.au/ebooks/fr100056.html#ch0>
- Henneman, John Bell. "The British Novel in the Nineteenth Century." The Sewanee Review, vol. 12, no. 2, 1904, fq. 168. JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/27530621> , Accessed 9 June 2023.
- Levine, George, "Darwin and the art of paradox", "Darwin, Tennyson and Their Readers: Explorations in Victorian Literature and Science", Anthem Press, 2013, fq. 109–34. JSTOR, <https://doi.org/10.2307/j.ctt1gxpwb0.11> , Accessed 9 June 2023. Project Gutenberg Australia; <https://gutenberg.net.au/ebooks/fr100056.html#ch0>
- Sette, Miriam. "Thomas Hardy, 'Far from the madding crowd' and the turn of the lyric." The Hardy Review, vol. 19, no. 1, 2017, fq. 52, JSTOR, <http://www.jstor.org/stable/45301707> , Accessed 9 June 2023. https://www.digitalpanopticon.org/London_1780-1900

ROLI I AFTËSIVE ME SHKRIM NË GJUHËN E HUAJ PËR QËLLIME PROFESIONALE

Msc. Megi Plaku

Qendra e Gjuhëve të huaja
Fakulteti i Inxhinierisë Fizike dhe Matematike,
Universiteti Politeknik i Tiranës
E-mail: megplaku@gmail.com

Dr. Albana Avrami

Qendra e Gjuhëve të huaja
Fakulteti i Inxhinierisë Fizike dhe Matematike,
Universiteti Politeknik i Tiranës
E-mail: albanaavrami@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në kontekstin e sotëm edukues vihet re një anashkalim dhe mosvlerësim i aftësive shkruese. Shkaku i këtij qëndrimi lidhet me faktin se shkrimi në vetvete është i mundimshëm dhe kërkon një njohje të mirë të gjuhës dhe, së dyti, qasja ndaj tij si në gjuhën amtare, ashtu dhe në atë të huaj, është e kufizuar.

Publiku të cilit ne i japim mësim përgatitet për t'u përfshirë në punë menjëherë pas mbarimit të shkollës, ndaj dhe përvetësimi i aftësisë shkruese merr një rëndësi të veçantë. Nisur nga nevojat e komunikimit me shkrim në ndërmarrje, nga përdorimi i tij si mjet përvetësimi e reflektimi ndaj dijes, por edhe nga rëndësia e tij në jetën e përditshme, ne u përpoqëm të përfshijmë në programin e gjuhës së huaj terminologjinë e fushës si dhe disa prej llojeve të ndryshme të shkrimit që hasen më shpesh në praktikën e përditshme.

Qasja është pragmatike dhe synon t'i ndërgjegjësojë studentët për rëndësinë e zotërimit të kësaj aftësie gjuhësore edhe në ditët e sotme. Studimi është kryer në Universitetin Politeknik të Tiranës, me studentë të vitit të parë që ndjekin lëndën e gjuhës angleze dhe gjermane, gjatë vitit shkollor 2021-2022. Metoda e ndjekur është ajo cilësore, e vëzhgimit të orës së mësimi dhe e reflektimit të studentëve mbi vlerën e të nxëniet nëpërmjet njohjes dhe përvetësimit të aftësive të të shkruarit.

Rezultatet dhe diskutimet e vënë theksin në edukimin shkollor të të rinjve me këtë aftësi të rëndësishme gjuhësore si vlerë që do u shërbejë atyre gjatë gjithë jetës.

Fjalët çelës: Gjuhë e komunikimit profesional, kurrikula gjuhësore, tipologji tekstore, qasja metanjohtë, integrim i aftësive gjuhësore.

ABSTRACT

In today's educational context, there is negligence and underestimation of writing skills. This attitude is related to the fact that writing itself is difficult and requires a good knowledge of the language and, secondly, access to it both in the mother tongue and in the foreign language is limited. The audience we

teach prepares to be involved in work immediately after finishing school, so the acquisition of writing skills takes on special importance. Based on the need for written communication in companies, on its use as a means of acquiring and reflecting on knowledge, but also on its importance in everyday life, we tried to include in the foreign language program the terminology of the field as well as some different types of writing that are encountered more often in daily practice. The approach is pragmatic and aims to make students aware of the importance of mastering this language skill even today. The study was conducted at the Polytechnic University of Tirana, with first-year students attending the English and German language course, during the 2021-2022 school year. The method followed is qualitative, through observing the lesson and Students' reflection on the importance of learning through the recognition and acquisition of writing skills.

The results and discussions emphasize the noteworthiness of teaching these special language techniques as values that will serve students throughout their lives.

Keywords: Language of professional communication, language curriculum, text typology, metacognitive approach, integration of language skills

Hyrje

Studentët që vijnë në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) janë studentë që dallohen për një formim të përgjithshëm cilësor (mesatare mbi 8 në të gjitha lëndët). Përgjithësisht, ata dinë të komunikojnë rrjedhshëm në gjuhë të huaj, por mënyra e tyre e të shprehurit me shkrim është e kufizuar dhe flet për një ushtrim të pamjaftueshëm të kësaj veprimtarie në nivelin parauniversitar. Madje mund të themi edhe se shkrimi nuk është konsideruar asnjëherë për ta si një objekt nxëniesje në vetvete.

Në veprimtaritë e kryera për këtë qëllim, më shumë rëndësi merr kuptimi i teksteve dhe interpretimi i tyre sesa puna me shkrim dhe korrigjimi i saj në klasë apo si detyrë shtëpie nga mësuesi. Kemi të bëjmë me një kulturë shkollore që, për shumë arsye, nuk i kushton rëndësinë e duhur zhvillimit të kësaj aftësie në klasë. Të krijohet përshtypja se mjetet dhe koha nuk mjaftojnë për praktikimin e saj dhe se ajo përdoret vetëm si mjet vlerësimi përfundimtar.

Por edhe në mësimdhënien tonë, vendi që zë e shkruara është modest, për vetë faktin se sasia e orëve që i janë dhënë gjuhës së huaj është e kufizuar (80 orë maksimumi). Por, duke qenë të vetëdijshëm për mangësitë që shfaqin studentët në këtë drejtim si dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës, ne e kemi përfshirë këtë aftësi në programin e gjuhës së huaj.

Në fakt, pavarësisht se, për objekt studimi, i ndajmë veprimtaritë gjuhësore nga njëra - tjetra, në detyrat që u japim mundohemi që në ushtrime t'i kombinojmë të gjitha aftësitë, pra, që ato të jenë gjithëpërfshirëse. E thënë ndryshe, një detyrë me shkrim përfshin edhe kuptimin e teksteve, edhe fjalorin e përdorur (qasja terminologjike), edhe përdorimin e tyre me shkrim, saktësinë gramatikore të të shprehurit dhe përshtatjen me situatën ligjërimore të parashikuar.

Ndonjëherë, nga e shkruara mbi një temë kalohet në të shprehurin me gojë mbi të duke e problematizuar çështjen e trajtuar. Ndikimi, në këtë rast, është i dyfishtë. Nga njëra anë, u jepet kohë studentëve paraprakisht që të mendojnë e të gjejnë fjalorin e duhur mbi një temë, nga ana tjetër, parapërgatitet e shprehura me gojë dhe kalohet më lehtësisht në këtë aftësi, derisa, në një etapë të dytë, studenti shprehet drejtpërsëdrejti mbi një temë të caktuar, pa qenë nevoja e një kalimi të ndërmjetëm nga një veprimtari pasive në një veprimtari aktive shprehëse. Në këtë mënyrë, ai shndërrohet në një komunikues të vërtetë në gjuhë të huaj duke zotëruar dy aftësitë shprehëse kryesore të një gjuhe, të shprehurin me gojë dhe me shkrim.

Por, puna që është kryer për të arritur deri këtu nuk ka qenë e lehtë. Së pari, është nisur me konceptimin e programeve të reja të cilat duhet t'u përshtateshin sasisë së orëve që i ishin kushtuar gjuhës së huaj si dhe objektivave të saj. Eksperimentimi i kësaj kurrikule përbën fazën e dytë të zbatimit të saj duke ia përshtatur atë sa më shumë interesave të studentëve. Gjithashtu, përmirësimi i saj i vazhdueshëm në funksion të publikut dhe kërkesave të kohës, përbën sfidën e vazhdueshme të pedagogëve të gjuhëve të huaja të këtij universiteti.

Zbatimi i reformës së Bolonjës (që prej vitit 2003), nuk u pa thjesht si një ndryshim mekanik i kurrikulave, por, para së gjithash, si një kërkesë e përhershme për t'iu afruar sa më shumë nevojave gjuhësore të studentëve, fushës në të cilën ata po investonin dhe mjeteve që duhet të përdoshin për arritjen e qëllimeve të synuara.

Duke u mbështetur në qasjen tërësore të aftësive, pas një periudhe të gjatë kohore të zbatimit të saj, në vitin shkollor 2021-2022, ne konceptuam tekste shtesë në mësimdhënie që ishin më bashkëkohore, por edhe që lidheshin drejtpërsëdrejti me interesat profesionale të studentëve. Detyrat e realizuara synonin gjithëpërfshirjen e studentëve në reflektimin mbi mënyrën se si mund të mësonin në mënyrë të vazhduar për të gjetur zgjidhje ndaj problemeve të karakterit kërkimor dokumentuese që mund t'ju dilnin në të ardhmen në punën e tyre.

Nxitja e pavarësisë në kryerjen e detyrave ishte një nga synimet kryesore të edukimit gjuhësor të studentëve. Duke parë që realitetet shoqërore në të cilat ne jetojmë karakterizohen nga ndryshime të vazhdueshme dhe të paparashikueshme, përshtatja ndaj këtyre situatave del si domosdoshmëri parësore edhe në përpunimin e dokumenteve me të cilat duhet të punojnë inxhinierët e ardhshëm. Madje ata mund edhe të konceptojnë vetë dokumente të tilla në varësi të nevojave të ndërmarrjes dhe punës profesionale që u duhet të kryejnë.

Në studimin tonë, në fillim do të flasim për mënyrën se si u ndërtuan programet e gjuhës së huaj duke përfshirë në to edhe aftësinë shkruese të studentëve. Pastaj, mënyrën se si u vunë në zbatim, vështirësitë e hasura dhe mënyrën e kalimit të këtyre të fundit. Së fundmi, rezultatet e nxjerra nëpërmjet vëzhgimit të situatave gjatë orëve të mësimit dhe këndvështrimet e studentëve mbi metodat e përdorura e venë theksin në domosdoshmërinë e zhvillimit të kësaj aftësie kaq të rëndësishme për studentët inxhinierë.

1. Vendi i aftësisë shkruese në mësimin e gjuhës profesionale

Rindërtimi i kurrikulave për gjuhën e huaj në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe sidomos pakësimi i orëve të mësimit të gjuhës së huaj në këtë universitet për ciklin Bachelor, përbënin një sfidë të vërtetë për kombinimin e aftësive gjuhësore në mësimdhënie dhe për përmbushjen e qëllimeve të kësaj lënde. Për këtë qëllim, ne vendosëm paraprkasht disa objektiva kryesore që do të na udhëhiqnin në ndërtimin e një kurrikule që do të ishte sa më afër nevojave të studentëve në këtë lëndë.

1.1 Larmi e veprimtarive, teksteve dhe mënyrave të të shkruarit

Në zhvillimin e aftësisë së të shkruarit, u mendua që të kishte më shumë larmi në llojin e teksteve profesionale të zgjedhura, në përdorimin e fjalorit terminologjik të fushës si dhe të studiohej tipologjia tekstore e tyre, gjithmonë në funksion të përdorimit të tyre në komunikimin profesional. E thënë ndryshe, tekstet shpjeguese, argumentuese, përshkruese të zinin një hapësirë më të madhe në dokumentet shtesë të konceptuara nga vetë mësuesit. Ndërkohë, elemente të tyre mund të trajtoheshin edhe në manualet e gjuhës që përdorreshin në mësimdhënie.

Vetë studentët duhej të ushtroheshin në shkrimin e këtyre teksteve duke përdorur shkrimin në grup apo në mënyrë individuale, si dhe duke ia përshtatur shkrimeve profesionale më të përdorshme në ndërmarrje.

1.2 Shkrimi si proces, jo vetëm si mjet vlerësimi përfundimtar

Në këtë këndvështrim, mbështetja që u jepet studentëve synon përvetësimin e kësaj aftësie gjatë gjithë procesit mësimor, duke u mësuar edhe mënyrat se si ta realizojnë atë. Mbështetja konsiston edhe në mjetet që u jepen studentëve për të mësuar e përparuar në mënyrë të pavarur. Kështu, ata duhet të jenë në gjendje të riorganizojnë mendimet e tyre me anë të skemave konceptuale, të përdorin korrigjuesit automatikë në punimet e tyre me shkrim si dhe t'i rishikojnë shkrimet e tyre me sy kritik e t'i vetëkorrigjojnë ato sa më mirë. Në këtë mënyrë, ata do të mundohen që t'i zgjidhin vetë problemet që u dalin në gjuhë të huaj dhe të rrisin kësisoj besimin në vetvete për të kapërcyer vështirësitë me të cilat përballen në karrierën e tyre profesionale.

1.3 Kalimi i natyrshëm nga një aftësi te tjetra

Duke i parë aftësitë e ndryshme në bashkëveprim me njëra-tjetrën, përqendrimi vetëm të njëra prej aftësive, por duke e parë atë në bashkërendim me të tjerat, në pikëpamjen tonë, nuk është kufizues, por plotësues e mjaft i natyrshëm. Gjithashtu, këndvështrimet e ndryshme mbi të njëjtën aftësi, e përforcojnë atë pa e bërë të mërzitshme për studentin. Nga ana tjetër, edhe mobilizimi i aftësive të tjera, u lë të kuptojnë se gjuha është një, megjithëse për ta përvetësuar e përdorur më mirë në situata të ndryshme, ne e përqendrojmë vëmendjen në elemente të ndryshme gjuhësore e leksikore apo dhe ligjërimore. Për rrjedhojë, ata fillojnë e mendojnë në gjuhë të huaj dhe stërviten për ta përdorur atë në komunikimin me shkrim apo me gojë. Në këtë rrugëtim, ata nisin të kërkojnë vetë dhe mjetet e metodat që do u shërbejnë për të mësuar sa më shpejt dhe sa më mirë.

2- Kuadri teorik dhe metodologjik

Në punimin tonë ne u bazuam në idenë që në radhë të parë duhen ndryshuar përfytyrimet që studentët kanë mbi të shkruarin (Jodelet, 1989) si dhe në përvojën e tyre në konsultimin apo përdorimin e shkrimeve në gjuhë të huaj, sidomos në ato profesionale, pra në përvojën e tyre si shkrues në këtë gjuhë duke ndërvepruar me të dhe nëpërmjet saj (Vigotsky (1934), Bronckart (1996). Gjithashtu, në studimin tonë, ne u bazuam në konceptim e D. Lehman (1997) mbi përqendrimin e mësimdhënies mbi studentin

Metodat e përzgjedhura për të vjelë të dhënat, janë intervista dhe

vëzhgimet në klasë. Intervista na lejon jo vetëm që të analizojmë përfytyrimet e tyre mbi aftësinë e të shkruarit, por edhe mangësitë që ata kanë në këtë drejtim. Ndërsa vëzhgimet, na mundësojnë përzgjedhjen e përvojave më të përshtatshme apo dhe përmirësimin e atyre të përdorura më parë për të realizuar sa më mirë objektivat tona në shkrimin në gjuhë të huaj.

Të dhënat nga intervista u mblodhën që në javën e katërt të shkollës. Materiali iu shpërnda katër viteve të para në degën telekom në Fakultetin e inxhinierisë së teknologjisë së informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Në të morën pjesë 80 studentë (nga të cilët 65 vajza e 15 djem) të moshës 19-20 vjeç. Ndër ta, 70 iu përgjigjën të gjitha pyetjeve të dhëna paraprakisht. Intervista, gjysmë e drejtuar, ishte hartuar për të marrë përgjigje me gojë dhe pyetjet ishin të hapura. Ajo u realizua në gjuhën amtare, me qëllim që studentët të ishin sa më të lirshëm për t'u shprehur. Mbledhja e të dhënave u realizua nëpërmjet shënimeve të mbledhura nga përgjigjet e dhëna. Intervista përmbante pyetje mbi:

- 1- Gjuhët e mësuara në sistemin parauniversitar dhe aftësia e fituar për t'u shprehur në këto gjuhë
- 2- Sa ishte përdorur aftësia me shkrim në mësimin e gjuhës së huaj
- 3- Pritshmëritë e tyre në mësimin e gjuhës së huaj në universitet
- 4- Vështirësitë që ndjenin ata në zotërimin e gjuhës
- 5- Metodatat dhe teknikatat për mësimin e gjuhës së huaj

Për sa i përket pyetjes së parë, ata theksuan se kanë zhvilluar mësim minimalisht në dy gjuhë të huaja (80 %), madje kishte edhe nga ata që e kishin mësuar edhe një gjuhë të tretë (2%) si rezultat i ndërrimit të shkollës së mesme ku u ishte dashur të fillonin nga fillimi një gjuhë tjetër. Gjuha e parë, për nga rëndësia ishte gjuha angleze të cilën e kishin mësuar gjatë tërë viteve të shkollimit, ndërsa për gjuhët e tjera vetëm kishin marrë njohuritë bazë të kuptimit e leximit.

Aftësia me shkrim zinte një vend të rëndësishëm në kryerjen e ushtrimeve për këtë veprimtari në librat e gjuhës së huaj, por fare pak ishte e zhvilluar aftësia e të shprehurit me shkrim nga ata vetë si dhe kontrolli i vazhdueshëm i detyrave gjatë vitit shkollor. Korigjimi i detyrave ishte bërë, më së shumti, përmes testeve gjatë vitit apo provimit përfundimtar vlerësues. Për gjuhën angleze, një pjesë e mirë e studentëve i kishin zhvilluar aftësitë shkruese në kurse private të nivelit B1 e më lart, ku u ishte kërkuar të hartonin ese në gjuhë të huaj. Fakti

që në këto grupe numri i pjesëmarrësve ishte i pakët e mundësonte sipas tyre, zhvillimin e thelluar të aftësive shkruese. Në shkollë, numri i nxënësve në gjuhë të huaj arrinte deri edhe në 30 nxënës për grup, gjë që e bënte të pamundur kontrollin individual në zotërimin e aftësive me shkrim në gjuhë të huaj.

Për sa i përket pritshmërive të mësimit të gjuhës së huaj në universitet, ata kërkonin ta lidhnin më shumë përsosjen e saj me fushën profesionale, të mësonin terminologjinë e fushës, të vazhdonin ta praktikonin gjuhën si dhe të plotësonin ndonjë mangësi që kishin në zotërimin e saj. Ata e ndjenin të domosdoshme kontrollin e vazhdueshëm të aftësive të tyre shprehëse e shkruese në gjuhë dhe korrigjimin e gabimeve në mënyrë individuale apo kolektive.

Në gjuhën angleze, nuk ndjenin shumë vështirësi në kuptimin e teksteve të përgjithshme. Në gramatikë, ndjenin më shumë vështirësi. Po ashtu edhe në formulimin e saktë dhe në mënyrë koherente të fjalive në situata të ndryshme me të cilat atyre u duhej të përballëshin, jo vetëm me shkrim, por edhe me gojë. Ndërsa në gjuhët e tjera përveç anglishtes, kjo aftësi lidhej më shumë me zotërimin e gjuhës në veprimtaritë pasive.

Ndër metodat e përdorura, më e shpeshta ishte ajo e dëgjimit të emisioneve apo videove në linjë. Më pak e shkruara dhe e folura, vetëm në klasë nëpërmjet ushtrimeve apo si detyrë shtëpie dhe kjo, vetëm në rastet kur ua kërkonte mësuesi.

3- Interpretimi i të dhënave

Përfundimet që arritëm nga anketimi na ndihmuam që të kemi një panoramë më të gjerë për mësimin e gjuhës së huaj dhe mënyrën e zhvillimit të saj në universitet. Kjo etapë ishte e domosdoshme në hartimin e një kurrikule që do t'u përgjigjej nevojave dhe interesave të studentëve.

Kështu, shumëgjuhësia si dukuri e formimit gjuhësor të nxënësit, në sistemin parauniversitar është në rënie. Në shumë raste, gjuha e dytë po zëvendësohet nga lëndë të tilla si teatër apo komunikim. E thënë ndryshe, në këtë mënyrë, kufizohet dhe larmia e metodave të të nxënësve në gjuhë si dhe ajo e përforcimit të veprimtarive gjuhësore të përdorura, pasi mënyra e funksionimit në të gjitha gjuhët është, deri-diku, e njëjtë. Për pasojë, nxënësit humbasin mjaft strategji e mënyra të të mësuarit që mund t'i mësonin edhe nga një gjuhë tjetër.

Reflektimi mbi mënyrën e të nxëniet nuk është kthyer në një strategji për ta. Pak studentë i njihnin mënyrat e ndryshme të të mbajturit mend të fjalëve të reja apo të ndërtimit të një teksti logjik e koherent.

Në praktikën e të mësuarit, ata bazoheshin kryesisht në veprimtaritë ushtrimore që jepeshin në libra dhe jo në përdorimin e gjuhës si mjet shprehës i realiteteve të ndryshme sociale. Ata mund të zhvillonin shumë mirë ushtrimet, por kur u duhej të flisnin mbi temën e trajtuar, fare pak prej tyre kishin fjalorin e duhur, sidomos atë terminologjik.

Ndërveprimi në gjuhë ishte një metodë e praktikuar fare pak. Ata nuk dinin se si të ndërhyjnë në një bisedë, ta argumentonin apo ta nuanconin mendimin e tyre. Ata nuk ishin ndeshur me problematizimin e situatave apo me mbrojtjen e mendimeve të tyre në situata ligjërimore të ndryshme.

Për rrjedhojë, këto të meta që u vërejtën gjatë vëzhgimit në klasë u panë edhe në veprimtarinë e të shkruarit. Duke mos qenë ushtruar në këtë veprimtari, studentët hasën vështirësi në hartimin e respektimit e rregullave të të shkruarit (koherenca dhe kohezioni), në shkrimin funksional, në njohjen e llojeve të ndryshme të shkrimit profesional dhe në përshtatjen e të shkruarit me situatën e të shprehurit (zyrtare / jo zyrtare). Gjithashtu, njohja e teksteve të ndryshme ligjërimore, të cilat ata i kishin studiuar edhe në gjuhën amtare, mbetej me tepër në rrafshin teorik sesa në atë praktik.

Si përfundim, pas studimit që ndërmorëm, dy elemente u mbajtën parasysh për përmirësimin e kurrikulave: objektivat e synuara në mësimin e gjuhës së huaj në universitet dhe metodologjia e mësimdhënies/nxënies, pra, mënyrat se si mund t'ua thjeshtëzojmë studentëve mësimin e aftësive gjuhësore pa ua bërë mësimin e gjuhës së huaj teorik apo të mërzitshëm.

4- Shkrimi si një objekt i vërtetë nxënies

Metodat e gjuhës së huaj të përdorura në universitet janë të fushës profesionale dhe synojnë kryesisht pasurimin e fjalorit të studentit në fushën e tij të studimit. Por ato nxisin fare pak të shkruarin apo të folurin, dy veprimtari aktive mjaft të rëndësishme në mbajtjen gjallë të gjuhës, aq më tepër nëse veprimtaritë e kryera nuk dalin jashtë kuadrit të shkollës, për ta lidhur gjuhën me realitetin.

Në objektivat tona ne patëm parasysh pavarësinë e të nxëniet më qëllim që t'i ndihmonim studentët të krijonin një aftësi të gjërë ndërvepruese

(gjuhësore, ligjërimore, terminologjike e profesionale). Dhe kjo, do të arrihej vetëm nëpërmjet kësaj pavarësie në të nxënë që do t'i orientonte ata në vetëplotësimin në një shkallë sa më të lartë të nevojave të tyre gjuhësore e profesionale edhe pas mbarimit të shkollës.

Për këtë qëllim, në orën e mësimit, krahas punës me librin dhe mësimin e terminologjisë së fushës u punua edhe me strategjitë e të mësuarit, punën me materiale të llojeve të ndryshme si dhe me realizimin e detyrave jashtë klase.

Në mësimin e terminologjisë së fushës, u inkurajua gjetja dhe leximi i materialeve të fushës së tyre të specialitetit dhe krijimi i një mikro-fjalori të kësaj fushe nga ata vetë, të mbledhur nga materialet e konsultuara. Një punë e tillë do u shërbente për të mbajtur mend më mirë fjalorin e fushës si dhe për ta ripërtërirë atë me terma të reja të përfshira në materialet bashkëkohore të lexuara, sa herë që do u duhej një gjë e tillë.

Parimi kryesor, pra, ishte t'i mësojmë se si të mësojnë. Për këtë qëllim, veprimtaritë gjuhësore u bazuan në përfshirjen e studentëve në kryerjen e detyrave që do u mundësonin një gjë të tillë. Meqenëse terminologjia dhe nevojat e tyre ndaj gjuhës janë të ndryshme e lindin në mjedisin e punës, ne u përpoqëm që të përforconim bazën e tyre gjuhësore e cila do t'u mundësonte pastaj të futeshin më lehtësisht në fushën e tyre të specialitetit të ngushtë me të cilën do të merreshin në të ardhmen.

Praktikimi i shkrimit në mënyrë të vazhdueshme në kryerjen e këtyre detyrave do t'i ndihmonte të përsërisnin fjalorin e mësuar, ta zgjeronin atë duke mësuar fjalë të reja si dhe t'ia përshtatnin dhe situatave të krijuara në ndërmarrje.

Studentët theksuan se mënyra e shkrimit të një e-mail-i apo dhe e letrave profesionale përbënte një domosdoshmëri për komunikimin e tyre me ndërmarrjet simotra jashtë, apo dhe për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari të përbashkëta me ta. Pra, duke i aftësuar për fushën e tyre profesionale në rrafshin gjuhësor, ata arritën të sjellin në klasë dokumente mjaft të larmishme që e shndërruan orën e mësimit në orë debati e reflektimi mbi terminologjinë e specialitetit dhe llojet e ndryshme të letrave të përdorura në fushën e komunikimit profesional. Nga lexues të materialeve profesionale ata u shndërruan në « shkrues » aktivë në gjuhë gjë që përbënte edhe një nga synimet e hartimit të kësaj kurrikule në fushën profesionale.

Përfundime

Shkrimi mund të konsiderohet si një objekt i vërtetë nxënies. I kombinuar me veprimtaritë e tjera gjuhësore ai ndikon në përforcimin e aftësive gjuhësore. Gjithashtu, ai nxit reflektimin mbi mënyrën se si përdoret gjuha në fusha të ndryshme të veprimtarisë profesionale.

Larmia e metodave të të nxënies: vetëm apo në grup, në klasë apo dhe jashtë saj, përdorimi i internetit, familjarizimi me larminë e shkrimeve në fushën profesionale, kryerja e veprimtarive kërkuese krahas atyre shkruese, ndihmojnë në rritjen e pavarësisë së të mësuarit. Ato e shndërrojnë studentin në një shkruer e përdorues të vërtetë të gjuhës në realitetin profesional.

Në këtë drejtim mbetet shumë për të bërë me qëllim që metodat dhe metodologjia e mësimdhënies në gjuhë të huaj të jenë sa më pranë interesave të studentëve inxhinierë dhe t'i shoqërojnë ata gjatë gjithë jetës.

BIBLIOGRAFIA

- Lehmann, D., English for specific purposes (ESP) et français sur objectifs spécifiques (FOS) : le préalable du contenu préalable ASp la revue du GERAS 15-18 | 1997 Anglais et français de spécialité, ISSN : 1246-8185, Burimi : <http://journals.openedition.org/asp/2938>
- Béacco, J.-Cl. et D. Lehmann (dir.). 1990. Publics spécifiques et communication spécialisée. Paris : Hachette (Coll. F-Recherches et applications).
- Charaudeau P. et Maingueneau D., 2002, Dictionnaire d'analyse du discours, Edition du Seuil
- Hutchinson, T. & A. Waters. 1987. English for Specific Purposes. A learning-centred approach. Cambridge: Cambridge University Press (Coll. New Directions in Language Teaching).
- M. Paci, Sh. Delija, S. Vishkurti, (2014), *The Development of an English for Specific Purposes Curriculum in the Polytechnic University of Tirana*. Burimi: International Journal of Humanities Social Sciences and Education (IJHSSE) Volume 1, Issue 8, August 2014, PP 193-199 ISSN 2349-0373
- Möhn, D., (1984), *Fachsprachen. Eine Einführung*. Tübingen: Niemeyer
- Mohammad Al Towaim, - *Grammatical and Lexical Features of Scientific and Technical Language* referuar më datë 10.07.015:48.
- Munby, J. (1978). Communicative syllabus design: A sociolinguistic model for defining the content of purpose-specific language programmes. Cambridge: Cambridge University Press
- O'Malley, J. M., & Chamot, A. U. (1990). Learning Strategies in Second Language Acquisition. New York: Cambridge University Press.
- Trimble, L. 1985. English for Science and Technology. A discourse approach. Cambridge: Cambridge University Press
- Sheela Rani Simon (2021) *An Integrated Approach to Teaching Language Skills*, IJIRT, Vol. 8 Issue 5, ISSN: 2349-6002. Mund të konsultohet në adresën: https://www.researchgate.net/publication/364374212_An_Integrated_Approach_to_Teaching_Language_Skills

FIGURA E GJERGJ KASTRIOTIT
NË POEMAT E AT BERNARDIN PALAJT

Dr. Karmen Lazri

Departamenti i Gjermanistikës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Shkodrës
"Luigj Gurakuqi"
E-mail: karmen.lazri@unishk.edu.al

Dr. Irena Ndreu

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: irena.ndreu@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në këtë ligjëratë, do sjellim të dhëna nga jehona e figurës së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, në dy poema jo aq të njohura të shkrimtarit dhe folkloristit Ât Bernardin Palaj, shkruar më 1937 dhe botuar më 2005, në Vëllimin-1 të veprave të autorit. Nga ky punim mësojmë se dy poemat, janë ndër krijimet më me vlerë të shkrimtarit Palaj (shkruar në shqip e italisht, 81 vjet të shkuara): e para me 306 vargje, kurse e dyta, me 182 vargje monokolonë dhe evokojnë epopenë e luftërave për liri, që ka bërë në shekuj populli ynë, derisa gëzoi lirinë e pavarësinë, fituar me përpjekje të pareshtura dhe me gjakun e tij, më 1912. Poeti i thur ditiramb qytetit heroik të Vlorës, mbarë kombit shqiptar, bijve të Shqipërisë që ngritën atje flamurin, midis rrebesheve të kohës, rrethuar nga lakmitë grabitëse të armiqve të vendit; Atdhetaria, dashuria për komb e gjuhë, për fusha e male, për historinë tonë të lashtë, që është dëshmuar që nga luftërat me Romën, me sllavë e venecian e sidomos me perandorët osmanë, përshkon si një fill i paprerë gjithë jetën e popullit tonë, mbretëria e të cilit, sipas autorit, mban gjallë unitetin dhe shqiptarësinë, me vetitë më të mira, që e dallojnë midis fqinjëve dhe kombeve të tjera në Ballkan e në Europë. Palaj u këndon kohëve mitike: Lekës së Madh dhe Burrit (Pirros), Teutës trimëshë dhe mbretërve ilirë që nuk iu dorëzuan Romës e legjioneve të saj, duke u ngjitur në male, për t'u mbrojtur dhe për të ruajtur ç'kishin më të shenjta: gjuhën, lirinë dhe traditat e bukura arbërore.

Qëllimi ynë, në këtë shkrim, del në pah aq dukshëm, sepse krijimtaria e shkrimtarëve tanë të gjysmës së parë të shekullit të kaluar (edhe përpara), i kanë

sjellë emrin dhe bëmat e Kastriotit, duke i vënë në qendër të frymëzimit të tyre, njëkohësisht për të rritur krenarinë kombëtare, për t'i nxitur bashkëkombësit drejt udhës së bashkimit dhe përparimit, si kombet e tjera. Metoda e përdorur nga autoret e kumtesës, është krahasimi i emrit dhe veprës së pavdekshme të Heroit Kombëtar me figura të shquara të historisë shqiptare, para dhe pas tij, deri kur u krijuan këto dy poema.

Fjalët çelës: flamur, Gjergj Kastrioti, ngjaje jetike, historike, folklor, traditë, etj.

ABSTRACT

In this lecture, we will bring data from the echo of the figure of the National Hero, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, in two not so well-known poems of the writer and folklorist Ât Bernardin Palaj, written in 1937 and published in 2005, in Volume-1 of the works of the author. From this paper we learn that the two poems are among the most valuable creations of the writer Palaj (written in Albanian and Italian, 81 years ago): the first with 306 verses, while the second, with 182 monocolon verses and evoke the epic of the wars for freedom, which our people have done for centuries, until they enjoyed freedom and independence, won with tireless efforts and with their blood, in 1912. The poet salutes the heroic city of Vlora, the entire Albanian nation, the sons of Albania who raised the flag there , among the torrents of time, surrounded by the rapacious greed of the country's enemies; The patriotism, the love for nation and language, for fields and mountains, for our ancient history, which has been witnessed since the wars with Rome, with Slavs and Venetians and especially with the Ottoman emperors, runs like an unbroken thread throughout the life of our people. whose kingdom, according to the author, keeps unity and Albanianess alive, with the best qualities that distinguish it from its neighbors and other nations in the Balkans and Europe. Palaj sings of the mythical times: Leka the Great and the Man (Pyrros), the brave Teuta and the Illyrian kings who did not surrender to Rome and her legions, climbing the mountains, to protect and preserve what they had most sacred: language, freedom and beautiful arboreal traditions.

Our purpose, in this writing, stands out so clearly, because the creativity of our writers of the first half of the last century (even before), have brought the name and deeds of Kastriot, putting them at the center of their inspiration, at the same time to increase national pride, to encourage fellow nationals towards the path of unification and progress, like other nations. The method used by the authors of the statement is to compare the name and the immortal work of the National Hero with prominent figures of Albanian history, before and after him, until these two poems were created.

Keywords: flag, Gjergj Kastrioti, vital, historical, folklore, tradition, etc.

Hyrje

Bernardin Palaj

(1894-1947)



Palaj ka qenë klerik dhe studiues e mbledhës i epikës legjendare. Lindi në Shkodër, në një familje prej Shllakut të Dukagjinit. Mori mësim në shkollën e fetërve françeskanë dhe në seminarin e tyre në Shkodër. Vijoi studimet në Austri, ku kreu liceun në Salsburg, kurse studimet e larta për filozofi e teologji në Insbruk.¹ Për t'u njohur më thellë me trashëgiminë letrare të B. Palajt, duhet vështruar zë për zë botimi i françeskanëve shqiptarë, në përmbledhjen "Vepra", Vëllimi I, Botimi II – Nën kujdesin e studiuses së njohur Angela Cirrincione.² Pjesa më e madhe e krijimeve të Palajt vjen në shqip e italisht. Prej tij trashëgojmë një fragment të titulluar "Prej burgut të jetës", me 245 vargje; fragmentin e gjatë me 1530 vargje "Valët e një shpirtit" – vepër e pabotuar me të njëjtin titull, një tregim historik në 8-rrokësh; "Moskë – Alkazar", me 890 vargje; "Vorreve të Flamurit", me 305 vargje; "Kuç e Zi", me 180 vargje; novelen ilire në vjershë "Ndërmjet të Shën Gjergjave", me 1180 vargje; oden heroike "Kah nata e vetme", me 1180 vargje. Në shtojcë (Appendice) mbyll vëllimin poezia meditative me titull "E Diellja e Larit n' Aventin", me rreth 150 vargje.³ Shtojmë se për këtë shkrimtar

1. ASHSH, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar-3*, Tiranë 2009. (Autori i zërit të Palajt, poeti Ndoc Papeleka, vijon më gjatë për personalitetin e këtij folkloristi: "Më 1918, Palaj u shugurua meshtar; u burgos në vitin 1924, sepse kundërshtonte rikthimin e Zogut në Shqipëri. Palaj iu kushtua mbledhjes së epikës legjendare nga vitet 1919-1934, të cilën e kurorëzoi me botimin e vëllimit "**Kangë kreshnikësh dhe legjenda**" (1937) të serisë së njohur *Visaret e Kombit*. Shkroi: "**Doke e kanu në Dukagjin**"(1942), "**Mite, besime e legjenda**"(1943), "**Kanuni i maleve**"(1944). Palaj hartoi edhe poezi. Në vitin 1944 u kthye me shërbim në malësi, ku u arrestua më 1946 dhe ndërroi jetë në burg. Në vitin 2005 u botuan në Shkodër: "**Vepra**" vëll.I, ku janë përmbledhur krijimet e tij poetike: "**Prej burgut të jetës**" (1933), "**Kuç e Zi**" (1937), "**Ndërmjet Shëngjergjave**" (1938), etj.

2. Biblioteka Françeskane "At Gjergj Fishta"- Kolana e shkrimtarëve françeskanë, At Bernardin Palaj, *Vepra, Vëllimi I, Botim II – Nën kujdesin e Angela Cirrincione-s*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.

3. L'*Aventino* è uno dei sette colli su cui viene fondata Roma, il più a sud. Si tratta di una collina di forma più o meno trapezoidale, dalle pendici ripide, che arriva a sfiorare il Tevere. Tra i sette colli era quello più isolato e di accesso più difficile. Verso est, tramite una sella, è collegato a un altro piccolo colle, chiamato "**Piccolo Aventino**". La sua altezza massima è di 43 m.

françeskan, është hartuar një monografi. Ndër të tjera, shkruhet për Palajn nga poeti Alfred Çapaliku,⁴ një karakterizim brenda një distiku:

*“Palaj mori në popull diçka
Pastaj i ktheu atij gjithçka.”* (f.3)

Mësojmë gjithashtu, që franseskani B.Palaj, përveçse folklorist e poet, ka qenë edhe muzikant, muzikolog dhe etnograf.

Personaliteti i autorit

Kreth personalitetit të këtij shkrimtari do të na mjaftonin disa sekuenca vlerësimi, nga përkthyesi i veprës së tij prej italishtes dhe atij që bëri Biografinë në Hymje (f. I) Willy Kamsi: *“Si Fishta edhe Palaj meritonte që qyshse ishte gjallë të gëzonte kunorën e vet prej lári.”* Vetë Palaj pat deklaruar kredon e vet atdhetare, duke u shprehur: *“Do të tërhiqem në një famulli të maleve të mija të dashuna dhe aty ku mbahen gjallë fryma e Shpirti arbnuer, në kontakt me popullin e thjeshtë, do të vijoj punën e nisun tash sa e sa vjetë, tue e gjurmue në historin, në folklore e sidomos në Kanunin. Do të përplotsoj e do të sistemoj rapsodit, qi unë i kam mbledhë me kujdes tash sa kohë.”*⁵ Mbi të gjitha Palaj është poet, sipas shkollës klasike, me frymë të ngrohtë romantike...por edhe në prozë, si në poezi, dallohet se si kultura e tij e gjanë klasike e modern në talentin e tij të rrallë poetik e muzikor ta ketë ngritë stilin e tij në shtresat ma të nalta të artit... *“Njohja e mirë e latinishtes dhe e gjermanishtes bane që fjalinë ta ndërtonte me pështjellje të gjana në trajtë përdredhoreje, të ndërtueme mire harmonishëm, që përfaqësojshin një risi në stilin shqiptar. Ndër palët e kësaj sintakse, të mbërthyeme fort e plot drejtpeshim në frymëmarrjen e gjanë të shtrimjes së saj të lakueme në dredha të guximshme, ai shkapërderdhte xhevahiret e fjalorit të thjeshtë e të gjallë të Dukagjinit, trevës malore prej së cilës vinte.”*⁶ Rapsoditë e alpeve shqiptare të mbledhuna prej Palajt te *Visaret e Kombit* vijnë prej zemrës së Dukagjinit, aty ku rapsodët që i këndojnë, në motërzimet ma të bukura të këtij qerthulli që gjinden ndër shqiptarë, nuk dijnë kurrnji fjalë slave, nuk dijnë zanafillen historike të Mujit dhe e shndërrojnë skajin turk të përdorun në Bosnjë....Palaj qe terhjekë sidomos prej historisë së popullit të vet e prej folklorit të maleve. Në ta dallonte gjallëninë e fisit,

4. Çapaliku, Alfred. Bernardin Palaj - **Jeta dhe veprat** (Monografi), Shtypshkronja “Shkodra”, Shkodër, 1999.

5. Palaj, Ât Bernardin. **Vepra**, Vëllimi I, Botimi II, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f. II.

6. Po ai, po aty, f. XII.

vijueshmëninë e races ilirike, forcën e kombit. Prandej me entuziazmin e një shkencatari plot gjakim, i kushtoi pesëmbëdhjetë vjet mbledhjes së kangëve shqiptare, tue jetue me popullin e tue përballue ravajë e të hjekuna jo fort të lehta. Por caku i tij ishte një: me u zbulue Shqiptarëve *Visaret e Kombit* me bukurinë e pastër e të mrekullueshme të rapsodive deri n'atë kohë të padijtuna ose të mbajtuna si të pavlerë.

Për poezinë e B.Palajt, duhen vënë në dukje disa karakteristika: së pari, poetika e tij është e gjitha aq klasike dhe si e tillë, s'ka aq shumë hapësirë për frazeologji, për lokucione, fjalë të urta, endiada e aforizma. Shkruhet se ai, mbi të gjitha asht poet original, i fortë në gjasim të stilit të Carducci-t. E dyta, shumica e krijimeve të tij janë me një metrikë tepër korrekte, midis të cilëve është mjaft e vështirë përfshirja e njësave frazeologjike dhe atyre paremiologjike....Aty-këtu përgjatë vargjeve, Palaj provon me sukses të përfshijë disa sentenca a thënie të plota nga Bibla, me fjalët e Mesisë, siç gjejmë në f.36, shtrirjen përgjatë tercinës të thënies më poshtë:

“Shî at ligjë, qi për themel ç’do shoqni ká,
E cilla urdhnon: “Per në daç keq mos me ngelë,
“O njeri mos ban shka ty s’don kush me ta bâ!”

...Natyrisht, ndihmesën më të madhe për ruajtjen e visarit kombëtar: pasurinë e gjuhës popullore, B. Palaj me sivëllain e tij Donat Kurti, do ta japin në gjurmimin, mbledhjen e regjistrimin e Eposit të Veriut, Ciklit të Kreshnikëve.

Pa dyshim që kur bëhet fjalë për autorë si B. Palaj, nuk mund të kërkohet një vend në rrymat a grupet letrare që kanë përshkruar letërsinë shqiptare, nga fillimet e saj deri më sot. Kjo vlen edhe për mjaft shkrimtarë të tjerë, që kaluan në harresë për arsye që dihen dhe nuk do të ndalemi në këtë kumt tonin. Pjesa më e madhe e krijimtarisë së këtij poeti e studiuesi folklorist u prodhua përgjatë asaj periudhe që është quajtur Letërsia e Pavarësisë, një kohë kur arti ynë i fjalës njohu pena aq të fuqishme: nga Gjergj Fishta e Ali Asllani, nga E. Haxhiademi dhe Ndre Mjeda, Ernest Koliqi e Migjeni, etj. Përgjithësisht, duhet shënuar se edhe në këtë kohë ka pasur përfaqësues të romantizmit, që ishte rryma kryesore e letërsisë shqiptare gjatë Rilindjes Kombëtare, ose janë shkruar vepra romantike. Njëri prej tyre është At B. Palaj, për të cilin kemi bërë objekt vështrimi gjuhësor dy poema të tij “*Vorreve të Flamurit*” dhe epopenë “*Kuq e Zi*”. Për temën që kemi vënë në fillim, themi se frymëzimi nga figura e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti,

përkshkon si fill i vetëm të dy krijimet në vargje të këtij autori. Studiuesit tanë të njohur vënë në dukje se *poezia jonë patriotike në përgjithësi është mbështetur më shumë mbi emrin e Skënderbeut, sesa mbi çdo emër tjetër apo ngjarje të rëndësishme,...i këndojnë shëmbëlltyrës së Skënderbeut, duke i kënduar pavarësisë, lirisë, dinjitetit dhe krenarisë kombëtare, shkruan prof. Rexhep Qosja.*⁷ Kështu, që në vargjet e fillimit të poemës së parë, del emri i Heroit tonë Kombëtar, që kishte qenë motivi kryesor i luftës për pavarësi kundër perandorisë osmane, edhe me rastin e Ditës së Flamurit, 28 Nëntor 1937, kur u botua kjo poemë:

“Qe pra, ja mrritme sot edhe ksajë ditë,
Diellin mbi Flamur t’lirë me e pa tuj shndritë
Porsi n’Deçiç e n’Vlonë;
Ku krezhnikët t’anë e bane me valëvitë
Neper flakë topash mbi tokë t’Skanderbeut...”

E zanin ia dhamë dheut,
Mal e fushë per mbas Vlonet tuj brohoritë
“T’vedit sot jem!Rrnoftë pamvarsija jonë!”
Njizet e tetë Nanduer!
Ma e lumja ditë, shejmire e me oguer.”

Në tre plane na vjen figura e Luanit të Krujës, quajtur poetikisht nga autori:

Gjergj - Skanderbeg - Kastriot

a). Si vazhdues i bëmave heroike e legjendare të mbretit të Epirit, Pirros (Burrit), Konstandinit të Madh që paskësh folur shqip, Lekës së Madh (Aleksandrit), me origjinë ilire, Teutës krenare dhe mbretërve të panështruar të Ilirisë së lashtë; *fisit të lashtë pellazg - iliro – trak*, kohë së cilës në epopenë e Flamurit, i këndohet:

“Shqyp t’u fal Pelazgu i motit Po n’ket gjuhë Shqyptari i sotit,
Tuej thur kodrat me germadhe; Si n’Dodonë ty sot t’kndon valle...”

b). Si Zot i Motit të Madh për gjithë shqiptarët: periudha e lavdisë së Gjergjit, me bashkëluftëtarë si Lekë Dukagjini, Mojs Golemi:

7. Qosja, Rexhep. **Panteoni i rralluar- Studime, kritika dhe ese**, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988, f.

*“Kualt prej Rromet turku i solli, Por s’u thye Gjergj Kastrijota
Ra Stamolla u thye n’Varnë bota, Der që deka e rrxoi n’vorr.”*

c). Lavdia e Tij ka frymëzuar një popull drejt lirisë, që u arrit më 28 Nëntor 1912, kohë festive që thërret për të formuar shqiptarët, prandaj dhe poemat e Palajt kanë mjaft emra luftëtarësh dhe njerëzish me vizion, si:

*“Po, edhe t’deknit n’vorre u gzuene Pse ajo Vlona e Smajl Qemalit
Per ket ditë, qi i erdh Shqypnis; Gzoi shka kje, edhe gurt e malit,
Bjeshkë e n’bjeshkë Malcit ushtuene Lumnoi mik – mjeroi anmik.”
Prej kushtrimit t’ditës s’liris; (Kuç e zi, f. 180)*

Ky vështrim për figurën dhe lavdinë e Skënderbeut në letërsinë shqipe, në krijimtarinë e Palajt, natyrisht nuk mund të bëhet i njëjtë edhe për autorë të tjerë bashkëkohës të tij, megjithëse u krijuan edhe vepra që emrin e Heroit e kanë edhe në titull, si Haki Stërmilli, që botoi romanin “Kalorësi i Skënderbeut”, apo Koliqi me poemën italisht e shqip “Kangjellat e Rilindjes”. Studiuesi i kësaj periudhe të letërsisë shqiptare, Ali Xhiku ka vënë re se *romantizmi ynë, edhe pse nuk e pasqyroi deri në fund drejt epokën e Skënderbeut, krijonte tek lexuesit përshtypje të gjalla mbi madhështinë e saj, mbi vitalitetin e shqiptarit, mbi karakterin e tij, që dallohej, në radhë të parë nga dashuria për lirinë e atdheut.*⁸

Është një meritë dhe aftësi e autorit që brenda vargjeve të këtyre krijimeve poetike ka përshkruar edhe parahistorinë e një populli, periudha që mund t’i emërtojmë edhe si më poshtë:

Kohët mitike legjendare:

Zanat arbnore, Shtojzovalle, Pelazg, fis pellazg iliro-trak, Butrinti, Dodona, Shkodra, Kaçaniku, Vlona, Fushë-Kosova, Dardhane e Kostantinit, Perandori ilir Dioklecjani, Leka, Burri, Teuta, Muji, Gjin Bue Shpata,

Nga Epika mitike greke: Troja, Pellazgët, Thrakët, Andromaka, Hektori, Salona,
Historia e shqiptarëve ka qenë luftë qëndrese, gjatë së cilës lavdia u takon ilirëve në luftën me Romën krenare, periudhë që autori e vesh aq bukur gjuhësisht, sa na duket se shohim betejat e përgjakta, ku nuk mungojnë as disa shfaqje mjeshtërie poetike, siç është dukuria

8. Xhiku, Ali. Romantizmi arbëresh, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980, f. 158.

l'enjambement (tejkalim), kur kuptimi leksikor i vargut duhet të kapërcejë në vargun vijues, si:

“Po, ata Ilirë, qi n’prânga arit
Rroma n’Shkodër t’i pat lidhë,
Rrethue ballin n’ keza larit,
Bâne botën kta me u dridhë,
 Mun preje frontit t’Rromës krenare
 Tuj vû ligje e tuj pre pare,
 Tokët e Rromës tu’i dâ nder miq.” (f. 184)

Ose:

<p> “Zjarm muer toka at herë Shqyptare, N’Sul t’janinës e n’Urë Tamare, Plasi puska per gjith vend; (f.186) </p>	<p> Zjarmin marë ja dham’Ballkanit; Terbue Shkjau, <u>nett e zijanit</u> Bâni m’Turk, por n’Vlonë u ndal.” </p>
--	---

Kohë e Kastriotit.

Flamur i Kastriotit, Ushtari i Krishtit, Mois Golemi, Lekë Dukagjini, burrat si motit, Ded Gjo’Luli, Mehmet Shpendi, Zef Harapi, Llesh Nikë Daka, zani i Skenderbeut,


Kohë e pavarësisë:

S. Qemali, Gurakuqi, Mexsi Plak, Isa Boletini, Tomsoni trim, Çerçiz Topulli,

Vendosmëria shqiptare:

“Se pa u shue krejt Berlin e Vjenë e Rromë,/
 S’e lëshojmë ket Flamur, n’kjoshti gjallë si kombë.”(f. 170)
 Kuer një Hasan Riza,
 Turk, por krezhnik – pleqni e kishte bâ
 Me një Serreq e Fishtë, mun n’ “Tarabosh”
 Flam’rin e Skanderbeut
 Me e ngulë atje e n’ “Kala”! (f. 172)

Ndërton poeti një strukturë sintaksore polindromi, që krijohet mes foljeve: “rrâni dhe dy foljeve “tuj britë” dhe “asht”, duke përfshirë në mes emra familjesh të shquara, apo emra vendesh ku nënkuptohen popullsitë e tyre shumë luftëtarë:



“Tuj britë n’kushtrim te shpija si n’at Vlonë:
 “Asht tokë per Flamur ktû; asht toka e jonë!”

Pranë të gjitha këtyre pasazheve vjen e përsëritet emri i Skënderbeut, njëherësh me Gjergj dhe Kastriot, por edhe në struktura sintagmash, si: *hija e Skenderbeut, toka e Skenderbeut, zani i Kastriotit, Gjergj Kastrijota, eshtnat e Skanderbeut, rreftja e Zotit – Gjergj Kastriotit, tokë e Kastriotit, Flamuri i Gjergjit, nana e Skanderbeut, etj.*

Përballë historisë sonë, vëren poeti, kemi pasur jo vetëm fqinjët grabitës të tokave tona, por edhe tradhtinë – përfaqësuar këtu, në kohët më kritike të ekzistencës së popullit shqiptar – me emrin e Esat pashë Toptanit, përherë në përballje me qëndresën e pareshtur të bijve më të mirë të shqipes. Palaj ka arritur të tregojë se tradhtia peshon aq rëndë sa dhe sulmet me bajonetë dhe armë zjarri :

“Por, a ka burrë, qi i thotë Shqyptarë sot vedit
E e ngulë ket Flamur n’Vlonë, n’at skele detit,
Nder bajoneta t’Grekut e t’Serbianit...?”
Per ndryshej, ju coptuen Shkjet e Ballkanit!” (f. 168)

U pî Junani, Serbi e Mali i Zi
...nji Esad...gjakbâs sa trathtar...
Shpirti i ktij nieri, qi u end n’per Shqypni,
Porsi aj Judi n’at Jallin e tij!
Ky, qi guxoi me hjeksue kombe e mret
E nji Shkjaut me ja shitë kombsin e vet...! (f. 172)
“Shkjaut – dyndë Uralesh...” (f.184)

Në një plan tjetër vështrimi, veç figurave legjendare e historike, mitike e përrallore, poemat që kemi sjellë për të ndriçuar figurën e Heroit tonë Kombëtar, (pa u shmangur këtu në figuracionin letrar), të bie në sy e të rrëmben veshja gjuhësore, që nga leksiku – me poetizimin e fjalës, fjalëformimi, bashkimet në sintagma dhe fjalitë e frazat poetike, që dallohen me ndërtimet e kërkuara nga vargu me ligjësitë e veta, që këtu vijnë të lira, pa masa metrike, por me rendin dhe theksat e qëlluar, **si:** *dielli mbi flamur, neper flakë topash, i dha zanin dheut, , ditë shejemirë, ditë me oguer, tuj peshue me arrsyë, kohë e kangve, kohë e rângve (punëve), krip i bardhë, kokërr rrëfeje, zëmra m’mer valë, shtyhem nder fjalë, zëmra ndrÿ, zëmra vorr, vatra vorr – rrethue me shkje, folsha nder Rmâj, la me gjak e lot (toka), ma t’keqin pleh Azije, zojë e detit; me endiada: t’bajë me u endë, bane me valvitë, bân me nxê, u tranden malet, kerclluen dhâmët, t’u fik zemra; bashkime me rend të përmbysur: n’ma t’vshitirat kohë, ma e lumja ditë; ma t’flligjten lojë, n’ma t’vshitiren ditë, i Madhi Turk, ma t’paren herë, fatamire Shkodra, ma e lumja shoqe, ma t’ngushten ditë, n’mâ t’bukuren pranverë, e ngrata Shqipni, fatbardha moj rini; tokë me orë (me fat), n’per flakë topash, alemi e polemi, etj.*

Përfundime:

Pas kësaj paraqitjeje, ne mund të radhisim disa konkluzione të temës sonë, lidhur me pasqyrimin e figurës së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, në dy poema të shkrimtarit Bernardin Palaj; *së pari*, duke treguar se Biri i Madh i Krujës, ka lindur në një truall lavdie, ashtu siç e sjell autori në vargjet kushtuar Pelazgëve mitikë:

<i>“Marë Europa djerre e shtoje</i>	<i>Tuj quejtë, s’parit, tokë e dete,</i>
<i>Qysh prej lindjet e n’prendim,</i>	<i>Tuj ngrehë kodrave gjytete,</i>
<i>Kuer Pelasgu prej Fushës Troje</i>	<i>Vetë zot shprijet n’Eurpöë t’vet.”</i>
<i>Shkepte Thrakt e Ilirët mallim,</i>	(f. 182)

E dyta, theksojmë se autori është njohës aq i mirë i historisë shqiptare, sa ia arrin ta sjellë atë në vargje, me një veshje gjuhësore dhe figurative mjaft të qëlluar.

Së treti, duke ravijëzuar këtë histori qëndrese të popullit tonë, poeti ia del të mos shkëputet asnjëherë nga jehona a zëri i Gjergj Kastriotit, lavdia e të cilit i ka çuar shqiptarët drejt lirisë dhe pavarësisë kombëtare. *Së katërti*, në dy poemat vihet në dukje se nuk ka qenë vetëm kërkimi i lirisë që e ka ruajtur dhe mbajtur shqiptarizmin, por edhe tregues të tjerë historikë dhe etnografikë, ku vendin e parë e ka zënë gjuha shqipe.

E pesta: në këto pak përfundime, nuk mund të lëmë jashtë edhe leksikun e pastër, shprehjet e goditura dhe stilemat poetike që e dallojnë midis tjerësh stilin e shkrimtarit Bernardin Palaj.

BIBLIOGRAFI

- ASHSH, **Fjalor Enciklopedik Shqiptar-3**, Tiranë 2009.
 Çapaliku, Alfred. **Bernardin Palaj - Jeta dhe veprat** (Monografi), Shtypshkronja “Shkodra”, Shkodër, 1999.
 Palaj, Ât Bernardin. **Vepra, Vëllimi I**, Botimi II, Botime Françeskane, Shkodër, 2005, f. II.
 Qosja, Rexhep. **Panteoni i rralluar- Studime, kritika dhe ese**, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1988.
 Xhiku, Ali. **Romantizmi arbëresh**, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1980.

VLERËSIMI DHE RËNDËSIA E METODËS SË RIVLERËSIMIT NË PROCESIN E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS GJERMANE NË SHKOLLAT SHQIPTARE

Msc. Arsilda Aliaj

Departamenti i Gjuhës Gjermane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: arsilda.aliaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky artikull analizon një metodë inovative të vlerësimit në procesin e mësimdhënies, me theks të veçantë në zhvillimin e njohurive të gjuhës gjermane në shkollat shqiptare. Metoda përdor një qasje të testimit dyfazor, fillimisht një test me shkrim dhe më pas një fazë të dytë të ritestimit, duke siguruar një mundësi për nxënësit për të korrigjuar gabimet dhe për të përmirësuar rezultatet e tyre. Bazuar në të dhënat e një rasti studimi konkret, ky artikull argumenton se ky proces i rivlerësimit ka ndikim pozitiv në përmirësimin e vlerësimit, stimulimin e përpjekjeve të nxënësve dhe eliminimin e pengesave në mësimdhënie. Përmes analizës së notave, grafikeve dhe përfshirjes së koncepteve të vlerësimit, demonstroi se kjo metodë mund të jetë një mjet efikas për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit në kontekstin e mësimit të gjuhëve të huaja.

Fjalët çelës vlerësim, rivlerësim, mësimdhënie, teste, matje.

ABSTRACT

This article analyzes an innovative assessment method in the teaching process, with a particular focus on the development of German language skills in Albanian schools. The method employs a two-phase testing approach, initially a written test and then a second retesting phase, providing an opportunity for students to correct errors and improve their results. Based on the data from a specific case study, this article argues that this reevaluation process has a positive impact on assessment improvement, stimulates students' efforts, and eliminates barriers in teaching. Through the analysis of grades, graphs, and the incorporation of assessment concepts, it demonstrates that this method can be an effective tool for enhancing the teaching and assessment process in the context of foreign language learning.

Keywords: *assessment, reassessment, teaching, tests, measurement.*

1. Përkufizime

Një nga fazat kryesore të procesit të mësimdhënies pa dyshim është vlerësimi. Përmes procesit të vlerësimit, bëhet e mundur përcaktimi i nivelit të përftimit të njohurive nga studentët. Ky proces gjithashtu thekson cilat pjesë të informacionit janë më të lehta për t'u përfshirë dhe cilat janë më të vështira, si dhe krijon mundësinë për të zbatuar metoda të reja mësimore me qëllim eliminimin e pengesave në mësimdhënie. Në mungesë të informacionit të përftuar nga procesi i vlerësimit, nuk mund të flitet për përmirësim të procesit të mësimdhënies. Për shkak të rëndësisë së procesit të vlerësimit, mendojmë se përmban vlerë shtesë çdo metodë që synon përmirësimin e këtij procesi. Në këtë artikull do të argumentohet efektiviteti i një metode testimi sipas së cilës, fillimisht studentëve u paraqitet një test me shkrim, dhe pas përfundimit të tij dhe nxjerrjes së rezultateve, atyre u jepen ushtrimet e zgjidhura të testit dhe në një orë mësimore të ardhshme u paraqitet përsëri i njëjti test. Kjo metodë testimi është bazuar në metodën e memorizimit.

Vlerësimi i njohurive të përvetësuara nga nxënësit ka qenë një pjesë e rëndësishme e sistemit arsimor për një kohë të gjatë. Tradicionalisht, kontrollimi i njohurive kryhej përmes provimeve me shkrim, me gojë dhe testeve. Definimi i termave¹ tregon se kontrollimi i njohurive të përvetësuara nga nxënësit në shkollë kryhet tradicionalisht përmes provimit me shkrim, me gojë dhe testeve. Testet e mira, krijuar nga mësuesit, shërbenin për të vlerësuar se sa mirë ishin arritur objektivat e caktuara dhe si po zhvillohej procesi i mësimdhënies.

Vlerësimi duhet të shihet si një proces i lidhur ngushtë me mësimdhënien dhe nxënien dhe duhet të jetë kryesori i këtyre dy proceseve. Ngushtë lidhur me vlerësimin është procesi i vetëvlerësimit, për të cilin do të përqendrohemi në këtë artikull.² Një pjesë e rëndësishme e vlerësimit lidhet me procesin e vetëvlerësimit. Termi "vlerësim" vjen nga greqishtja "assedere" dhe do të thotë "të ulësh pranë dikujt", duke i dhënë një gjykim apo duke vlerësuar vlerat e një personi, procesi apo programi. ³ Musai dhe Mita kanë përkufizuar vlerësimin si vendosjen e një vlerë gjykimi mbi atë që është matur, ndërsa disa e perceptojnë atë si një gjykim të cilësisë. Duke studiuar rëndësinë e vlerësimit ata kanë arritur

1. Musai, "Psikologji edukimi" 1999

2. Bushi, Jonida, Ema Kristo „Bewertung und Selbstevaluation in der Lehre“, Balkan Journal of Interdisciplinary Research, Vol 7, No. 1 Graz-Austri 2021.

3. Muho, Efektet e mënyrave të ndryshme të vlerësimit në motivimin e nxënësve gjatë përvetësimit të gjuhës së huaj" Tiranë, 2015

në këto dy përkufizime: “Vlerësimi nënkupton vendosjen e një vlerë gjykimi mbi atë që është matur.”⁴ dhe “Disa e perceptojnë atë si një gjykim të cilësisë”⁵

Në përdorimin e fjalorit të gjuhës gjermane, vlerësimi do të thotë “bewerten, mit einer Note versehen”, që përkthehet si “të vlerësosh, të japësh një notë”. Kjo notë, e cila shpeshherë quhet shpërblim, është një mjet për të vlerësuar punën e mirë të nxënësve në përvetësimin e njohurive.

Gabimet, pavarësisht se janë performative ose lidhen me kompetencat, mund të ndikojnë në procesin e vlerësimit. Ato klasifikohen në gabime fonetike, leksikosemantike, morfologjike-sintaksore dhe gabime pragmatike.⁶ Identifikimi i këtyre gabimeve është i rëndësishëm për të kuptuar se si një nxënës po përparon në përvetësimin e njohurive

Në përfundim të procesit të vlerësimit, kemi matur gjithashtu. Termat matje dhe vlerësim janë përdorur shpesh here në vend të njëra-tjetrës, por nuk janë sinonime. Në literaturë gjejmë përkufizime pothuajse të njëjta lidhur me matjen. Kjo duket e qartë në vijim:

“Matja në kuptimin e përgjithshëm është procesi i krahasimit të një sasi të njohur me një sasi të panjohur për të fituar informacion për sasinë e panjohur.”⁷

“Matja është sasia e njëjësive dhe vendosja e një numri mbi atë që kryen apo përfundon një nxënës.”⁸

Procesi i vlerësimit është një proces që zgjat në kohë. Nxënësit janë në një garë imagjinare të vazhdueshme me veten, me njohuritë e tyre për të arritur në një vlerësim sa më të lartë të njohurive të tyre të konvertuar në nota. Notat janë të ashtuquajturat shpërblime për punën e mirë të bërë në përvetësimin e njohurive. Notat, të cilat kanë një vlerë të jashtëzakonshme dhe sa më të larta të jenë, aq më shumë mundësi ofrojnë për cilindo. Sa herë që merremi me trajtimin e funksionit të notave, ato analizohen si nga ana cilësore, po ashtu dhe në anën sasiore. Përmes këtij procesi të gjatë dhe të vazhdueshëm, mësuesit masin dhe vlerësojnë në sasi dhe në cilësi njohuritë e nxënësve.

4. Musai, “Psikologji edukimi” 1999

5. Mita, “Vlerësimi në arsim” 2009

6. Kleppin, Karin, Fehler und Fehlerkorrektur. Berlin, München, Wien, Zürich, New York: Langenscheidt.1998

7. Mita, “Vlerësimi në arsim” 2009

8. Musai, “Psikologji edukimi” 1999

Sipas Musait ⁹, tre janë qëllimet kryesore kur mësuesit vlerësojnë nxënësit:

Të formulojnë vendime specifike për çdo nxënës ose grup nxënësish.

Të drejtojnë planifikimin e tyre mësimor dhe, si rrjedhojë, veprimtaritë me të gjithë klasën.

Të kontrollojnë sjelljen e nxënësit.

Siç mësuesi vlerëson nxënësin për dijet e fituara gjatë procesit të mësimit, gjatë testimet e ndryshme ai vlerëson dhe punën e tij. Testimi bën që nxënësi të qëndrojë pak më gjatë para librave për të provuar suksesin në provim. Kjo kërkon pa diskutim shumë vullnet dhe durim. Në të njëjtën kohë, testimi diagnostikon vështirësitë që kanë nxënësit në procesin e të nxënës dhe është një mjet përmes të cilit diagnostikohen shumë pika kyçe të mësimdhënies.

Gabimet konsiderohen si tregues të dukshëm të problemeve të kuptimit ose zbrazëtirave të njohurive, kështu që shpesh herë lidhen me emocione negative nga nxënësit. Megjithatë, nëse situatat e gabimeve lidhen kryesisht me emocione negative, ato nuk perceptohen nga nxënësit si mundësi për të mësuar; kështu, potenciali mësimor i situatës së gabimit mbetet i pakapërcyer. Megjithatë, trajtimi i përshtatshëm i gabimeve nuk karakterizohet nga një mungesë absolute e emocioneve negative në situatat e gabimeve. Një shkallë modeste e emocioneve negative mund të nxisë përqendrimin e nxënësve në gabimin e bërë dhe përpjekjen për ta korrigjuar. Megjithatë, duhet të zbatohet parimi i mos-frikësimit.¹⁰

2. Llojet e testeve

Interesi për format e vlerësimit në mësimin e gjuhëve të huaja vitet e fundit ka rritur në mënyrë të dukshme; kjo vlen për provimet e standardizuara të diplomës ashtu edhe për vlerësimet e nivelit të gjuhës. Mësuesit duhet të jenë të njohur me parimet teorike të vlerësimit dhe në të njëjtën kohë duhet të fitojnë njohuri konkrete dhe të kuptueshme për shembuj dhe implementime, në mënyrë që të jenë në gjendje të krijojnë dhe vlerësojnë formatet e detyrave dhe testeve për aftësitë dhe

9. Musai, "Psikologji edukimi"1999

10. Kleppin, Karin, Zum Umgang mit Fehlern im Fremdsprachenunterricht. In: Jung, Udo O. H. (Hg.), Praktische Handreichung für Fremdsprachenlehrer, 6470. 4., vollständig neu bearbeitete Auflage. Frankfurt a.M./Berlin/Bern/Brussel/Neë York/Oxford/Wien. 2006

kompetencat e ndryshme gjuhësore¹¹. Procesi i vlerësimit të nxënësve shfaqet në disa forma të ndryshme. Për të kryer këtë proces, mësuesit përdorin mjete të ndryshme. Sipas Musait¹², mësuesit zakonisht përdorin katër instrumente tipike të vlerësimit: testet me shkrim, pyetjet me gojë, testet e arritjeve dhe testet standard. Testet mund të përgatiten nga mësuesit vetë, por gjithashtu edhe nga specialistët, pra testet e standardizuara. Në literaturë, gjejmë ndarjen e testeve në teste objektive dhe subjektive.

Sipas Mita¹³, llojet e testeve përfshijnë:

- a) Teste verbale / teste joverbale
- b) Teste të standartizuara / të pastandardizuara
- c) Teste individuale / teste për grupin
- d) Teste të shpejtësisë / teste të fuqisë
- e) Teste objektive / teste subjektive
- f) Teste të njohurive / teste të aftësive
- g) Teste që matin inteligjencën / teste që matin personalitetin
- h) Teste diagnostikuese
- i) Teste që bazohen në norma / teste që bazohen në kritere

Testi ka disa cilësi bazë: objektiviteti, përdorshmëria, besueshmëria, dhe diferencueshmëria¹⁴.

3. Vlerësimi i njohurive të gjuhës gjermane në shkollat shqiptare

Edhe pse lënda e gjuhës gjermane po përqafton gjithnjë e më shumë nga shkollat e ndryshme, duke e implementuar atë si gjuhë të parë ose të dytë, has vështirësi të mëdha në vlerësimin e njohurive të fituara nga nxënësi. Një vlerësim ideal do të ishte ai në të cilin të testoheshin të katër aftësitë (dëgjimi, leximi, shkrimi, dhe të folurit). Por ky është një synim pjesërisht i mundur, sidomos në sistemin tonë arsimor, për të cilin gjithmonë është e rëndësishme çfarë është e shkruar e zezë mbi të bardhë.

11. Barbara Hinger/ Wolfgang Stadler „Testen und Beerten fremdsprachlicher Kompetenzen, Narr Verlag 2018, S. 15-33

12. Musai, “Psikologji edukimi” 1999

13. Mita, “Vlerësimi në arsim” 2009

14. Musai, “Psikologji edukimi” ,1999

Në shkollat shqiptare, sistemi i vlerësimit luajt një rol kyç në vlerësimin e performancës dhe zhvillimit akademik të nxënësve. Metodatat e vlerësimit të përdorura në shkollat shqiptare përfshijnë zakonisht provime, teste, detyra dhe projekte. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se përqendrimi në vlerësim në shkollat shqiptare shpesh ka çuar në një fokus të ngushtë në notat e nxënësve në vend të procesit të përgjithshëm të mësimit. Kjo qasje në vlerësim mund të krijojë një mjedis mësimor me presion, ku nxënësit janë të përqendruar vetëm në arritjen e notave të larta në vend që të kuptojnë dhe aplikojnë vërtet njohuritë dhe shkathhtësitë që kanë fituar. Ky fakt është i mbështetur nga burimi që thotë se modalitetet e vlerësimit kanë ndikimin më të madh në kurrikulën e kuptuar¹⁵ (Perveen, 2021). Për të adresuar këtë çështje, ka nevojë për një qasje më të balancuar dhe holistike në vlerësim në shkollat shqiptare. Kjo qasje e re duhet të konsiderojë jo vetëm notat, por edhe procesin e mësimit, duke përfshirë mendim kritik, zgjidhje të problemeve dhe krijimtarinë.

Në lidhje me sistemin aktual të vlerësimit¹⁶, nxënësit në shkollat ku gjuha gjermane përdoret si gjuhë e huaj e parë ose e dytë nga klasa e VI-XII janë të përfshirë në një proces vlerësimi të përbashkët, i cili zhvillohet në fund të çdo tremujori. Kjo vlerësim përfshin tre komponentë kryesorë:

Vlerësimi i Vazhduar: Nxënësit vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë tremujorit.

Vlerësimi me Test/Detyrë Përmbledhëse: Përfshin vlerësimin e tyre nëpërmjet testeve ose detyrave përmbledhëse.

Vlerësimi me Projekt Kurrikular: Nxënësit vlerësohen për projekte që lidhen me përmbajtjen kurrikulare.

Nëse shohim përqindjet e tyre të përbashkëta, vlerësimi i vazhduar zë 40%, vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse zë gjithashtu 40%, ndërsa vlerësimi me projekt kurrikular përbën 20% të vlerësimit total. Ky proces i vlerësimit përsëritet për çdo tremujor dhe, në fund, llogaritet një notë përfundimtare përmes formulës:

15 Perveen, S. A. A. S. (2021). Critical analysis of pakistan national educational policies of 1992, 1998 and 2009 with special reference to examination reforms in sindh board. *Pakistan Journal of Educational Research*, 4(3). <https://doi.org/10.52337/pjer.v4i3.260>

16 MAS, Udhëzim për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar, 2022

Nota përfundimtare në kasat VI-XII llogaritet në këtë mënyrë:

$$\text{Nota përfundimtare} = (\text{Nota e Vazhduar} \times 0.4) + (\text{Nota e Testit/Detyrës} \times 0.4) + (\text{Nota e Projektit Kurrikular} \times 0.2)$$

Vlerësimet në sistemin shqiptar arsimor në klasat IX-XII variojnë nga 4 (nota më e ulët) deri në 10 (nota më e lartë). Në sistemin gjerman të vlerësimit, notat janë të ndryshme nga sistemi shqiptar. Në vend që të përdoret shkalla nga 4 deri në 10, në sistemin gjerman notat vijnë në një shkallë nga 1 (nota më e lartë) deri në 6 (nota më e ulët). Ky ndryshim mund të jetë sfidues për nxënësit dhe prindërit që vijnë nga një kontekst shkollor tjetër. Prandaj, është e rëndësishme të kuptohet se një notë më e lartë në sistemin gjerman do të jetë një shifër më e vogël krahasuar me shkallën e njohur shqiptare. Për shembull, një notë 1 në sistemin gjerman do të konsiderohej një rezultat shumë i mirë, ndërsa në shkallën shqiptare do të interpretohej si një notë shumë e dobët. Kjo dallim në shkallë mund të ketë implikime në interpretimin e rezultateve dhe në përshtatjen e nxënësve në një mjedis shkollor të huaj.

Në vijim, paraqitet një tabelë lidhur me domethënien që kanë notat në Gjermani.

Tabelle 1: Notenstufen KMK (1968, S.1)

Bezeichnung	Ziffer	Definition
sehr gut	1	Die Note „sehr gut“ soll erteilt werden, wenn die Leistung den Anforderungen in besonderem Maße entspricht.
gut	2	Die Note „gut“ soll erteilt werden, wenn die Leistung den Anforderungen voll entspricht.
befriedigend	3	Die Note „befriedigend“ soll erteilt werden, wenn die Leistung im allgemeinen den Anforderungen entspricht.
ausreichend	4	Die Note „ausreichend“ soll erteilt werden, wenn die Leistung zwar Mängel aufweist, aber im ganzen den Anforderungen noch entspricht.
mangelhaft	5	Die Note „mangelhaft“ soll erteilt werden, wenn die Leistung den Anforderungen nicht entspricht, jedoch erkennen läßt, daß die notwendigen Grundkenntnisse vorhanden sind und die Mängel in absehbarer Zeit behoben werden könnten.
ungenügend	6	Die Note „ungenügend“ soll erteilt werden, wenn die Leistung den Anforderungen nicht entspricht und selbst die Grundkenntnisse so lückenhaft sind, daß die Mängel in absehbarer Zeit nicht behoben werden könnten.

Nëse vlerësimi përmes notave konsiderohet si një objekt për të matur, cilësia e tij vlerësohet duke u bazuar në disa kritere dytësore, ndër të cilat tre kriteret kryesore janë objektiviteti, besueshmëria dhe vlefshmëria. Megjithatë, sipas teorisë klasike të testit, këto kritere përdoren kryesisht në ndërtimin e testeve të standardizuara të performancës shkollore¹⁷.

Në përpjekje për të avancuar vlerësimin dhe për të përfshirë një perspektivë më moderne, një risi që duhet të praktikohet më shpesh në shkollat shqiptare janë testimet online. Pothuajse të gjitha metodat e mësimit të gjuhës gjermane përfshijnë teste online të standardizuara, të cilat matin dhe vlerësojnë nxënësit në lidhje me çështje të ndryshme gramatikore, në fjalor dhe aftësitë e tyre të shkruar. Përdorimi i këtyre testeve online sjell një dimension shtesë në vlerësim, duke përmirësuar përgjithësisht mënyrën sesi vlerësohet dhe ndiqet përparimi i nxënësve. Pa dyshim, realizimi i këtyre testeve kërkon dhe infrastrukturën e duhur, por kjo mund të ofrojë një mjet më të saktë për vlerësimin e aftësive të nxënësve në mënyrë të personalizuar dhe të përshtatshme me nevojat e tyre të mësimit.

4. Kriteret e përzgjedhjes për ushtrimet në një test të gjuhës së huaj

Përzgjedhja e ushtrimeve për të krijuar teste nuk është asnjëherë një vendim i lehtë. Ushtrimet duhet të jenë të tilla që të sjellin ndryshimin midis aftësive të ndryshme të nxënësve. Sipas Goethe-Institut Belgrad: “Të gjitha llojet e testeve, qofshin ato provime formale ose teste të zhvillimit të nxënësve, duhet të regjistrojnë performancën e nxënësve sa më saktë që të jetë e mundur (vlefshmëria e përmbajtjes), ta matin atë në mënyrë sa më të besueshme (besueshmëria) dhe ta vlerësojnë atë në mënyrë sa më objektive.”¹⁸

Kur është fjala për zgjedhjen e ushtrimeve, kujdesemi që ato të jenë të mbyllura, gjysmë të hapura dhe të hapura. Ushtrimet e hapura përfshijnë detyra me shkrim dhe të folur, në të cilat nxënësit udhëzohen në aspektin e përmbajtjes, por kanë lirinë për të përgjigjur sipas kreativitetit të tyre. Në ushtrimet gjysmë të hapura, nxënësit shkruajnë një ose dy fjale ose një fjali të shkurtër, duke përfshirë këtë lloj detyre

17. Langfeldt, Die klassische Testtheorie als Grundlage normorientierter (standardisierter) Schulleistungstests. In K. A. Heller (Hrsg.), Leistungsdiagnostik in der Schule, 1984

18. Goethe-Institut Belgrad, Gütekriterien, URL: <https://www.goethe.de/resources/files/pdf236/serbien-rahmencurriculum-anhang-19-23.pdf>

në testet e kuptimit të dëgjimit. Në anën tjetër, ushtrimet e mbyllura, që janë të destinuar për të kontrolluar njohuritë, kërkojnë nga nxënësit të njohin zgjidhjen e saktë, pa nevojitur të shkruajnë asgjë vetë. Këto detyra përfshijnë shpesh detyra me zgjedhje të shumëfishta ose e vërtetë/false.

Megjithatë, vlerësimi i njohurive të nxënësve në shkolla nuk është gjithmonë një proces i drejtë. Ka nevojë për një përjasje të hollësishme dhe të përpiktë që mësuesit të mund të vlerësojnë nxënësit në mënyrë efektive. Për të përmirësuar këtë proces, mund të ketë hapësirë për rishqyrtim dhe përmirësime në metodologjinë dhe praktikën e vlerësimit nëpër shkolla.

Por në të vërtetë, si zhvillohet testimi i njohurive të nxënësve në shkolla? A arrijnë gjithmonë mësuesit të vlerësojnë nxënësit në formë të duhur? A ka hapësirë për rivlerësim?

5. Rast Studimi : Vlerësimi dhe Rivlerësimi i një Provimi

Eksperienca e gjatë e mësuesve që vazhdojnë të mësojnë brezat e rinj tregon se ka gjithmonë një mënyrë për të inkurajuar nxënësit, ata të cilët në një moment të caktuar nuk kanë arritur të japin maksimumin e tyre, duke përdorur mjete si rivlerësimi për t'u dhënë një shans të dytë. Kjo praktikë ka qenë zakonisht një mundësi e ofruar kryesisht për nxënësit e shkëlqyer, të cilët, megjithatë, mund të kenë hasur sfida në një moment të veçantë të mësimin. Le të eksplorojmë mundësinë që kjo praktikë të zbatohet për të gjithë nxënësit në një klasë.

Megjithatë, synimi i këtij studimi është të kuptojmë avantazhet e riprovimit dhe rivlerësimit si një metodë pune në përmirësimin e njohurive të gjuhës gjermane në një klasë. Kjo përpjekje ka për qëllim të identifikojë se si këto praktika mund të përdoren në avantazh të të gjithë nxënësve, duke krijuar një mjedis më të përgjegjshëm dhe inkurajues për zhvillimin e aftësive gjuhësore. Duke shqyrtuar përfitimet e kësaj praktike, mund të vërehen ndryshime pozitive në nivelin e përgjithshëm të performancës dhe motivimit të nxënësve në fushën e gjuhës gjermane.

Në përpjekje për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e planit tonë mësimor, kemi vendosur të implementojmë një fazë të re, e cila përfshin realizimin e një testi dhe titestimi. Kjo strategji vjen si rezultat i një analize të kujdesshme të eksperiencës së mësuesve dhe performancës së

nxënësve në klasa. Përmes kësaj metode, synojmë të vlerësojmë dhe të shtojme nivelin e përgatitjes së nxënësve në lëndën e gjuhës gjermane.

Testimi dhe titestimi janë dy mjetet kyçe që do të na ofrojnë një panoramë të plotë të njohurive dhe aftësive të secilit nxënës. Këto mjete jo vetëm do të na ndihmojnë të identifikojmë zonat ku nxënësit mund të kenë nevojë për përmirësime, por gjithashtu do të na ofrojnë një mjet për të vlerësuar efikasitetin e strategjive tona mësimore dhe për të rregulluar planin tonë sipas nevojave të tyre të përditshme. Duke i dhënë rëndësi këtij procesi të vlerësimit, synojmë të përdorim rezultatet për të krijuar një mjedis më të përshtatshëm dhe sfidues për mësimin e gjuhës gjermane në klasën tonë.

Për të siguruar një mësim të strukturuar dhe efikas për klasën e dhjetë, kemi hartuar një plan mësimor të përqendruar në përsëritjen e leksioneve 1-3, duke përdorur manualin “Menschen A1.1”. Ky plan do të zhvillohet në një kohëzgjatje prej 30 minutash dhe do të përfshijë një grup prej 16 nxënësish.

Detajet e Planit Mësimor:

Tema: Përsëritje për leksionet 1-3

Klasa: 10

Kohëzgjatja: 30 minuta

Metoda: Menschen A1.1, leksionet 1-3

Numri i nxënësve: 16

Qëllimi:

Të njohin përemrat në gjuhën gjermane dhe t'i përdorin ato saktë në fjalë.

Të zgjedhin foljet në kohën e tashme duke i përdorur ato në kontekste të ndryshme.

Të ndërtojnë një tekst të shkurtër për veten duke përdorur fjali të thjeshta.

Të shkruajnë saktë fjalët në gjermanisht.

Gramatikë:

Përemrat vetore: përdorimi dhe identifikimi i tyre në tekst.

Zgjedhimi i foljeve: përdorimi i foljeve në kohën e tashme.

Metoda e përdorur për testim është një provim me një kohëzgjatje prej 30 minutash, duke përfshirë 4 pyetje të ndryshme. Realizimi i një riprovimi pas vlerësimit të parë ka sjellë një element të ri dhe motivues

për nxënësit. Kjo është një praktikë e re për ta, pasi ata janë mësuar të marrin notën menjëherë pas dorëzimit të provimit dhe ta shohin provimin e korigjuar.

Procesi fillon me nxënësit që marrin një provim të përgatitur nga mësuesi, i cili përfshin 4 ushtrime me nivele të ndryshme vështirësie. Pas dorëzimit të provimit, mësuesja e korigjon atë, duke ofruar një shpjegim të detajuar për përgjigjet e tyre. Nxënësit marrin provimin e korigjuar dhe një fletë ku janë përfshirë zgjidhjet e ushtrimeve dhe kriteret e vlerësimit.

Ata kanë kohë të mjaftueshme për të analizuar ushtrimet dhe për të identifikuar gabimet e tyre. Në fund, ata vlerësohen për cilësinë e punës së tyre duke adresuar gabimet dhe duke kuptuar elementët që kanë nevojë për përmirësim.

Pas kësaj faze, ata përgatiten për riprovimin e ardhshëm, duke pasur mundësinë të rikujtojnë dhe të ripunojnë materialet e nevojshme për të arritur një rezultat më të mirë. Kjo strategji e riprovimit ofron një mundësi të vlefshme për nxënësit për të rritur vetëvlerësimin dhe për të kuptuar më mirë mësimin apo elementët mësimor të shpjeguar dhe/ apo testuar.

5.1. Vlerësimi cilësor i korigjimit dhe rivlerësimit

Ushtrimet e zgjedhura për këtë provim janë të diferencuara në ushtrime gramatikore dhe ushtrime në të cilën vlerësojmë aftësitë në të shkruar.

Ushtrimi i parë

Übung 1. Ordnen Sie zu.

a heiße | aus | wer | bin | kommst | Schweiz

- Hallo, ich bin Laura. Und _____ bist du?
- ◆ Ich _____ Paco.
- Woher _____ du?
- ◆ Ich komme _____ Spanien. Und du?
- Aus der _____.

b Ihnen | gut | nicht | dir | Tag

- Guten _____, Frau Wachter! Wie geht es _____?
- ◆ Hallo, Svenja, sehr _____, danke. Und _____?
- Ach, _____ so gut.

____ / 10 Punkte

Ushtrimi i parë i zgjedhur është përzgjedhur me qëllim që të korrespondojë me një nivel të ulët gjuhësor. Nxënësit duhet të plotësojnë hapësirat boshe me fjalët e duhura, të cilat janë paraqitur më sipër. Ky ushtrim është vlerësuar me 10 pika, ku çdo hapësirë bosh ka një vlerë prej 1 pike.

Pas korigjimit të provimit, konstatojmë disa gabime të vogla në pikën b, përfshirë një ndryshim në pozicionin e përemrave në rasën dhanore "Ihnen" dhe "dir". Për shembull, një gabim tipik ishte në përdorimin e fjalëve "Wie geht es Ihnen?" dhe "Und dir?", ku nxënësit ndryshonin pozicionet e përemrave.

Pasi implementuam riprovimin, vëmë re se ky gabim u korigjua plotësisht nga nxënësit që kishin lexuar me vëmendje zgjidhjet e ushtrimit. Kjo tregon se procesi i riprovimit ka sjellë një përmirësim në kuptimin dhe përdorimin e përemrave në gjuhën gjermane, duke ofruar një shans për të eliminuar gabimet e mëparshme dhe për të fituar pikët maksimale në këtë ushtrim. Kjo përbën një dëshmi të suksesit të riprovimit si një mjete e efektshme për përmirësimin dhe përsosjen e njohurive të nxënësve në fushën gjuhësore.

Ushtrimi 2

Übung 2. Ergänzen Sie die Verben in der richtigen Form.

- a ● Wo wohnst (wohnen) du?
 ◆ Ich _____ (wohnen) in Hannover. Und du, wo _____ (leben) du?
 ● Ich _____ (leben) in Frankfurt, zusammen mit Klara. Das _____ (sein) meine Frau. Wir _____ (haben) auch ein Kind, Lina. Sie _____ (sein) drei Jahre alt. Und du, _____ (sein) du auch verheiratet?
 ◆ Nein, aber ich _____ (haben) eine Freundin. Wir _____ (sein) nicht verheiratet, aber wir _____ (leben) zusammen.
- b ● Was _____ (machen) Sie beruflich?
 ◆ Ich _____ (arbeiten) als Ingenieur bei Siemens. Und was _____ (sein) Sie von Beruf?
 ● Ich _____ (sein) Studentin und _____ (haben) einen Job als Kellnerin.

____ / 15 Punkte

Ushtrimi 2 është një ushtrim i cili klasifikohet si nivel mesatar në këtë nivel gjuhësor. Nxënësit duhet të plotësojnë hapësirat boshe me foljet e zgjedhura duke i përdorur ato në formën e duhur. Ky ushtrim ka një vlerë prej 15 pikëve, ku çdo folje e zgjedhur saktë i jep nxënësit 1 pikë.

Në vlerësimin e parë të këtij ushtrimi, vëmë re se shumë nxënës kanë bërë gabime të shumta në zgjedhjen e foljeve, veçanërisht tek foljet e

parregullta (si p.sh., sein, haben). Këto gabime kanë çuar në humbje të pikëve për një numër të madh nxënësish, duke shfaqur një nivel sfidues të njohurive të tyre në këtë fushë.

Megjithatë, pas kryerjes së riprovimit, vëmë re një përmirësim në zgjidhjen e saktë të ushtrimit. Kjo tregon se procesi i riprovimit ka sjellë një rritje në kuptimin dhe përdorimin e foljeve të zgjedhura, duke përmirësuar kështu performancën e nxënësve në këtë ushtrim. Kjo analizë dëshmon qartazi se riprovimi ka ofruar një mundësi efektive për nxënësit për të identifikuar dhe korrigjuar gabimet e tyre, duke përmirësuar në mënyrë të dukshme njohuritë e tyre.

Ushtrimi 3 dhe 4

Übung 3. Ergänzen Sie den Steckbrief und schreiben Sie dann einen kurzen Text über sich selbst.

Vorname: _____	Familienstand: _____
Familienname: _____	Familie: _____
Herkunft: _____	Kinder: _____
Wohnort: _____	Geschwister: _____
Beruf/Ausbildung: _____	Sprachen: _____
Alter: _____	

Ich heiße _____ und komme aus _____

____ / 10 Punkte

Übung 4. Freies Diktat.



____ / 5

Ushtrimi 3 dhe ushtrimi 4 janë dy ushtrime që janë mbi mesataren në nivelin e vështirësisë.

Ushtrimi 3 përshkruan një detyrë ku nxënësit duhet të shkruajnë të dhënat për veten dhe të përpilojnë një tekst të shkurtër. Në vlerësimin e parë, kjo pjesë ishte pjesërisht e vështirë për shumicën e nxënësve. Edhe pse ata arritën të paraqesin të dhënat e tyre, fjalitë që ata ndërtuan përbëheshin nga shumë gabime gramatikore, duke çuar kështu në një ulje të përgjithshme të pikëve të marra në këtë ushtrim.

Megjithatë, vlerësojmë një përmirësim të ndjeshëm në riprovim. Pasi nxënësit merrnin modelin e zgjidhjes së këtij ushtrimi, vërehet një ulje e konsiderueshme e gabimeve gramatikore gjatë provimit të përsëritur. Kjo tregon se riprovimi ka shërbyer si një mjet efektiv për nxënësit për të identifikuar dhe korrigjuar gabimet e tyre të mëparshme, duke rritur kështu cilësinë e tekstit të tyre. Në total vetëm një nxënës ka arritur të marrë pikët maksimale në riprovim, shënuar një përsosmëri të veçantë nga ana e tij.

Për të shtuar një sfidë të rëndësishme në drejtshkrim, ushtrimi i fundit shqyrton nivelin e nxënësve në një aspekt të rëndësishëm të gjuhës gjermane. Në këtë kontekst, një shikim i vëmendshëm zbuloi disa gabime të vogla në drejtshkrim, siç janë “ferhajratet” në vend të “verheiratet” ose përdorimi i “uir” në vend të “wir”, ose “arbajten” për “arbeiten”. Në vlerësimin fillestar, nxënësit morën vlerësimin 2 ose 3 pikë për këtë pjesë të provimit, ndërsa pas riprovimit ata arritën të mësonin fjalët në mënyrë të saktë, duke e ngritur nivelin e tyre dhe duke arritur vlerësimin 4 ose 5 pikë. Kjo tregon një përmirësim të dukshëm në aftësinë e nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar rregullat e drejtshkrimit gjatë procesit të riprovimit.

Mendohet se nxënësit bëjnë më shumë gabime në gramatikë, por ka edhe lloje të tjera të gabimeve gjithashtu, si gabimet në fjalor, gabimet në shqiptim, shkrim, kulturë dhe gabimet në artikull, të cilat mund të konsiderohen si gabime gramatikore. Prandaj, është e qartë se ka të gjitha llojet e gabimeve në mësim, por gabimet më të zakonshme bëhen në fushën e gramatikës. Në shumicën e rasteve, mësuesi korrigjon të gjitha gabimet gramatikore si dhe gabimet në fjalor. Zakonisht, gabimet gramatikore korrigjohen nga mësuesi dhe më rrallë nga një shok i klasës. Mekanizmat e korrigjimit të gabimeve të paraqitura mund të jenë: korrigjime direkte dhe indirekte, korrigjime të jashtme dhe vetë-korrigjime. Hulumtimet e mëparshme në mësimin e gjuhëve të huaja kanë treguar se mësuesit e gjuhëve të huaja duket se kanë rutina të caktuara personale për korrigjimin. Mësuesit duhet të inkurajohen të reflektojnë mbi sjelljen e tyre korrigjuese duke kontribuar në përmirësimin e mësimit të gjuhës së huaj.¹⁹

19. Bushi, Jonida “Correction of Speaking Mistakes when Learning a Foreign Language - Analysis of the Most Common Mistakes and their Correction in Learning the German Language.” (2022). Journal of Educational and Social Research, 12(2), 63, 2020.

5.2. Analiza e vlerësimit i provimit dhe riprovimit

Është e rëndësishme që të analizojmë rezultatet e provimeve jo vetëm në aspektin cilësor, por gjithashtu në atë sasior. Kjo përfshirje e analizës sasiore do të jetë një ndërhyrje e rëndësishme për të kuptuar se si metodat e përdorura kanë ndikuar në përparimin dhe aftësitë e nxënësve. Analiza sasiore do të ofrojë një pamje të plotë mbi shpërndarjen e rezultateve, identifikimin e tendencave dhe zbulimin e çdo ndryshimi të dukshëm në performancën e përgjithshme. Në provimin e parë dhe në rivlerësim, analiza sasiore do të na lejojë të shohim se si grupi i nxënësve ka zhvilluar rezultate në kohë. Nëse ka përmirësime të dukshme pas kohës së riprovimit, kjo mund të tregojë për një rritje në aftësitë e përgjithshme të nxënësve dhe një kuptim më të mirë të materialeve të mësimin.

Gjithashtu, analiza sasiore mund të ndihmojë në zbulimin e çdo ndryshimi në përqindjen e gabimeve specifike nga një provim në tjetrin. Kjo do të mundësonte një identifikim të mëtejshëm të vështirësive të përbashkëta të nxënësve dhe do të ndihmonte në hartimin e strategjive më të mira për të adresuar këto sfida në të ardhmen. Kështu, analiza sasiore e vlerësimit do të jetë një instrument efektiv për të përmirësuar përgjithshëm cilësinë dhe efikasitetin e mësimin në klasë.

Analiza sasiore e vlerësimit në provimin e parë dhe në rivlerësim

<i>Nxënësi</i>	<i>Nota e testimit të parë</i>	<i>Nota e ritestimit</i>
1	10	10
2	4	7
3	7	9
4	6	6
5	9	10
6	9	10
7	9	10
8	7	9
9	4	4
10	10	10
11	7	8
12	8	9

13	4	4
14	5	6
15	7	9
16	7	8

Tabela Nr.1

Tabela 1 paraqet një përmbledhje të numrit të nxënësve dhe notave përkatëse të marra në vlerësimin e parë dhe në rivlerësim. Kjo është një shtrirje e shifrave që na jep një pamje të qartë mbi shpërndarjen dhe evoluimin e rezultateve të nxënësve nga fillimi deri në përfundim të procesit të vlerësimit.

Në vlerësimin e parë

Nota	4	5	6	7	8	9	10	Nota mesatare
Nr. I notave	3	1	1	5	1	3	2	7,0

Tabela Nr.2

Tabela 2 paraqet shpërndarjen e notave të nxënësve në provimin e parë. Përmes kësaj table, mund të shohim se sa nxënës kanë fituar notat maksimale dhe se si janë shpërndarë notat në pjesën tjetër të spektrit. Kjo analizë sasiore e provimit fillestar mund të na japë një përshtypje të parë se çfarë kompetencash janë më të forta dhe ku ka nevojë për përmirësime.


Në rivlerësim

Nota	4	5	6	7	8	9	10	Nota mesatare
Nr.	2	0	2	1	2	4	5	8,0

Tabela Nr. 3

Tabela 3, nga ana tjetër, ofron të njëjtën analizë sasiore, por për rezultatet e riprovimit. Krahasimi midis tabelës 2 dhe tabelës 3 na jep një përkufizim më të saktë se si ka ndikuar riprovimi në performancën e nxënësve. Duke qenë se vërehet një rritje në numrin e notave maksimale, kjo mund të tregojë për një përmirësim të përgjithshëm të njohurive dhe kuptimit të materialit nga ana e nxënësve.

Përmes kësaj analize të gjatë, mund të vërejmë nëse përdorimi i riprovimit ka pasuar një efekt pozitiv në rezultatet e nxënësve, duke ndihmuar në identifikimin e fushave ku kanë patur nevojë për përmirësime dhe duke përmirësuar kështu cilësinë e procesit mësimor në klasë.



Grafiku i mësipërm tregon qartë rritjen që kanë pësuar nxënësit në procesin e rivlerësimit të notave. Kjo pasqyrohet qartë edhe në notën mesatare, e cila është ndryshuar nga 7 në 8. Po ashtu, në notat negative 4 dhe 5 gjatë procesit të rivlerësimit kemi pasur një rënie në numër, ndërsa në rivlerësim, notat 8, 9 dhe 10 u rritën në numër. Nisur nga grafiku, vlen të theksojmë se kjo metodë pune për mësuesit duket të jetë mjaft efektive.

Nxënësit arrijnë që të memorizojnë gabimet e bëra në provimin e parë dhe pas korrigjimit nga mësuesi mundohen t'i kuptojnë ato gabime. Kjo reflektohet nga përmirësimet që ndihen në notat gjatë ritestimit dhe në shfaqjen e zotërimit më të mirë në kompetencën e të shkruarit. Theksojmë që kjo kompetencë luan një rol kyç në aftësinë e shkrimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.²⁰

20. Becker-Mrotzek, M., & Böttcher, I. (2012). Schreibkompetenz entwickeln und beurteilen (4., überarbeitete Neuauflage). Berlin: Cornelsen Verlag.

6. Përfundime

Procesi i mësimit të një gjuhe të huaj është i vështirë, dhe vlerësimi i njohurive të fituara po ashtu paraqet sfida. Ky rast studimi na ofron mundësinë të shohim procesin e mësimit dhe vlerësimin nga një këndvështrim tjetër. Mësuesi gjithmonë shpjegon dhe në fund teston njohuritë e fituara nga nxënësi, duke vendosur një notë. Megjithatë, puna me nxënësit në një formë të tillë është shumë produktive. Mundësia për ta ribërë më mirë një provim është një mundësi që i duhet dhënë çdo nxënësi. Ata kanë të drejtë të gabojnë, të mësojnë dhe të përmirësojnë. Kjo është një ndër mënyrat më efikase për t'u zhvilluar përpara, duke i motivuar ata dhe duke mos i stresuar.

Ky artikull pati si synim metodën e rivlerësimit në procesin e mësimit të gjuhës gjermane në shkollat shqiptare. Duke filluar nga definicionet e vlerësimit dhe metodave tradicionale të vlerësimit, artikulli ka argumentuar për efektivitetin e metodës së propozuar, e cila përdor një fazë të dytë të testimeve. Metoda e propozuar përfshin një test me shkrim dhe një fazë të dytë të ritestimit, duke i dhënë nxënësve mundësi të korrigjojnë gabimet dhe të përmirësojnë rezultatet e tyre. Analiza e një rasti studimi konkret ka treguar se ky proces i rivlerësimit ka ndikim pozitiv në përmirësimin e vlerësimit, stimulimin e përpjekjeve të nxënësve, dhe eliminimin e pengesave në mësimit. Analiza e rastit studimor tregoi se metoda e rivlerësimit ka potencial për të përmirësuar rezultatet e nxënësve. Përmirësimet e dukshme në notat e nxënësve pas ritestimit sugjerojnë se ky proces mund të jetë një mjet efikas për të korrigjuar gabimet dhe për të nxitur përmirësimin e njohurive.

Përdorimi i detyrave të drejtshkrimit në testimet ka një rol thelbësor në vlerësimin e njohurive të nxënësve. Identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve në drejtshkrim pas provimit i jep nxënësve mundësinë për të kuptuar dhe përmirësuar aftësitë e tyre gramatikore.

Procesi i rivlerësimit po ashtu ka ndikim pozitiv në motivimin e nxënësve. Mundësia për të përmirësuar notat dhe për të kuptuar më mirë materialet pas vlerësimit fillestar nxit përpjekjet dhe interesimin e nxënësve për të mësuar më shumë.

Kombinimi i testeve me shkrim, testimin e njohurive të përgjithshme dhe detyrave të drejtshkrimit shërben si një metodë e përkryer e vlerësimit. Përdorimi i testeve të ndryshme të përfshira në një provim mund të ofrojë një pamje më të plotë të njohurive të nxënësve.

Planifikimi i një leksioni për përsëritjen e mësimeve tregon se përsëritja është një komponent i rëndësishëm i mësimit. Nxënësit kanë avantazhin e një provimi të ripërsëritur pas korrigjimit, duke i dhënë ata një mundësi të dytë për të vlerësuar dijen e tyre.

Duke përfshirë seksione të drejtshkrimit në provim, mësuesit mund të kontrollojnë dhe promovojnë aftësitë e nxënësve në drejtshkrim. Kjo është një pjesë e rëndësishme e vlerësimit që ndihmon në zhvillimin e një komunikimi të mirë gjuhësor.

Përmes një përjasje sasiore, artikulli ka pasqyruar përmirësimin në notat e nxënësve pas procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e vlerësimit cilësor dhe ka propozuar një metodë të përgatitur më mirë për testimet e gjuhëve të huaja. Analiza e notave para dhe pas rivlerësimit tregon një përmirësim të dukshëm, sidomos në detyrat që kërkojnë aftësi të shkruara. Në përfundim, ky artikull thekson se metodat e reja të vlerësimit, siç është metoda e rivlerësimit, mund të jenë mjet efikas për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit në kontekstin e mësimin të gjuhëve të huaja në shkollat shqiptare.

BIBLIOGRAFIA

- BARBARA HINGER/ WOLFGANG STADLER „Testen und Bewerten fremdsprachlicher Kompetenzen“, Narr Verlag 2018
- BECKER-MROTZEK, M., & BÖTTCHER, I. Schreibkompetenz entwickeln und beurteilen (4., überarbeitete Neuauflage). Berlin: Cornelsen Verlag. 2012.
- BUSHI, JONIDA, EMA KRISTO „Beëertung und Selbstevaluation in der Lehre“ botuar në Revistën Ndërkombëtare Shkencore“ Balkan Journal of Interdisciplinary Research, Vol 7, No. 1 Graz-Austri 2021.
- BUSHI, JONIDA, EMA KRISTO, ENDRI PAPAJORGJI, “Correction of Speaking Mistakes when Learning a Foreign Language - Analysis of the Most Common Mistakes and their Correction in Learning the German Language.” (2022). Journal of Educational and Social Research, 12(2), 63. <https://doi.org/10.36941/jesr-2022-0035>. 2020.
- Goethe Institut Belgrad, Gütekriterien, URL: <https://ëëë.goethe.de/resources/files/pdf236/serbien-rahmencurriculum-anhang-19-23.pdf>
- KLEPPIN, KARIN “Fehler und Fehlerkorrektur“ Berlin, München, Eien, Zürich, Neë York: Langenscheidt.1998
- KLEPPIN, KARIN, Zum Umgang mit Fehlern im Fremdsprachenunterricht. In: Jung, Udo O. H. (Hg.), Praktische Handreichung für Fremdsprachenlehrer, 6470. 4., vollständig neu bearbeitete Auflage. Frankfurt a.M./Berlin/Bern/Brussel/Neë York/Oxford/Eien. 2006
- LANGFELDT, H.-P. (Die klassische Testtheorie als Grundlage normorientierter (standardisierter) Schulleistungstests. In K. A. Heller (Hrsg.), *Leistungsdiagnostik in der Schule* (S. 65–98). Bern: Huber. 1984
- PERVEEN, S. A. A. S. (2021). Critical analysis of pakistan national educational policies of 1992, 1998 and 2009 with special reference to examination reforms in sindh board. Pakistan Journal of Educational Research, 4(3). <https://doi.org/10.52337/pjer.v4i3.260>
- MAS, “Udhëzim për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”,Tiranë, 2022
- MITA NIKOLETA “Vlerësimi në arsim” Tiranë,2009
- MUHO ANITA “Efektet e mënyrave të ndryshme të vlerësimit në motivimin e nxënësve gjatë përvetësimit të gjuhës së huaj” Tiranë, 2015
- MUSAI, BARDHYL “Psikologji edukimi” Pegi, Tiranë,1999
- RÜDIGER GROTHJAHN/KARIN KLEPPIN „Prüfen,Testen, Evaluieren“ Klett Verlag 2015.
- WOLFGANG SCHNEIDER, MARCUS HASSELHORN (Hrsg.) „ Handbuch der Pädagogischen Psychologie“ Hogrefe Verlag 2008, S. 324-335.

KOMUNIKIMI SI MJET MIRËQENIEJE NË KOMPANI RAST STUDIMI OPTIMA ALBANIA

Msc. Sabina Sitaj

Departamenti i Financës

Optima Albania

E-mail: sitajsabina@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Komunikimi është një mjet i rëndësishëm të cilin asnjë kompani nuk mund ta injorojë. Ai luan një rol kyç në përmirësimin, vendosjen, finalizimin e objektivave dhe parimeve të kësaj të fundit. Qëllimi i kompanisë moderne nuk është vetëm fitimi, qëllimi i saj është të njihet në treg dhe të krijojë një imazh të fortë në sytë e publikut (kompanitë e tjera konkurruese, klientët dhe stafi). Ky punim fokusohet në temën e komunikimit të brendshëm të ndërmarrjes dhe hipoteza kërkimore së cilës jemi përpjekur t'i japim përgjigje është të kuptojmë se si komunikimi ndikon në mirëqenien e një kompanie. Mirëqenia e kompanisë është thelbësore për zhvillimin, produktivitetin dhe krijimin e një mjedisi të këndshëm për stafin e saj. Komunikimi kontribuon në krijimin e një kulture dhe identiteti të ndërmarrjes. Përmes analizimit dhe kuptimit të rëndësishëm të komunikimit në një kompani dhe se si ai integrohet në gjirin e saj, do të përqendrohemi në përvojën praktike të identifikuar në kompaninë Optima. Studimi i rastit, historia, konceptet që kompania komunikon dhe strategjitë e përdorura do të synojnë t'i përgjigjen qëllimit të hipotezës: të tregojë se komunikimi është një faktor i rëndësishëm në mirëqenien e një kompanie.

Fjalët çelës: komunikim, komunikim i brendshëm, kompani, mirëqenie, pyetësor

ABSTRACT

Communication is an important instrument that plays a key role in improving, setting, and finalizing the objectives and principles of the company. The goal of the modern company is not only profit, but its goal is also to be recognized in the market and create a strong image in the eyes of the public (other competing companies, customers and staff). This work focuses on the topic of internal business communication and the research question we have tried to answer is to understand how communication affects the well-being of a company. The well-being of the company is essential for development, productivity and creating a pleasant environment for its staff. Communication contributes to the creation of a corporate culture and identity. By analyzing and understanding the importance of communication in a company and how it is integrated into it, attention will be focused on the practical experience identified in the company Optima. The case study, the story, the concepts that the company communicates and the used strategies, will aim to answer the purpose of this work: to confirm that communication is an important factor in the well-being of a company.

Keywords: communication, internal communication, company, well-being, questionnaire

Çfarë është komunikimi

Aftësia për të menduar dhe aftësia për të folur janë karakteristikat të cilat e kanë dalluar qenien njerëzore nga pjesa tjetër e botës shtazore. Ku ka jetë ka komunikim dhe realiteti social sot vërtitet rreth komunikimit, një realitet në të cilin enden mesazhe dhe kode të ndryshme. Nga pikëpamja etimologjike, të komunikosh do të thotë të ndash njohuri, ide dhe mendime përmes disa kanaleve për qëllime të ndryshme¹. Fjala “komunikim” ka origjinë latine, rrjedh nga folja “communicare”, që do të thotë “të ndash të bashkëndash”². Të komunikosh do të thotë të marrësh pjesë në një sistem marrëdhëniesh, përmes normave dhe rregullave të zbatuara nga pjesëmarrësit në procesin e komunikimit, të cilët shkëmbejnë informacione, ide dhe mendime duke përdorur kanale e kode verbale, paraverbale dhe simbolike, të vendosura në një kontekst specifik.

Komunikimi i ndërmarrjes dhe komunikimi i brendshëm

Përpara se të analizojmë komunikimin e kompanisë është e rëndësishme të përcaktojmë se çfarë nënkuptohet me termin “kompani”. Në fjalorin “Treccani” gjejmë këtë përkufizim:

“Kompania mund të konsiderohet si një organizatë ekonomike njerëzish dhe mallrash, si një sistem forcash ekonomike, që zhvillon proceset e prodhimit dhe/ose konsumit në mjedisin me të cilin ndërvepron, në të mirë të subjekteve ekonomike me të cilat bashkëpunon»³.

Përkufizohet si komunikim i ndërmarrjes:

“Të gjitha ngjarjet përmes së cilave kompania arrin të krijojë një proces komunikimi me një ose më shumë marrës, të cilëve u propozon një ose më shumë aspekte të identitetit të saj”⁴.

Komunikimi i ndërmarrjes i referohet mënyrës se si kompanitë zgjedhin të komunikojnë me audienca të ndryshme brenda dhe jashtë strukturës së tyre. Këto audienca përfshijnë: klientët, mediat, investitorët, punonjësit etj. Komunikimi është i përhapur pothuajse në të gjitha kompanitë e mëdha, të cilat lejojnë strukturimin efikas të vlerave të kompanisë. Koncepti i komunikimit të ndërmarrjes përfshin të gjitha proceset që një kompani ndërmerr për t’u lidhur me mjedisin e jashtëm dhe atë të brendshëm; procese jetike për të siguruar mbijetesën e kompanisë në treg, por edhe për të forcuar lidhjen e saj

1. Rossi G., La comunicazione aziendale, Franco Angeli, Milano, 2009, pag. 43-47

2. <https://www.treccani.it/vocabolario/comunicare>

3. <https://www.treccani.it/enciclopedia/azienda>

4. Salem E., Che cos’è la comunicazione d’impresa, Lupetti, Milano, 1988, pag. 55-71

me burimet të cilat nga ana tjetër garantojnë funksionimin e proceseve prodhuese dhe organizative të kompanisë. Për të arritur objektivat që një kompani ka dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm pune, është e nevojshme të përcaktohet një strategji e brendshme komunikimi. Termi komunikim i brendshëm i ndërmarrjes i referohet të gjitha mjeteve përmes të cilave një kompani komunikon me stafin e saj.

“Komunikimi i brendshëm konsiderohet si pikë referimi për politikat dhe strategjitë e kompanisë; risitë, organizimin, menaxhimin, marketingun, planifikimin. E gjithë kjo bëhet e mundur nëse një kompani ka komunikim të brendshëm efektiv”⁵.

Të flasësh për komunikim të brendshëm do të thotë t’i referohesh atij objektivi strategjik nga i cili zhvillohen të gjitha aktivitetet e kompanisë si prodhimi, menaxhimi, inovacioni, shitja dhe kontrolli. Ai i lejon kompanisë të jetë dinamike dhe të ketë punonjës vazhdimisht të informuar, të motivuar dhe të lidhur nga ndjenja e përkatësisë në vendin e tyre të punës. Funkzioni primar i komunikimit të brendshëm është të bashkojë imazhin që drejtuesit dhe punonjësit kanë për kompaninë, duke promovuar kështu mirëkuptimin dhe kulturën e organizatës midis stafit.

Kultura organizative e ndërmarrjes

Çdo kompani ka kulturën e saj, e cila bazohet në vlerat e kompanisë, prioritetet dhe njerëzit që punojnë në të. Këta faktorë bashkohen për të krijuar mjedisin e punës së një kompanie, për të krijuar kulturën e saj. Termi “kulturë” përkufizohet si:

“Një kompleks njohurish, traditash, procedurash teknike, lloje sjelljesh të ngjashme, karakteristikë e një grupi të caktuar shoqëror, të një populli, të një grupi popujsh ose të gjithë njerëzimit”⁶.

Ndërsa me termin “organizativ” përshkruhet si:

“Një organizim i aktiviteteve të kompanisë dhe një strukturë organizative e lidhur, e bazuar në disa parime themelore dhe një sërë rregullash, procedurash dhe metodash specifike”⁷.

Struktura organizative e një kompanie ndërtohet rreth një mjedisi kulturor, i cili kontribuon në forcimin dhe arritjen e objektivave të kompanisë. Një kulturë konsiderohet e shëndetshme vetëm kur

5. FOGLIO A., La comunicazione interna alle imprese e alle organizzazioni, Franco Agnelli, 2015 pag. 54

6. Zingarelli N. Lo Zingarelli 1995. Vocabolario della lingua italiana, Milano, Zanichelli editore, Bologna, 1994

7. Idem

punonjësit e saj ndihen të vlerësuar, të sigurt dhe e dinë se kanë mundësi për rritje profesionale. Kur punonjësit janë të kënaqur me ambientin në të cilin punojnë, atëherë rritet edhe produktiviteti i kompanisë. Komunikimi është forma kryesore e zhvillimit të një dialogu midis punonjësve të një organizate dhe ekipit drejtues. Drejtuesit e kompanisë sot i japin gjithnjë e më shumë rëndësi kulturës së ndërmarrjes dhe e konsiderojnë atë një mjet strategjik dhe thelbësor për arritjen e objektivave të përbashkëta.

Rast Studimi: Komunikimi si mjet mirëqenieje në Optima Albania

Optima Albania është krijuar në vitin 2015 me qendër në Tiranë, pjesë e Optima Italia një ndër kompanitë më të rëndësishme italiane, e cila operon në treg duke ofruar shërbimet e energjisë dhe telekomunikacionit. Optima u themelua në vitin 1999 me seli në Napoli nga dy sipërmarrës të rinj dhe në një kohë të shkurtër ndikimi i saj rritet në shkallë vendi. Në vitin 2010 listohet në bursë me emrin Optima Italia S.p.A. dhe vitin 2011 Optima vendos të zgjerojë aktivitetin e saj dhe përveç shërbimeve të telekomunikacionit dhe energjisë elektrike vendos të krijojë edhe departamentin e furnizimit me gaz.

Ekziston gjithmonë mundësia për të përmirësuar kulturën e punës, por për ta bërë këtë duhet kohë, durim, vullnet dhe përkushtim. Për të pasur një kulturë të shëndetshme brenda kompanisë, duhet të zbatohen rregullat e vendosura në vendin e punës, si dhe të merren parasysh mendimet e punonjësve për mjedisin ku ata punojnë. Optima Albania ka brenda saj formimin e një kulture të larmishme dhe ndërtimin e një komunikimi të suksesshëm të ndërtuar mbi vlerat njerëzore dhe misionin e kompanisë. Këto janë pika thelbësore në krijimin e imazhit dhe identitetit të kompanisë. Identiteti i kompanisë përfaqësohet nga karakteristikat që e bëjnë atë të veçantë dhe e dallojnë nga të tjerët. Respektimi i punonjësve, krijimi i një klime të favorshme biznesi, stabiliteti, objektivat e qarta dhe vullneti për t'i çuar përpara ato, janë disa nga cilësitë që e dallojnë Optima nga kompanitë e tjera që operojnë në treg.

Një strategji e suksesshme komunikimi brenda kompanisë duhet të karakterizohet nga aktualiteti dhe dinamizmi, duke iu përshtatur vizionit të kompanisë dhe objektivave që ajo vendos. Zhvillimi i strategjisë së komunikimit të brendshëm në kompaninë Optima si një mjet për të garantuar mirëqenien dhe krijimin e një kulture të korporatës kryhet përmes teknikave të ndryshme si:

- Zëri i punonjësit - përmes kësaj praktike Optima komunikon me stafin për çështje që i shqetësojnë drejtpërdrejt për të gjetur pikat kyçe përmes së cilave arrihet përmirësimi i proceseve organizative të punës dhe komunikimit. Në këtë mënyrë, duke dëgjuar dhe marrë ide dhe opinione të ndryshme, kompania është në gjendje të krijojë një mjedis dhe kulturë të favorshme.
- Intraneti i kompanisë - Intranet është një sistem i brendshëm komunikimi i kompanisë i aksesueshëm vetëm nga personat që punojnë në këtë të fundit. Optima ka vendosur në dispozicion të stafit të saj këtë sistem, i përbërë nga kanale të shumta si E-mail, Skype for Business, WhatsApp, të cilat thjeshtojnë proceset e brendshme organizative duke u kthyer kështu në mjete të favorshme për krijimin e një kulture korporative.
- Kurse trajnimi të vazhdueshme - Optima zhvillon vazhdimisht kurse të ndryshme trajnimi profesional, duke rritur produktivitetin dhe efikasitetin e stafit të saj, si dhe kurse të ndryshme komunikimi për të menaxhuar më mirë situata të ndryshme brenda kompanisë.
- Proaktiviteti - Marrja e përgjegjësisë, të qenit i vendosur dhe i ndërgjegjshëm në vendime, aftësia për të parashikuar dinamikën e punës janë disa nga cilësitë e proaktivitetit që Optima synon t'i transmetojë gjithmonë stafit të saj, për të garantuar mbarëvajtjen e punës.
- Puna në grup - Një ndër kërkesat e vendosura nga Optima për stafin e saj është aftësia për të punuar në grup. Një ekip njerëzish që janë të aftë të bashkëpunojnë mes tyre, ndihmojnë në arritjen e qëllimeve, realizimin e projekteve dhe forcimin e marrëdhënieve mes stafit.
- Optima ofron mundësi promovimi për punonjësit e saj dhe është e përkushtuar në krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke respektuar të drejtat dhe lirinë e fjalës në mënyrë të barabartë për të gjithë individët e saj, përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Shkëmbimi i informacionit dhe komunikimi i vazhdueshëm janë mjetet kryesore për të menaxhuar më mirë marrëdhëniet brenda kompanisë. Komunikimi i ndërmarrjes nuk konsiderohet më një mjet funksional, ai tashmë është një mjet strategjik dhe është specifik për secilën kompani.

Duke marrë parasysh gjithçka u tha më sipër, në studimin e zhvilluar në kompaninë Optima është zgjedhur metodologjia e mëposhtme:

Formulimi i pyetjeve kërkimore përmes një pyetëso. Pyetëso është një metodë efektive për të analizuar kulturën e një kompanie. Kjo metodë kërkon pak kohë, por është një nga ndër më të mirat dhe më të besueshmet, sepse lejon identifikimin e drejtpërdrejt të qëndrimit që punonjësit kanë ndaj kompanisë, duke përcaktuar kështu vlerat dhe elementët që janë të rëndësishëm për të. Analiza e përgjigjeve të dhëna na lejon të nxjerrim përfundime të përshtatshme dhe të përgjithshme, duke synuar t'i japë përgjigje qëllimit të studimit: të tregojë se komunikimi është një mjet i rëndësishëm dhe strategjik në mirëqenien e një kompanie, si dhe pyetjeve kërkimore të mëposhtme që lidhen ngushtë me komunikimin në kompaninë Optima Albania.

Pyetja kërkimore 1: Sa të kënaqur jeni me komunikimin në ambientin e punës tuaj?

Pyetja kërkimore 2: Sa të kënaqur jeni me informacionin e marrë gjatë rekrutimit tuaj?

Pyetja kërkimore 3: A ju mban kompania të informuar për risitë dhe ndryshimet që ju prekin drejtpërdrejtë?

Pyetja kërkimore 4: Sa efektive është metoda e komunikimit e përdorur nga eprorët tuaj? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.

Pyetja kërkimore 5: Sa komod ndiheni kur komunikoni me eprorët dhe kolegët tuaj për probleme të ndryshme që mund të hasni në punë? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.

Pyetja kërkimore 6: A e përmirëson komunikimin mes jush dhe eprorëve tuaj përdorimi i kanaleve digjitale (email, whatsapp, viber, skype, etj.)?

Pyetja kërkimore 7: Në një javë të zakonshme, sa shpesh ndiheni të stresuar në punë? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.

Pyetja kërkimore 8: Sa gjasa ka që ju të kërkoni një punë tjetër jashtë kompanisë? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.

Fazat e procesit kërkimor

Një ndër fazat më të rëndësishme të një kërkimi është mbledhja e të dhënave, por në të njëjtën kohë kjo fazë është dhe më e neglizhuara. Nëse nuk tregohet kujdesi i duhur kjo fazë mund t'i zhvlerësojë rezultatet ose interpretimet e nxjerra dhe t'i dëmtojë ato. Studimi mbledh të dhëna parësore duke përdorur metoda cilësore dhe sasiore. Për t'iu përgjigjur pyetjes hipotetike dhe pyetjeve kërkimore shoqëruese/plotësuese, do të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Përcaktimi i hipotezës, në rastin tonë pyetja hipotetike është të tregojmë se komunikimi funksionon si një mjet mirëqenieje në kompaninë Optima.
- Mbledhja e të dhënave, përmes së cilave marrim informacionin që na nevojitet për hipotezën tonë. Duhet të përcaktohet metoda përmes së cilës do të kryhet mbledhja e të dhënave dhe gjithashtu kampioni i studimit. Në rastin tonë, mbledhja e të dhënave do të kryhet nëpërmjet një pyetësoi të bërë për një grup personash që punojnë në kompaninë Optima.
- Analiza e të dhënave, gjatë kësaj faze i gjithë informacioni i marrë nga mbledhja e të dhënave përpunohet për të nxjerrë rezultate që përdoren për të vërtetuar hipotezën.
- Faza e fundit është ajo e rezultateve ku këto të fundit shfaqen në mënyrë korrekte dhe efikase.

Grupi i marrë në studim janë punonjësit e kompanisë Optima Albania; Pas përpilimit dhe nxjerrjes së të dhënave, rezultoi se personat e intervistuar janë të moshës 22 deri në 39 vjeç. Të dhënat u mbledhën përmes një pyetësoi të kryer brenda ambienteve të kompanisë me pyetjet e dhëna më sipër. Madhësia e kampionit është bërë duke respektuar metodat statistikore duke patur parasysh intervalin dhe nivelin e besimit.


Përzgjedhja e elementeve të zgjedhur: e rastësishme.

Metodat e mbledhjes së të dhënave: pyetësor i zhvilluar brenda ambienteve të kompanisë.

Madhësia e kampionit: 186 individë


Analiza e rezultateve

Pyetja kërkimore 1: Sa të kënaqur jeni me komunikimin në ambientin e punës tuaj?




Të kesh një staf të kënaqur nuk është e lehtë dhe kompanitë duhet të zbatojnë strategji të ndryshme për të krijuar një mjedis me komunikim të mirë. 48% (90 individë) janë të kënaqur me komunikimin në ambientin e punës, 36% (66 individë) janë të kënaqur, 3% prej tyre janë neutralë (34 individë), 3% e tyre (6 individë) kanë zgjedhur alternativën shumë të pakënaqur dhe 0 për alternativën e pakënaqur.

Pyetja kërkimore 2: Sa të kënaqur jeni me informacionin e marrë gjatë rekrutimit tuaj?




Informacioni i transmetuar gjatë procesit të rekrutimit është thelbësor për punonjësën, sepse përmes tij ky i fundit arrin të krijojë një ide për kompaninë të cilës i drejtohet. Në pyetësorin e zhvilluar, 39% e të anketuarve janë të kënaqur me komunikimin e dhënë në momentin e parë, 29% janë shumë të kënaqur, 19% janë neutralë, 10% janë shumë të pakënaqur dhe 3% të pakënaqur.

Pyetja kërkimore 3: A ju mban kompania të informuar për risitë dhe ndryshimet që ju prekin drejtpërdrejt?




Një nga detyrat e çdo kompanie është të informojë stafin për ndryshimet që ndodhin brenda saj dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek ta. Në rastin konkret «Po» është alternativa që ka më shumë vlerësime me 74% (138 punonjës), e ndjekur nga alternativa «Ndonjëherë» me 23% (42 punonjës) dhe në fund alternativa «Jo» e zgjedhur nga vetëm 3% (6 punonjës).

Pyetja kërkimore 4: Sa efektive është metoda e komunikimit e përdorur nga eprorët tuaj? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.




Shkëmbimi i mesazheve të qarta dhe të kuptueshme është çelësi i komunikimit. Në diagramin e mësipërm është paraqitur shkalla e efikasitetit të metodave të komunikimit të përdorura nga eprorët në kompaninë Optima. Thuajse gjysma e pjesëmarrësve 48% janë shumë të kënaqur (5) dhe vetëm 6% e tyre janë të pakënaqur (2). Pjesa e mbetur prej 45% ndahet në 35% të kënaqur (4) dhe 10% neutral (3), ndërsa niveli 1 (shumë i pakënaqur) është 0 vota.

Pyetja kërkimore 5: Sa komod ndiheni kur komunikoni me eprorët dhe kolegët tuaj për probleme të ndryshme që mund të hasni në punë? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.




Një mjedis miqësor është një nga gjërat që të gjithë duan, por që vetëm pak mund ta ofrojnë. Anketa e kryer tregon qartë se nuk ka vlerësime negative, 48% e të anketuarve janë shumë të kënaqur, 42% janë të kënaqur dhe vetëm 10% janë neutralë. Nga këto rezultate mund të kuptohet se komunikimi brenda kompanisë është në nivelin maksimal.

Pyetja kërkimore 6: A e përmirëson komunikimi mes jush dhe eprorëve tuaj përdorimi i kanaleve digjitale (email, whatsapp, viber, skype, etj.)?



Komunikimi përmes kanaleve të ndryshme digjitale i bën punonjësit të ndiheni më afër kompanisë dhe të kenë rezultate më të mira në punën e tyre. Sondazhi zbuloi se 87% e të anketuarve mendojnë se përdorimi i kanaleve digjitale përmirëson komunikimin me eprorët, 7% e të anketuarve besojnë se kanali digjital nuk ndikon në komunikim, ndërsa pjesa e mbetur e të intervistuarve (6%) nuk kanë një opinion.

Pyetja kërkimore 7: Në një javë të zakonshme, sa shpesh ndiheni të stresuar në punë? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.



Fluksi i lartë i punës, komunikimi jo efektiv, ndjenja e mos përkatësisë në punë apo probleme të ndryshme mund të çojnë në krijimin e situatave stresuese. Në diagramin e mësipërm vihet re se niveli i stresit në kompaninë Optima është në nivele të ulëta, 19% e të anketuarve kanë zgjedhur nivelin 1, 39% e tyre kanë zgjedhur nivelin 2, 32% kanë zgjedhur nivelin 3, 7% kanë zgjedhur nivelin 4 dhe 3% kanë zgjedhur nivelin 5.

Pyetja kërkimore 8: Sa gjasa ka që ju të kërkoni një punë tjetër jashtë kompanisë? Vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë.



Pagat e ulëta, mungesa e komunikimit dhe e rritjes profesionale, stresi i vazhdueshëm, marrëdhëniet e vështira me eprorët dhe kolegët janë vetëm disa nga arsyet që shtyjnë punonjësit të kërkojnë një punë të re. Në sondazhin e kryer në kompaninë Optima më shumë se gjysma e të anketuarve, 55%, zgjedhën shkallën e vlerësimit 1, e cila tregon nivelin më të ulët për t’u larguar, dhe vetëm 3% e tyre zgjedhën shkallën e vlerësimit 5, që tregon nivelin më të lartë. 22% e të anketuarve zgjedhën nivelin 2, i cili gjithashtu tregon një nivel të ulët, dhe pjesa tjetër ndahet në mënyrë të barabartë midis niveleve 3 dhe 4, praktikisht 10% për secilin.

Përfundime

Fokusi i këtij punimi ishte komunikimi si një faktor i rëndësishëm në proceset mbarëvajtëse të një kompanie. I gjithë studimi konsistoi në analizën e mirëfilltë të një kompanie reale që operon në tregun shqiptar, Optima Albania. U formulua një pyetësor, qëllimi i të cilit ishte të evidentonte disa pika të rëndësishme të komunikimit të brendshëm dhe të demonstronte se funksioni kryesor i komunikimit është krijimi i një marrëdhënie të shëndetshme brenda strukturës së një kompanie. Përmes përgjigjeve të marra, të cilat janë thelbi dhe vlerë e shtuar të kësaj pune, kemi arritur në disa përfundime të rëndësishme për temën tonë të studimit:

Pothuajse gjysma e të anketuarve (48%) janë të kënaqur me komunikimin e kompanisë Optima, një shifër relativisht e lartë në raport me njerëzit e pakënaqur që janë vetëm 3%. Informacioni i dhënë gjatë punësimit të punonjësve të saj vërehet se ka qenë i saktë dhe ka përcjellë vizionin e kompanisë. Rezultatet e pyetësorit tregojnë se stafit i komunikohet çdo ndryshim që ka të bëjë me ta dhe që ndikon në punën e tyre. Komunikimi që përdoret brenda kompanisë Optima rezulton efektiv, me 48% të punonjësve shumë të kënaqur dhe 35% të kënaqur. Kompania ka arritur të krijojë një mjedis miqësor dhe mikpritës ku 48% e punonjësve të saj janë shumë të kënaqur dhe 42% e tyre janë të kënaqur, si dhe ka vendosur në dispozicion përdorimin e kanaleve të tjera digjitale për të përmirësuar marrëdhëniet dhe komunikimin me punonjësit e saj. Nga të dhënat e mbledhura gjatë pyetësorit në lidhje me nivelin e stresit në kompaninë Optima, vërehet se niveli i stresit është shumë i ulët, kjo tregon se kompania ka krijuar një mjedis ideal me metoda dhe mjete për të thjeshtuar punën e stafit të saj. Nga rezultatet e marra nëpërmjet pyetësorit mund të themi se komunikimi i përdorur në kompaninë në studim është funksional dhe nëpërmjet tij është arritur krijimi i një klime dhe kulture në favor të zhvillimit të punës, si dhe të mirëqenies fizike dhe psikologjike të stafit të saj.

BIBLIOGRAFIA

CROCI E., "Comunicazione interna", in Caselli L. (a cura di), (1995), *Le parole dell'impresa*, Franco Angeli, Milano 1995
DAMASCELLI N., *La comunicazione nelle imprese*, Franco Angeli, Milano 1985
DEL MARE A., CANINO A., AZZONI G., *Come si comunica all'interno di un'impresa* Lupetti, Milano, 1990
FOGLIO A., *La comunicazione interna alle imprese e alle organizzazioni*, Franco Agnelli, 2015
FONTANA F., CAROLI M., *Economia e gestione delle imprese*, McGraw-Hill, Milano, 2003
GILLIS T. and Iabc, *The Iabc Handbook of Organizational Communication: A guide to Internal Communication*, Jossey-Bass, 2006
INVERNIZZI E., *La comunicazione organizzativa: teorie, modelli e metodi*, Edizioni Giuffrè, Varese, 1999
LASSWELL HAROLD D. *La struttura e la funzione della comunicazione nella società*, New York, 1948
MARKWICK N., Fill C., *Towards a framework for managing Corporate Identity*, *European Journal of Marketing*, 1997
MORELLI M., *L'immagine dell'impresa. Le leve strategiche della comunicazione nell'epoca del cambiamento*, Franco Angeli, Milano 2002
PASTORE A., VERNUCCIO M., *Impresa e comunicazione. Principi e strumenti per il management*, Apogeo Education, Milano, 2006
RAMPINIF., *La comunicazione aziendale*, Etas, Milano, 1990
ROSSI G., *La comunicazione aziendale*, Franco Angeli, Milano, 2009
SALEM E., *Che cos'è la comunicazione d'impresa*, Lupetti, Milano, 1988
SCHRAMM, W. *Come funziona la comunicazione, Il processo e gli effetti della comunicazione di massa* Urbana, Illinois, 1954
SIANO A., *Competenze e comunicazione del sistema d'impresa*, Giuffrè Editore, Milano, 2001
WATZLAVICK P., Bravin J.H. Bravin, Jackson D.D., *Pragmatica della comunicazione umana*, Astrolabio, Roma, 1971
ZINGARELLI N. *Lo Zingarelli 1995. Vocabolario della lingua italiana*, Milano, Zanichelli, Bologna, 1994.
<https://www.optimaitalia.com/>
<https://www.treccani.it/enciclopedia/azienda>
<https://www.treccani.it/vocabolario/comunicare>

CHALLENGES OF THE 21ST CENTURY EDUCATION, ESPECIALLY DURING TIMES OF A GLOBAL PANDEMIC

Enkela Binaj

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: enkela binaji@unitir.edu.al

ABSTRACT

The COVID-19 epidemic undoubtedly has a historically significant impact on the global educational system. Governments and educational institutions all around the world have started several policy initiatives in response to this pandemic to support students' education. Amid a global pandemic finding solutions has become more urgent. A new 21st-century aid delivery strategy based on an effective operational public-private partnership and results-based finance model must be developed to address the severe global education problem of today. A more effective and coherent global education architecture will also be necessary for success. Simply providing more money won't solve the issue, thus new leaders at the highest level are needed, as well as fresh ideas.

Keywords: Learning Platforms, Internet, Pedagogy, COVID-19 and Online Teaching, Technology, Digital Generation, Challenges.

1. Introduction

Globalization and social media have made the world more accessible than it has ever been. Simultaneously, rising income disparities have further divided the world's population. The twenty-first century schools, universities, businesses, and society as a whole are grappling with fundamental educational issues. We are living in a paradigm-shifting era, where technological, demographic, social, environmental, economic, and political changes are causing us to rethink our educational structure. Youngsters who are looking towards the future are at the center of this whirlwind. Each child holds the potential to grow into a powerful, ethical, creative, critical, and active adult.

2. Content:

Since the first days of 2020, numerous educational institutions around the world had to suspend face-to-face instruction because of the growing fears about the COVID-19 virus's spread and the urgency to stop it. Without a doubt, the coronavirus exposed new weaknesses in global education systems. Given that the future is unpredictable, society now needs adaptable and robust educational systems. More schools now have to figure out how to

continue teaching and learning while under the prospect of lengthy future shutdowns as a result of the Novel Coronavirus, other possible global pandemics and the ensuing COVID-19 epidemic. This study will look at how teaching and learning can carry on in such unheard-of circumstances. Thus, the following research topics serve as the basis for this study:

1. What difficulties exist in ensuring that students' learning is unaffected?
2. How to handle these difficulties if the situation persists?

During the COVID-19 epidemic, significant, nationwide initiatives to use technology to promote remote learning, distance education, and online learning were sprouting and changing swiftly. However, current literature highlights other flaws, such the inadequate infrastructure for online education, the lack of training for teachers, the knowledge gap, the complexity of the home environment, and so forth (Murgatroid, 2020).

The COVID-19 epidemic was a heavy lever that brought about a significant shift in the educational process at any institution of higher learning and pointed it in the direction of information and cutting-edge technologies. Foreign and domestic researchers who have been tracking the widespread adoption of online learning have noted that the pandemic has prompted a re-examination and fresh understanding of such fundamental elements of the academic environment as academic infrastructure, educational platforms, and the readiness of teachers and students for it

It will take a generation to overhaul the currently deficient education systems in dozens of countries, and it will require consistent top-level political leadership as well as significant new donor and developing country contributions. Thus, International organizations started paying

particular attention to the document Education Response in Crises and Emergencies. UNESCO stated in the Education 2030 Incheon Declaration and Framework for Action, that countries should:

Provide alternative modes of learning and education for children and adolescents who are not in education institutions, and put in place equivalency and bridging programs, recognized, and accredited by the state, to ensure flexible learning in both formal and non-formal settings, including in emergency situations (R. H. Huang et al., 2020, p. 1).

Education systems must change to become more robust, equitable, and inclusive, leveraging technology to benefit all students and building on the innovations and collaborations that have evolved throughout this crisis.

Key Features of 21st Century Education

In different countries including Albania, the ministries of education place a lot of emphasis on education for the twenty-first century, but they will be missing some of its most crucial components if they don't approach the subject from a sustainability perspective. The traditional focus on acquiring skills necessary for employment in the current global economy raises the question of whether the global economy can be sustained over the course of this century. Therefore, it is crucial to consider the key features of such modern education, such as follows:

- I. **Personalized learning** Treating children as unique individuals is crucial. The "plague" of standard testing and a standard curriculum that most school systems experience is caused by the ostensible demands of the market. Because of this, they are raising generations of kids who are unable to "think around the corner or outside the box." It is essential to picture a change in how students are educated, and the educational system is set up. Every kid is considered as a singular personality, and the creation of a personalized education plan is the first step in the child's education. The kid is evaluated in each of the areas that are taught, and based on the results, integrated lesson plans are created that build on the knowledge the child already has and use instructional techniques appropriate to that level. The youngster is one of a group of pupils whose instructor oversees creating a unique lesson plan for each student. Activities when the teacher works with the student one-on-one are part of that plan. All these measures are more challenging while transforming the academic environment into "online classroom".

II. Equity, diversity, and inclusivity- This is a crucial source of information that addresses the requirement for academic organizations to create policies that are current, active, and fluid by design, supporting an ongoing examination of best practices with an overt commitment to continuous improvement, as well as an influence for future leaders who will rise through the ranks. How the leadership and faculty of academic institutions manage cultural and other types of disparities in higher education is one of the most significant difficulties that these institutions face. High racial tensions and the growing demand for equality indicate that major reforms are required to make progress. The pedagogies employed in numerous courses value the interactions that students have with one another and with the instructor in order to learn. In these classes, the teaching/learning environment is created to welcome and model a learning community where students participate in critical conversations and role-playing exercises that encourage perspective awareness and reflection. This is particularly true of diversity courses that aim to promote transformative learning, perspective awareness, group learning, critical discourse, and reflective thinking. Distant learning posed an insurmountable challenge to ensuring equity and inclusivity.

III. Learning through doing- The basic tenet of learning by doing is that as we perform an action, we can learn more about it. Another way to consider this is to approach something more actively rather than just passively learning about it. The claim is that participation in active learning fosters deeper learning and that making errors is acceptable, as long as you learn from them. This way of thinking gave this method a new name: experiential learning. During the times of pandemic demonstration and experiential learning became challenging. Consider being a professor for professions such as doctors or musicians who could not demonstrate or impart such knowledge to their students from the distance of their homes.

IV. Changed role of the teacher –students at the centre of teaching methods - Due to the coronavirus epidemic, the teacher's job has undergone a significant transformation in the last years. Remote learning was thrust to the forefront of every school, college, and educational institution's approach to learning, and teachers were compelled to rethink their delivery strategies to accommodate this new

digital and pandemic - induced reality. Teachers have had to adapt to a new form of delivery at record speed over the past 28 months, which has involved combining small face-to-face sessions with remote classes.

V. Relations & Face-to-face interactions - The provision of social support and information to families, as well as the development of healthy relationships with families, are crucial for high-quality early childhood programs. Children benefit from their early learning experiences when home and schoolwork together to maintain routines and provide support (Raikes and Edwards 2009). For families with disabled children, collaborating and working in partnership with other families to support them in assisting their children in achieving the goals for schooling and everyday living is even more significant (Sheehey 2007). Technology has both beneficial and harmful effects on our personal and professional life as it increasingly permeates both. Because of the increased educational and time commitment standards of the information age, many people now spend less time with their families. According to Knopf and Swick (2008), the information era necessitates greater educational levels and more time commitment, which means that many people will have less time to spend with their families. Meanwhile, technology plays distinctive and important roles in the dissemination of knowledge and resources as well as in the provision of social networking for people.

VI. Teacher professionalization- there is little doubt that the pandemic has made the difficulties of teaching more apparent. To minimize any disruption to learning caused by remote instruction, teachers had to quickly adapt and upgrade their skills. Teachers have participated in trainings to help them upgrade their skills and better adapt to a new reality. However, the long-term effects of this new knowledge and experiences compel teachers to ponder what the future of teaching itself will look like.

VII. Technology as a major component of distant - learning and teaching during a global pandemic- new technology is one of the most potent influences reshaping the roles of educators like teachers and students. Information scarcity was the foundation of the previous style

of instruction. There were few alternative avenues for one to acquire knowledge, therefore teachers and their books served as knowledge oracles. But the world of today is flooded with data from a huge number of print and electronic sources. The primary goal of education today is to assist students understand how to use facts by fostering their capacity for critical thought, problem-solving, making well-informed decisions, and the creation of knowledge that will benefit both the individual student and society. Teachers now have more time to work one-on-one or in small groups with pupils as they are not required to serve as the primary information providers.

Some challenges of the 21st Century's Education

1. What difficulties exist in ensuring that students' learning is unaffected?

The environment we live in is constantly changing and the ability to stay ahead of time is part of one's survival. Educators of today face the challenging need to adapt their pedagogical approaches to meet the needs of their 21st century learners, becoming able to tailor education to meet future needs of both learner and society. Despite this, there have been many difficulties for students, instructors, administrators, and education leaders as a result of the abrupt switch from in-person to online learning.

Difficulties caused by the invisible antagonist

- The use of information and communication technologies (hereinafter referred to as ICT), tools for online teaching and learning, computer and digital literacy, digital skills and competencies became important components of professional success, and it seems they will remain such.
- The move to distant learning, particularly in light of the COVID-19 epidemic, has altered the nature of education in the modern day. Today, efficient use of digital tools and educational resources is viewed as a crucial element in enhancing and raising the value of the educational experience. Through an expanding array of digital technology and resources, students acquire information and educators impart their theoretical and practical experience.

2. How to handle these difficulties if the situation persists?

The required competence in the field of ICT

Students and educators had to adapt quickly to the new realities of the digital format. A foreign language teacher must have a high level of ICT competence, which includes not only the ability to work with webinar programs, such as Zoom, MS Teams, Skype, but also:

- prepare and submit the training material in the electronic form
- choose from the entire variety of ICT tools exactly those that will contribute to the solution of various communicative and methodological tasks
- ensure the active interaction of all participants in the educational process.

It is not enough for a modern teacher to be technologically literate and be able to build and instill appropriate technological skills and abilities in students. They should be able to help students use ICT in order to successfully cooperate, solve emerging problems, master teaching skills and, as a result, become full-fledged citizens and employees

Online Independent learning as an outcome of our new reality:

Since its introduction in the middle of the 1990s, virtual schooling has emerged as a popular approach to remote learning. The most often used definition of a virtual school is an organization recognized by a state or regulatory body that provides education via remote learning, most frequently through the Internet. Although there are many various ways to categorize virtual schools, the three most popular delivery modalities are independent, asynchronous, and synchronous. Right now, the vast majority of students attending virtual schools tend to be a small group of academically bright, driven, and autonomous learners. For many students and educators, the rise of online course designs has altered the learning environment. Maximizing student online peer relationships is commonly advised as a recommended practice in online course design with the goal of creating a strong, if virtual, online learning community. Online education was present before the CoVid19 pandemic, and the following are worth mentioning:

- **Salman Khan** is the founder and faculty of the Khan
- Academy www.khanacademy.org a not-for-profit organization with the mission of providing a free world-class education to anyone,

anywhere. It now consists of self-paced software and, with over 1 million unique students per month, the most- used educational video repository on the Internet (over 30 million lessons delivered to-date).

- **University of People** - <https://www.uopeople.edu>- which offers 100% online, tuition-free degree programs
- **Hundreds of highly regarded colleges and universities** offer 100% online degree programs that enable students to take every class online.

3. Conclusions

The study's instructors/facilitators were able to use and have become proficient in the following tactics despite their limited resources:

- Using Facebook to share information with students, parents/guardians, and other parties
- Creating pertinent worksheets and publishing them for students on social media sites
- Establishing chat groups on Viber and other platforms for learners' convenience. Active discussion with parents and students is facilitated through Viber groups
- Email exchanges with parents and guardians regarding student needs
- Utilizing mobile devices to reach students, creating supplemental worksheets for home- based learning in accordance with MoE's (Ministry of Education) guidelines, adopting MOODLE and other online platforms as workable alternatives.

Some of the tactics used by the facilitators/teachers include those described above. However, findings specifically highlight that:

- There is a lack of capacity to operationalize distance learning modalities and a shortage of appropriate distance learning tools and materials,
- Teachers/facilitators need to work with Ministries of Education to develop catch-up programs or condensed curricula to avoid losing a school year,
- Ramp up information dissemination and awareness-raising activities to inform students, parents, and the public of the risks associated with pandemics, etc.

To ensure that the learning opportunities provided correspond to broader educational objectives within an educational system, it can be crucial to organize digital educational content to align with existing curricula. It is also crucial to make content accessible on a variety of devices and mobile friendly. Universities need to work with internet service providers to help students have free or inexpensive access to online learning. Supporting staff who teach online is also important.

ICT has essentially become a powerful force in changing the educational landscape across the world. In response to COVID-19, education will migrate away from traditional physical classrooms, but this will require planning, collaboration, and thoughtful decision-making.

Planning and assisting with a big learning transformation can be started with the help of this study. We should have hope because the evidence suggests that learners are highly satisfied with and interested in ICT-immersed learning environments. There is little doubt that technology has had a significant impact on young people's online life. The educational aspirations and interests of pupils who have developed digital addictions can be synchronized by this digital revolution.

The level of ICT integration in the teaching process in Albanian schools is not adequate; as a result, this article will help to develop this process in the Albanian educational system, and its findings and recommendations will serve as a guide for future strategies.

REFERENCES:

- Akademia e Shkencave (2002) Fjalor i Gjuhës Shqipe [Dictionary of the Albanian Language], Tiranë: Botimet Toena
- Boris, Gary D. (2000) *Effective Teaching Methods*, 4th ed, Pearson
- Document of Strategy for Development of Preuniversity Education (2014-2020) drafted by Ministry of Education and Science
- Scrivener, James (2011) *Learning Teaching*, 3rd Edition, Macmillan Publishing's
- Adedoyin, O. B., & Soykan, E. (2020). Covid-19 pandemic and online learning: the challenges and opportunities. *Interactive Learning Environments*, 1-13.
- Chea, S., Kieng, S., Leng, P., & Water, T. (2020). Pedagogy of online learning in Cambodia: Revisiting ideas of connection, engagement, attendance, and assessment. *AVI Policy Brief*, 2020(19), 1-9. <https://asianvision.org/archives/publications/CETL> (Center for Excellence in Teaching and Learning). (n.d.). What is the difference between online and blended learning? <https://sta.uwi.edu/cetl/what-difference-between-online-and-blendedlearning>
- Daniel, S. J. (2020). Education and the COVID-19 pandemic. *Prospects*, 49(2020) 91-96. <https://doi.org/10.1007/s11125-020-09464-3>
- Dhawan, S. (2020). Online learning: A panacea in the time of COVID-19 crisis. *Journal of Educational Technology Systems*, 49(1), 5-22. <https://doi.org/10.1177/0047239520934018>

RRUGA DREJT EKSPERTIZËS: ZHVILLIMI I AFTËSIVE NË FUSHËN E PËRKTHIMIT

Dr. Adelina ALBRAHIMI

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: adelina.albrahimi@unitir.edu.al

Prof. Assoc. Dr. Ogerta Koruti Stroka

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës
E-mail: ogerta.koruti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky studim synon të analizojë procesin dhe rrugën e fitimit të aftësive në fushën e përkthimit që çon drejt zhvillimit të një ekspertize të qëndrueshme. Përkthimi është një shkallë e lartë e artit të komunikimit, ku përvoja dhe njohuritë kthehen në çelës për kuptimin dhe shprehjen e saktë të mesazheve nga një kulturë në tjetrën. Kjo analizë përqendrohet në rrugëtimin e përkthyesve nga fazat fillestare të mësimin të gjuhëve të ndryshme deri në arritjen e një niveli të lartë të shkathtësive në përkthim. Me anë të shembujve praktikë dhe studimeve të rastit, do të shqyrtojmë teknikat dhe strategjitë që përkthyesit ndjekin për të zhvilluar një kuptim të thellë të kontekstit, kulturës dhe gjuhës së origjinës së tekstit, si dhe për të prodhuar një përkthim cilësor dhe të besueshëm në gjuhën e synuar. Kuptimi i thellë i kontekstit, specializimi në fusha të caktuara dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit janë disa nga elementët kyç që kontribuojnë në rritjen e nivelit të ekspertizës së përkthyesve. Duke mbështetur përpjekjet për të avancuar në këtë fushë, kjo analizë synon të ofrojë një vështrim të gjerë mbi rrugën drejt fitimit të aftësive në përkthim dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e shërbimeve të përkthimit në një kontekst global.

Fjalët çelës: përkthimi, eksperti dhe fillestari në përkthim, gjuha burimore, gjuhë e synuar

ABSTRACT

This study aims to analyze the process and pathway towards acquiring skills in the field of translation leading to the development of sustainable expertise. Translation represents a pinnacle of the art of communication, where experience and knowledge converge to accurately understand and convey messages from one culture to another. This analysis focuses on the trajectory of translators from the initial stages of learning different languages to achieving a

high level of proficiency in translation. Through practical examples and case studies, we will explore the techniques and strategies translators employ to develop a deep understanding of the context, culture, and original language of the text, as well as to produce quality and reliable translations in the target language. A profound understanding of context, specialization in certain fields, and the utilization of information and communication technology are some key elements contributing to the elevation of translators' expertise. By supporting efforts to advance in this field, this analysis aims to provide a comprehensive overview of the pathway towards acquiring skills in translation and their impact on enhancing translation services in a global context.
Keywords: translation, përkthyesi ekspert dhe fillestar, mother tangu, target language

Hyrje

Trajnimi në çdo fushë specifike kërkon pikësëpari përkufizimin e qartë të nivelit të ekspertit, pra, përcaktimin e aftësive, të kapaciteteve, të performancës, të etikës e të normave të tjera të nevojshme për dikë për t'u quajtur ekspert në një fushë të caktuar, pasi arritja e nivelit të ekspertit përbën objektivin që duhet të synohet të arrihet nga profesionistët e të gjitha fushave¹. Po ashtu arritja e nivelit të ekspertit shoqërohet me më shumë njohuri të thelluara mbi fushën e ekspertizës. Sipas të njëjtës logjike, është e nevojshme që të përkufizohet niveli i

1. Është e kuptueshme që në literaturë nuk bëhet direkt kalimi nga jo eksperti tek eksperti. Më specifiku, Hoffman, lidhur me ekspertizën njih nivelet e mëposhtme: "I padituri", i cili përkufizohet si dikush që nuk ka fare njohuri për fushën. Arsyja pse Hoffman-i e fillon progresionin zhvillimor me këtë kategori është se në shumë studime të botuara, të ashtuquajturit "fillestarë" janë në fakt "të paditur"; "Fillestari" është dikush që është i ri, dikush që është në provë, ose, për shembull, dikush që do të fillojë studimet në interpretim/përkthim. Dallimi ndërmjet "të paditurit" dhe "fillestarit" është që fillestari është ekspozuar minimalisht me fushën e studimit, ose është prezantuar me të; [...]
Më pas vjen "nxënësi/stazhieri", personi që është duke iu nënshtruar procesit të nxënies, si për shembull një student që i nënshtrohet një programi udhëzimesh, shkon përtej nivelit të prezantimit dhe është gati për të kaluar në nivelin tjetër [...]
"Specialisti" është personi i cili mund të kryejë punën e përditshme në mënyrë kompetente, pa qenë e nevojshme për t'u mbikëqyrur, por që punon bazuar në udhëzimet e marra [...]; ai është punonjës me eksperiencë dhe i besuar;
"Eksperti" është specialisti gjykimet e të cilit janë në mënyrë të spikatur të sakta dhe të besueshme, performanca e të cilit dëshmon për aftësi të dëshmuara dhe përpjekje jo të sforcuara dhe që mund të trajtojë në mënyrë efektive lloje të caktuara problemesh të radha apo të vështira. Po ashtu, eksperti ka aftësi apo njohuri të posaçme që rrjedhin nga eksperiencia e gjerë ose e përqendruar në nënfusha;
Në nivelin më të lartë është "mjeshtri", ekspert i kualifikuar dhe i aftë për të mësuar të tjerët. Tradicionalisht mjeshtrit përbëjnë grupin e elitës, gjykimet e të cilëve përcaktojnë rregulloret, procedurat, standardet ose idealet (Hoffman : 199).

ekspertit përkthyes² në mënyrë që, për arsye trajnimi, ai të shërbejë si niveli i synuar për t'u arritur nga palët e interesuara, si, për shembull, studentët e përkthimit, personat që kanë vendosur t'i dedikohen përkthimit, personat që po shqyrtojnë mundësinë e kapërcimit nga një fushë tjetër e afërt a e lidhur ekspertize në përkthim, personat që kanë përkthyer më parë, por që nuk janë shumë të afirmuar në treg, ose që dëshirojnë të rrisin aftësitë kognitive dhe teknike në fushën e përkthimit, apo çdokush tjetër i interesuar për studime empirike në fushën e përkthimit.

Studimet rreth ekspertizës datojnë nga kërkimet klasike të De Groot-it (1965, 1966) e shoqërohen nga të tjerë pas tij, të interesuar për të zbuluar dasinë ndërmjet aftësive të shahistëve. De Groot (1965) më shumë se gjysmë shekulli më parë konstatoi se teksta nuk kishte dallime të mëdha ndërmjet gjerësisë apo thellësisë së kërkimeve lidhur me lëvizjet e mundshme gjatë lëvizjeve të gurëve të shahut, ekspertët i perceptonin ndryshe problemet që duhet të zgjidhnin. Një tjetër kërkim pionier mbi fushën e ekspertëve dhe të ekspertizës ka të bëjë me qasjet e jo ekspertëve dhe të ekspertëve për të zgjidhur probleme fizike, kryer nga Simon dhe Simon (1978) dhe Larkin, Dcdemott, et al. (1980a, 1980b). Sipas studimeve të tyre, ekspertët dhe jo ekspertët ndryshonin në mënyra të ndryshme: ekspertët ishin në gjendje t'i dilnin përpara problemit dhe të përdornin faktet që kishin për të gjeneruar ekuacionet e përdorura. Po ashtu, ekspertët i zgjidhnin më shpejt problemet dhe me gjasa krijonin një përfytyrim fizik të tyre.

Megjithëse në pamje të parë paragrafi i mësipërm duket si pak ose aspak i lidhur me fushën e përkthimit, logjika e nocionit të ekspertizës dhe të ekspertit është e njëjtë dhe në rastin e përkthimit dhe të interpretimit, madje dhe në çdo fushë tjetër. Studimet empirike tregojnë se ekspertët asociohen me të kuptuarin deri në detaje, për aq sa është e mundur, të njohurive, të arsytimit dhe të posedimit të aftësive të thelluara në fusha të ndryshme, me zhvillimin e instrumenteve metodologjike për t'i përfutuar njohuritë e nevojshme dhe me përshkrimin e ngjashmërive ndërmjet ekspertëve të fushave të ndryshme (Moser-Mercer et al: 108). Künzli dhe Moser-Mercer (1995), në kuadrin e studimeve të tyre empirike mbi proceset e përkthimit dhe mbi *sight translation*³ (Moser-

2. Më vonë në tekst fjala ekspert i referohet ekspertëve përkthyes.

3. Koncepti i *sight translation* i referohet procesit të përkthimit ndërkohë që njëkohësisht e lexon një tekst që e ke fizikisht përpara.

Merser, 1997, në shtyp) shprehen që baza e njohurive të ekspertëve përkthyes ekspertë duket se është disi ndryshe e organizuar.

Ashtu si dhe në fusha të tjera, zhvillimi i ekspertizës në fushën e përkthimit kërkon integrimin e shumë nënaftësive dhe nënproceseve të përpunimit gjuhësor, një pjesë e të cilave ndodhin dhe paralelisht, si për shembull proceset e të kuptuarit të gjuhës, proceset sintaksore dhe semantike (Marsen-Wilson dhe Taylor 1980), duke vënë në punë dy sisteme gjuhësore në të njëjtën kohë, pra gjuhën burimore dhe gjuhën e synuar (Paradis 1993), dhe prodhimin gjuhësor, pra përpunimin sintaksor dhe semantik, përfshirë dhe dekodimin gramatikor dhe fonologjik (Levelt 1989). Megjithëse jo aq i ngjeshur sa procesi i interpretimit, përkthimi është proces i lodhshëm dhe shumë kërkues, përfshin kombinimin e shumë nënaftësive, përdorimin e teknikave dhe të strategjive, të cilat duhet të mësohen si të tilla për të rritur gjasat për t'u bërë ekspert.

Nën optikën e argumentit të sipërpërmendur, personat e interesuar për t'u bërë profesionistë, apo për të studiuar më shumë në fushën e përkthimit duhet të kuptojmë fillimisht natyrën e ekspertizës dhe mënyrën sesi përvetësohen apo nxihen aftësitë për të qenë në gjendje të arrihet niveli i ekspertit. Kërkimet në fushën e përvetësimit ose nxënies së aftësive janë përqendruar në fusha ku ekspertiza dhe performanca e lartë konsiderohen si rezultante të të nxënimit dhe të praktikës. Kërkuesit kanë hulumtuar ekspertizën në fusha të tilla si sporte, arte, shkenca dhe në fusha të tjera kongnitive, duke përfshirë dhe përkthimin dhe interpretimin.

Megjithëse me prejardhje të ndryshme, Hoffman (1997), Moser, Frauenfelder, Casado dhe Kunzl (2000), Ericsson (2001) dhe Moser (2008) të gjithë shqyrtojnë procesin e përfitimit të aftësive kryesisht në fushën e interpretimit, por edhe të përkthimit, dhe identifikojnë faza të nxënies së aftësive si mjet për akumulimin e njohurive prej eksperti.

Struktura e njohurive të ekspertit

Eksperti "... konsiderohet përgjithësisht si dikush që ka fituar një nivel të lartë performance në një fushë të caktuar si rezultat i viteve të eksperiencës " (Moser-Mercer et al, 2000). Ndryshe nga një fillestar, ("... i cili zakonisht përkufizohet si dikush që ka pak ose aspak eksperiencë në një fushë të caktuar"), ekspertët kanë ide më të mirë dhe aftësi për ta parë punën në një kuadër më të përgjithshëm. Ata e

marrin informacionin në segmente apo njësi dhe bazuar në modelet e përsëritura, dhe janë në gjendje t'i identifikojnë shpejt problemet në mënyrë që të përcaktojnë se çfarë përgjigje do t'i japin situatës (Sternberg, 2003). Ekspertët kanë të ndërtuara skema që i ndihmojnë që njohuritë t'u shfaqen si më të zakonshme dhe më implicite (De Groot, 1965). Baza më e gjerë dhe më e organizuar e njohurive që kanë i bën ata të aftë të kenë arsyetim më të mirë, ta përpunojnë informacionin më shpejt dhe të përshtaten lehtë me situatat e reja.

Sipas Moser-Merser et al 2000, lidhur me interpretimin, ekspertiza⁴ ndahet në katër fusha njohurish (Moser-Mercer et al, 2000):

- njohuri faktike: ku eksperti percepton më shumë lidhje asociative dhe të fushës sesa një i ri në profesion;
- njohuri semantike: ku eksperti percepton më shumë lidhje ndërmjet kuptimit dhe kontekstit;
- njohuri skematike: ku eksperti percepton skemat e llojeve të ndryshme të fjalimeve dhe diskurseve;
- njohuri strategjike: ku eksperti percepton lidhjet ndërmjet të njohurës dhe të panjohurës, ndërsa i riu në profesion ngecet tek e panjohura;

E përkthyer më specifikisht në fushën e përkthimit, skema e mësipërme kuptohet si më poshtë.

Së pari, ekspertët kanë informacion faktik më mirë të organizuar, pra mund të krijojnë më shumë lidhje asociuese me fenomene të caktuara, situata apo kontekste, ose dhe lidhje të fushës. Për shembull, nëse një tekst flet për *Council of the European Union* si organi ku mbledhen së bashku përfaqësuesit e qeverive të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, për ekspertin është e qartë, madje i pallogaritshëm si problem përkthimor, që bëhet fjalë për *Këshillin Evropian*, ndërkohë për një fillestar ka shumë të ngjarë që përkthimi të jetë *Këshilli i Evropës*, variant i cili është kryekëput i gabuar jo vetëm nga pikëpamja gjuhësore por edhe nga pikëpamja institucionale dhe filozofike, pasi Këshilli i Evropës është organ me 48 shtete anëtare, që përmban shumë më shume shtete anëtare se Bashkimi Evropian. Në rastin e ekspertit, për të është e natyrshme që ai automatikisht të asociojë tekstin me funksionimin e institucionit ose të institucioneve, ndërsa në rastin e fillestarit vëmendja përqendrohet tek gjegjëset linguistike, tek teksti objekt përkthimi dhe jo tek njohuritë e përgjithshme.

4. Megjithëse Moser-Merser i referohet interpretimit *per se*, këto fusha njohurish lidhen edhe me përkthimin.

Së dyti, gjatë përkthimit të një teksti të caktuar, eksperti ka një bazë terminologjike të organizuar, terma gjegjës për një organizim të caktuar dhe informacion që lidhet specifikisht me fushën e njohurive. Le të marrim si shembull tekstet e mëposhtme:

(teksti në gjuhën burimore)

The member States' basic obligation is to **“secure to everyone within their jurisdiction the rights and freedoms defined in Section I of this Convention”** (which includes, for those States Party to the various Protocols, the obligation to secure the rights and freedoms defined in those Protocols).

(teksti në gjuhën e synuar – versioni i fillestarit)

Detyrimi kryesor i shteteve anëtarë është që **“t'i sigurojë gjithkujt brenda juridiksionit të tij të drejtat dhe liritë që përcaktohen në Seksionin I të kësaj Konvente”** (ku përfshihen, për shtetet palë në protokollet e ndryshme, detyrimi për të siguruar të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këto Protokolle).

(teksti në gjuhën e synuar – versioni i ekspertit)

Detyrimi bazë i shteteve anëtarë është që **“t'i sigurojë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë që përkufizohen në Seksionin I të kësaj Konvente”** (ku përfshihen, për shtetet palë në protokollet e ndryshme, detyrimi për të siguruar të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këto Protokolle).

Megjithëse fillestari që ka ofruar përkthimin në paragrafin e dytë është për t'u përgëzuar për përkthimin e bërë, prapëseprapë dallimet ndërmjet versionit të tij dhe versionit të ekspertit shkojnë përtej fjalëve të përzgjedhura, lidhen me të kuptuarit e nocioneve dhe të funksionimit të së drejtës. Për shembull, në rastin e termit *“gjithkujt”*, fillestari është munduar të gjejë një term sa më gjithëpërfshirës të jetë e mundur, ndërkohë që nuk duket se e ka të qartë se cilët janë palët e përfshira në këtë term. Në rastin e përkthimit *“çdokush”* eksperti përkthyes e di që termi është shumë i gjerë dhe përfshin jo shtetasit e shtetit në fjalë ashtu siç përfshin edhe shtetasit, pasi të drejtat nuk janë vetëm për qytetarët e një shteti; ai po ashtu e di që termi përfshin dhe personat juridikë (p.sh. kompani-të, OQJ-të, etj.) ashtu siç përfshin dhe personat fizikë (p.sh. individët dhe grupe të caktuara njerëzish).

Po ashtu, eksperti është i gatshëm t'i transferojë njohuritë nga një fushë tek tjetra, si për shembull, ai mund të përdorë njohuritë e

tij ligjore gjatë përkthimit të një rregulloreje për tregtinë. Nga ana tjetër, njohuritë semantike bazohen në kontekst. Eksperti e merr informacionin kontekstual nga përkthimet e mëparshme që ka bërë, nga takimet konsultative në të cilat ka marrë pjesë, nga diskutimet me ekspertët juristë, ose nga informacione që ka rreth qëllimit të një instrumenti/teksti të caktuar ligjor, a fushe përkatëse.

Së treti, përkthyesi ekspert ka njohuri skematike në formën e formulave “të gatshme për përdorim”, ose terminologji të njohur për shkak të ekspozimeve të tij të mëparshme. Le të shohim paragrafët e mëposhtëm:

(teksti në gjuhën burimore)

“Inhuman treatment” must reach a minimum level of severity, and “cause either actual bodily harm or intense mental suffering”. It need not be deliberate nor inflicted for a purpose. In the typical case of injuries in custody, where a person is in good health before arrest or detention and is proved to be injured after it, the burden of proof is on the authorities to show force was not used, or was not excessive, or was justified by the victim’s own conduct. Undue restraint during arrest or of a psychiatric patient can also amount to inhuman treatment.

(Teksti i përkthyer nga eksperti përkthyes)

“Trajtimi çnjerezor” duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie dhe “të shkaktojë ose dëmtim trupor, ose vuajtje intensive mendore”. Ai nuk është i nevojshëm që të jetë i qëllimshëm, dhe as të kryhet për një qëllim. Në rastin tipik të keqtrajtimit në paraburgim, kur një person është në gjendje të mirë shëndetësore përpara arrestimit ose ndalimit dhe provohet se ka pësuar dëmtim më pas, barra e provës i takon autoriteteve për të treguar që nuk është ushtruar forcë, ose që forca nuk ka qenë e tepruar, ose që ajo ka qenë e justifikuar nga sjellja e viktimës. Kufizimi i panevojshëm i një personi gjatë arrestimit, ose i një pacienti psikiatrik mund të çojë në trajtim çnjerezor.

Është e qartë që përkthimi i mësipërm është kryer nga një ekspert përkthyes. Terma të tilla si trajtim çnjerezor, akt i qëllimshëm, apo i kryhet për një qëllim, paraburgim, barra e provës, zor se mund të përdoren me kaq saktësi nga një fillestar. Këto terma përdoren ekzaktësisht siç përdoren në instrumentet ndërkombëtare, si për

shembull në Konventë, dhe siç përdoren në legjislacionin e brendshëm të Shqipërisë, duke siguruar parimin e *konsistencës*, i cili është shumë i rëndësishëm në gjuhën ligjore.

Së katërti, njohuritë strategjike i lejojnë ekspertit të përdorë strategji për zgjidhjen e problemeve të natyrave të ndryshme që mund të hasen gjatë procesit të përkthimit. Le të shohim shembullin e mëposhtëm:

(teksti në gjuhën burimore)

Deportation and extradition: deporting or extraditing a person to another country where they face a real risk of treatment can result in a breach by the deporting State. In most cases the decision to deport etc. will be taken at a high judicial or governmental level. But the conditions of return of a deportee are often the responsibility of police or immigration officers. Humane conditions should always be ensured and a person who is medically unfit to travel should not be forced to do so.

(tekst i përkthyer nga eksperti përkthyes)

Dëbimi dhe ekstradimi: dëbimi ose ekstradimi i një personi në një shtet tjetër ku ai haset me një rrezik real të trajtimit mund të çojë në shkelje nga shteti dëbues. Në pjesën më të madhe të rasteve, vendimi për dëbim, etj., merret nga niveli i lartë gjyqësor ose qeveritar. Por, kushtet e kthimit të të dëbuarit shpesh janë përgjegjësi e policisë ose e oficerëve të migracionit. Gjithmonë duhet të sigurohen kushte humane. Një person që është i pamundur të udhëtojë nga pikëpamja mjekësore nuk duhet të detyrohet të udhëtojë.

Në rastin e një teksti të tillë, gjasat më të mëdha për një fillestar janë që *deportation* të përkthehet si *deportim*, e madje përkthyesi të mos jetë në gjendje as të bëjë dallimin ndërmjet *deportimit* (sipas tij) dhe ekstradimit. Në rastin e ekspertit përkthyes, si strategji për zgjidhjen e problemit përkthimor është konsultimi i dokumenteve të tjera të referencës. Ai e di që të dyja si *deportation* dhe *extradition* janë të drejta themelore të mbuluara nga *Konventa e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*, kështu që do t'i referohej këtij dokumenti për të qenë i sigurt për përkthimin dhe për t'u siguruar për dallimet ndërmjet dëbimit dhe ekstradimit.

Përveç njohurive të ekspertit, Hoffman e identifikon segmentimin më të mirë të informacionit, vendimmarrjen e shpejtë, intuitën, vetëbesimin

dhe aftësinë për të parashikuar atë çfarë ndodh gjatë interpretimit ose shkruhet në tekstin objekt përkthimi si karakteristika të ekspertëve përkthyes.

Ekspertiza është e lidhur po ashtu me *zgjidhjen e problemit*, me aftësinë për të përdorur një ose më shumë aftësi për t'u bërë ballë situatave të vështira (Kintsch, 1988). Ekspertiza e zakonshme është aftësia për të zgjidhur me efektivitet probleme të zakonshme dhe probleme të reja që dalin gjatë procesit të përkthimit.

Pra, me fjalë të tjera, ekspertizë do të thotë njohuri e thelluar dhe kompetencë në fushën e ekspertizës, ndërsa në rastin e përkthimit do të thotë njohuri të thelluara dhe kompetencë në gjuhë dhe në fushën e tekstit objekt përkthimi. Nga ana tjetër *ekspertiza adaptive* është aftësia për t'ju përshtatur situatave të reja, për të përmirësuar performancën me kalimin e kohës, dhe për t'u angazhuar në metakognicion për të siguruar një performancë jo vetëm më efeciente, por edhe në një nivel më të lartë profesionalizmi. Gjithsesi, kjo lloj ekspertize mund të arrihet vetëm nga një përqindje e vogël ekspertësh.

Në përgjithësi, autorët që janë marrë me analizën e nivelit të ekspertëve bien dakord që njohuritë e ekspertëve në përkthim varen nga aftësitë ekzistuese: njohja e mirë e gjuhës burimore dhe e gjuhës së synuar dhe e kulturave të lidhura me to, e shoqëruar nga «njohuri të thelluara» (Moser) dhe «njohuri gjithëpërfshirëse» (Hoffman).

Po ashtu, studimet tregojnë se njohuritë në nivel eksperti, të kombinuara me “praktikën e qëllimshme” (Ericsson) dhe me motivimin (Moser), njihen si elementë kryesorë të një eksperti dhe i bëjnë atij të mundur të përballet me situata të reja dhe stresuese me më pak përpjekje. Ekspertiza i lejon përkthyesit të merret më efektivisht me “të panjohurat”, të tilla si fjalori, shprehje a fusha të panjohura, dhe të jetë më fleksibël në zgjidhjen e problemeve.

Zhvillimi i aftësive

Pasi të kuptohet se çfarë duhet që dikush të bëhet apo të quhet ekspert, është e rëndësishme të shpjegohet sesi përvetësohen aftësitë për të fituar ekspertizë dhe për t'u bërë ekspert.

Përvetësimi dhe zhvillimi i aftësive është proces gradual, e ku luajnë rol shumë faktorë, të tillë si motivimi, vetëbesimi, kapaciteti, qasja, aftësia (Moser-Mercer, 2008).

Megjithëse mënyra e përvetësimit ose e fitimit të aftësive është studiuar shumë në shkencat e ndryshme, jo shumë është thënë në mënyrë të strukturuar për të në fushën e përkthimit. Megjithatë, meqenëse mënyra e përfitimit të aftësive është e njëjtë thuajse në të gjitha fushat, autorja e këtij punimi është e mendimit se e njëjta logjikë fitimi apo përvetësimi aftësish aplikohet dhe në fushën e përkthimit. Për t'ju përmbajtur kësaj logjike, ia vlen të nënvizohet se ndërsa Ericsson e ka përqendruar kërkimin e tij në përvetësimin e aftësive tek sportet, aktivitetet e kohës së lirë apo tek llojet e tjera të aktiviteteve para se të analizonte interpretimin, autorë të tillë si Moser-Merser, Hoffman, Kilary dhe të tjerë ia kanë drejtuar kërkimet e tyre specifikisht interpretimit dhe të gjithë ata kanë arritur në të njëjtin përfundim lidhur me etapat që përfshihen në përvetësimin e aftësive. Pavarësisht se përdorin koncepte të ndryshme, të gjithë përshkruajnë fazat specifike kognitive dhe vijimësinë e zhvillimit të aftësive si instrumente të domosdoshme për të shkuar drejt ekspertizës, koncepti i cili trajtohet dhe më sipër.

Është me interes të theksohet se Moser *et al* theksojnë se vijimësia në përvetësimin e aftësive ndonjëherë ndalon. Nuk është e pazakontë për shembull që përkthyesit në fazën “asociuese” (lexo më sipër) të arrijnë në një nivel “stanjacioni” dhe aftësitë e tyre të mos zhvillohen më tej. Një shpjegim i kësaj situatë është rritja e automaticitetit të nënaftësive të pengojnë memorien e punës. Për këtë arsye duhet një lloj “ristrukturimi” i memories për të përparuar më tej.

Të gjithë autorët theksojnë nevojën për praktikë të rregullt dhe ushtrime të specifikuar sipas aftësive që duhet të përvetësohen, në mënyrë progresive dhe të strukturuar për të organizuar më mirë njohuritë, për të akumuluar eksperiencën, për të rritur kapacitetin e memories, për të lehtësuar automaticitetin dhe, së fundmi, për të ndërtuar ekspertizën. Po ashtu, është me interes të theksohet se autorë të ndryshëm, pavarësisht nga fusha e ekspertizës, kur bëhet fjalë për ekspertët nënvizojnë fort rëndësinë e kohës. Për shembull, lidhur me sportet, literatura ekzistuese sugjeron se maksimumi i ekspertizës arrihet në mes dhe në fund të të njëzetave. Sipas Ericsson-it, për t'u bërë ekspert në çdo fushë, duhen të paktën 10 vjet eksperiencë, ndërkohë Hoffman sugjeron gjashtë deri në dhjetë vjet eksperiencë për t'u konsideruar ekspert në interpretim. Nisur nga shumëllojshmëria e teksteve që i nevojiten një përkthyesi të përkthejë gjatë eksperiencës së tij, nevojës për të studiuar në vijimësi gjuhën mëmë dhe gjuhën e

dytë apo gjuhën e huaj, apo edhe gjuhë të tjera, bazuar në literaturën ekzistuese për aftësitë dhe ekspertizën dhe eksperiencën e saj personale, autorja e këtij punimi është e mendimit që një përkthyesi i nevojitet dhjetë vjet eksperiencë për t'u quajtur ekspert.

Implikimet për përkthimin dhe trajnimin e përkthyesve

Përsa i përket trajnimit të studentëve të përkthimit, përkthyesve të rinj në moshë a në profesion, është e rëndësishme të përdoret një qasje që e çon studentin/profesionistin e ri nga faza kognitive, tek ajo asociative dhe më pas autonome nëpërmjet të cilave mësohen faktet rreth profesionit, detyrës apo projektit të përkthimit dhe procesit që duhet kaluar për të përfunduar projektin. Është e rëndësishme që studentët a përkthyesit e rinj paralelisht me teorinë mbi traduktologjinë të përballen gjithnjë e më shpesh me praktikën e përkthimit, të jenë në gjendje të analizojnë gabimet e tyre, të mësojnë t'i eliminonjë ato, të ndërtojnë kapacitetet për të bërë lidhjen ndërmjet pjesëve të ndryshme të procesit dhe të analizojnë sesi këto pjesë të ndryshme kontribuojnë për një punë të suksesshme, të përvetësojnë të gjitha procedurat e përkthimit nëpërmjet një trajnimi të qëndrueshëm dhe praktik aq sa procesi dhe puna e të përkthyerit t'u vijë natyrshëm dhe të dinë si të kërkojnë, si të hulumtojnë, kujt t'i drejtohen dhe si t'u gjejnë zgjidhje problemeve që mund t'u dalin në praktikë.

Për ta ngritur një aftësi të fituar rishtazi në nivelin e ekspertizës, është e nevojshme që praktika e qëllimshme dhe analitike të bëhet pjesë e rutinës së studentëve apo të përkthyesve të rinj. Kjo është mënyra e vetme që bën të mundur eliminimin e pikave të dobëta, aplikimin e rregullave specifike për probleme specifike dhe, pas rritjes së njohurive taktike dhe organizimit më të mirë, dhe ndërtimin e strategjive për zgjedhjen e problemeve të hasura.

Po ashtu, mënyra sesi praktikohet studenti apo përkthyesi i ri ka ndikim shumë cilësor mbi ekspertizën. Për t'u bërë *ekspert adaptiv*, në gjendje për të reflektuar mbi strategjitë dhe për të modifikuar çfarë është e nevojshme për t'u përshtatur me një situatë të re (interpretimi) (Moser-Mercer et al, 2000, Moser-Mercer, 2008), është e rëndësishme që studentët të mos praktikohen thjesht në përgjithësi. Në fakt ata duhet t'i ndajnë ushtrimet mbështetur në aftësi të caktuara, procedurën dhe mënyrën e të funksionuarit të së cilave ata e kuptojnë, dhe duhet të përqendrohen dhe të punojnë në mënyrë të ndërgjegjshme. Ky është parimi i praktikës së qëllimshme. Në mënyrë që studentët të jenë në

gjendje të bëjnë përparime në këtë drejtim, trajnimi duhet të theksojë të nxënit metakognitiv, organizimin efektiv të njohurive dhe situata komplementare në të cilat përvetësohen aftësitë e caktuara (Moser-Mercer, 2008).

Përfundime


Fitimi i aftësive drejt ekspertizës në fushën e përkthimit është një rrugë e vështirë, por e vlefshme. Procesi i mësimit dhe zhvillimit të aftësive përmes përvojës dhe njohurive të thelluara është themelore për të arritur një nivel të lartë të përkthimit cilësor. Përkthyesit duhet të jenë të përkushtuar në vazhdimin e mësimit të gjuhëve të ndryshme, në kuptimin e thellë të kulturave dhe kontekstit, si dhe në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Gjithashtu, është thelbësore që përkthyesit të specializohen në fusha të caktuara, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë ndërmjetësimit të mesazheve në mënyrë të saktë dhe të qartë në gjuhën e synuar. Krijimi i një lidhjeje të ngushtë me të dyja kulturat dhe njohuria e thellë e kontekstit janë elemente kyçe që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së përkthimit.

Përmirësimi i aftësive në përkthim nuk është vetëm një rrugë drejt zhvillimit personal, por gjithashtu është një kontribut i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve të përkthimit në një ambient global. Duke pasur parasysh rëndësinë e përkthimit në ndërkombëtarizimin e informacionit dhe komunikimit, përkthyesit duhet të vazhdojnë të kërkojnë për mënyra për të përshpejtuar zhvillimin e tyre në këtë fushë, duke u përqendruar në krijimin e ekspertizës së qëndrueshme për të ofruar përkthime të besueshme dhe cilësore për audiencën e tyre të synuar. Po ashtu, është e rëndësishme të nënvizohet se pavarësisht nga orët e praktikës dhe nga eksperiencia, për shkak të vështirësisë së përvetësimit të aftësive për një punë të vështirë dhe shumë komplekse, si përkthimi i *acquis communautaire*, duhet të kuptohet nga të gjithë rëndësia e madhe e motivimit, praktikës së rregullt dhe të synuar, nxjerrja e mësimave nga praktika dhe gabimet për të përmirësuar performancën dhe përparimi drejt rrugës së ekspertizës.

BIBLIOGRAFIA

- Ericsson, Anders.(2001). Expertise in interpreting. An expert performance perspective. In *Interpreting* (pp.187-220). John Benjamin Publishing Company. Amsterdam/Philadelphia.
- Ericsson, K A, Krampe, R Th, & Tesch-Römer, C (1993). The role of deliberate practice in the acquisition of expert performance. *Psychological Review*, 100, 363-406.
- Hoffman, Robert.(1997). The cognitive psychology of expertise and the domain of interpreting. In *Interpreting* (pp.189-230). John Benjamin Publishing Company. Amsterdam/Philadelphia.
- Kintsch, W (1988). The role of Psychological Review, 95, 163-182.
- Kiraly D C (1997). Think-aloud protocols and the construction of a professional translator self-concept. In J H Danks, G M Shreve, S B Foundatin, and M K McBeath (Eds). *Cognitive processes in translation and interpreting* (pp 137-160). Thousand Oaks, CA: Sage.
- Moser, Barbara.(2008). Skill acquisition in interpreting: a human performance perspective. In *The Interpreter and Translator Trainer* (pp.1-28). St Jeromes Manchester.
- Moser-Mercer, B (in press). Acquiring expertise in sight translation. In S Lambert (Ed), *A cognitive approach to interpreter training*.
- Moser-Mercer, B., Frauenfelder, U., Casado, B. & Künzli, A. (2000). Searching to define expertise in interpreting. In K. Hyltenstam & B. Englund-Dimitrova (Eds.), *Language processing and simultaneous interpreting* (pp. 107-132). Amsterdam: John Benjamins.
- Moser-Mercer, B et al (2000). The rocky road to expertise in interpreting: Eliciting knowledge from learners. In M Kadric, K Kaindl, and F Pochhacker (Eds). *Translations-wissenschaft* (pp 3939-352). Tübingen, Germany: Stauffenburg Verlag.
- Séguinot, C (Ed) (1989). *The translation process*. Toronto: York University
- Shreve, G (1997). "Introduction". In J Danks, G M. Shreve, S B Fontain, and M K McBeath (eds), *Cognitive Processes in Translation and Interpreting*. Thousand Oaks, London and New Delhi: Sage.
- Simon, H A (1973). A simulation of memory for chess positions. *Cognitive Psychology*, 5, 29-46.



Quels outils linguistiques et stratégies
de communication pour une
valorisation du patrimoine culturel
matériel et immatériel national?

Botimi me titull « Quels outils linguistiques et stratégies de communication pour une valorisation du patrimoine culturel matériel et immatériel national? » është fryt i projektit të përbashkët dyvjeçar të Fakultetit të Gjuhëve të huaj me Universitetin e Torinos dhe me Universitetin e « St. Kliment Ohridski » de Sofias. Ai është një studim gjuhësor në fushën e komunimit turistik që fokusohet në ligjërimin turistik dhe tekstet turistike, praktikat ligjërimore dhe regjistrat gjuhësorë të guidave turistike por edhe në sfidat ndërkulturore të përkthimit të tyre në gjuhë të huaj. Nxjerrja në pah dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore lidhet ngushtë me komunikimin dhe mjetet që krijojnë imazhin, identitetin e vendit dhe e kthejnë këtë fundit në një destinacion të parapëlqyer nga turistët.

Meqë komunikimi është një disiplinë e shekullit XX, ne jemi të vetëdijshëm se teoritë dhe studimet në këtë fushë nuk janë të shumta dhe shpesh vuajnë nga mungesa e legjitimitetit. Madje, për sa i përket komunikimit turistik, studimet e ndërmarra nga specialistët e komunikimit, janë të pakta dhe të botuara këto vitet e fundit, çka e bën vërtet të dobishëm çdo kontribut në këtë fushë. Projekti me të njëjtin titull i ndërmarrë nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (UT), nga Universiteti i « St. Kliment Ohridski » i Sofias dhe Universiteti i Torinos, kishte për qëllim të eksploronte nga pikëpamja e strategjive komunikative dhe e gjuhësisë, komunikimin mbi trashëgiminë kulturore kombëtare të tri vendeve partnere, Bullgarisë, Shqipërisë, Italisë. Konstatimet mbi rëndësinë dhe performancën e këtij komunikimi në kontekstin e strategjive dhe orientimeve kombëtare dhe evropiane të zhvillimit të turizmit kulturor dhe të trashëgimisë kulturore, të paraqitura në këtë botim, shoqërohen me një listë rekomandimesh dhe mjetesh gjuhësore të cilat mund të përforcojnë dhe ta kalibrojnë si duhet këtë komunikim kaq të rëndësishëm për të vënë në dukje pasurinë dhe vlerën e trashëgimisë kulturore kombëtare.

Në këtë botim pasqyrohet puna kërkimore, e tri ekipeve universitare, në periudhën 2019 - 2020 që konsiston në një analizë të mprehtë e cila tregon se si secili vend ndërton imazhin « e dëshiruar » për ofertën e vet turistike të trashëgimisë së tij kombëtare materiale dhe jomateriale, përmes studimit të një korpusi të përzgjedhur me kujdes si dhe duke evidentuar të metat dhe mangësitë e këtyre praktikave me qëllim që të mund të promovojmë praktikat më të mira. Punimi synon gjithashtu :

- të identifikojë dhe të listojë mjetet e komunikimit turistik dhe të analizojë objektivat e promovimit lokal dhe ndërkombëtar të trashëgimisë materiale dhe jomateriale ;
- të tregojë se si strukturat veprojnë dhe ndikojnë përmes mjeteve të komunikimit mbi zhvillimin e turizmit duke analizuar impaktin e tyre në terren
- të analizojë strategjitë e komunikimit përmes një qasjeje antropologjike kulturore, historike, artistike, gjuhësore, ligjërimore dhe ikonike duke shkëmbyer mes partnerësh praktikatat më të suksesshme ;
- të formulojë rekomandime për të përmirësuar komunikimin turistik.

Ky botim i artikuluar në tri pjesë, sipas kontributit të secilit partner të projektit, ofron rezultate të prekshme dhe një kontribut të drejtpërdrejtë për të përmirësuar punën e institucioneve publike dhe private që operojnë në fushën e turizmit.

Prof. Dr. Saverina Pasho



SHËPJEGIM I SONETEVE TË ZGJEDHURA
TË SHEKSPIRIT PËRMES ANALIZËS
KRAHASUESE PËRKTHIMORE

e autorit Ukë Zenel BUÇPAPAJ

Ukë Zenel Buçpapaj, - përkthyes i shquar, poet, njohës e hulumtues i përkushtuar i letërsisë, - paraqitet me një monografi të mirëfilltë shkencore kushtuar soneteve të Shekspirit, - që qarkullojnë në shumë gjuhë, madje në disa motërzime, - përkthyer nga Napoleon Tasië Vedat Kokona. Njohja me themel e mjeshtërisë së përkthimit, ideja se përkthimi (emërtuar shpesh si rikrijim, rikëndim) është i mundshëm dhe arrin të përcjellë në plotni një (krye)vepër, pavarësisht dallimeve mes gjuhës së origjinalit dhe asaj pritëse, sidomos nëpërmjet gjetjes nga ana e përkthyesit të një hapësire shpirtërore të përbashkët, ku lexuesi ftohet të njohë e të përjetojë pikërisht falë thelbit të vet njerëzor e jo prej folësi të një gjuhe të caktuar, përbëjnë thelbin e monografisë.

Autori sjell ose risjell në vëmendjen e studiuesve të letërsisë pikëpamje të veçanta, vëzhgime, fakte, argumente që janë rezultat i përvojës së tij tejet të pasur si përkthyes, por edhe si poet e njohës i thellë i letërsisë. Ukë Zenel Buçpapaj ka dhunti të padiskutueshme si përkthyes, ndaj edhe monografia e tij ka thellësinë, mençurinë dhe çiltërsinë e domosdoshme, sidomos në këtë epokë kur jo vetëm përkthimet, por edhe e folmja dhe e shkruara po i nënshtrohen hap pas hapi gjuhës së brendshme horizontale të teknologjisë.

Një veçori e monografisë së Ukë Zenel Buçpapajt është eklektizmi i mbështetur në përvojë e empati, çka u jep rëndësinë e pranueshme e joidhujtare teorive, shkollave, bindjeve apo pikëpamjeve e opinioneve në modë. Ky eklektizëm, që mund të quhet edhe *dëshmi e drejtpërdrejtë e një përvoje të rrallë falë pasurisë dhe veçanësisë së shqipes*, ndihmon në pasurimin e komunikimit e mirëfilltë ndërkulturor dhe ruan sinorët e imagologjisë (pa u dhënë autorëve të ndryshëm vlera që s'i kanë, por sidomos pa ua shtrembëruar apo krasitur vlerat që kanë).

Sipas autorit, janë format e ndryshme brenda gjuhësore, kodet e fjalëve, ato që sjellin prorre një natyrshmëri dhe ngjizin një komunikim të plotë ndërkulturor. Ky i fundit është vendimtar për kontekstin e sotëm që vepron me sasi industriale dhe ia ruan me fanatizëm të drejtat e autorësisë çdo shprehje sado të diskutueshme artistike, duke holluar shpesh fatalisht kufirin mes një veprë vërtet origjinale, burimore, dhe replikave, kopjeve, rimarrjeve të panumërta.

Në monografinë e tij shkencore, Ukë Zenel Buçpapaj sjell shembuj të detajuar për kontekstet në të cilët mund të përdoret me vërtetësi e ndershmëri një fjalë / shprehje / fjali; për skajet ku nis e ku mbaron liria e një përkthimi, me qëllim që të mos humbë as besnikëria ndaj tekstit të fillestar e as shija dhe natyrshmëria e gjuhës pritëse.

Në qendër të monografisë është gjuha e pasur e Shekspirit – njëra nga më të pasurat në letërsi, njëra nga më befasueset në mendësi, por edhe

njëra nga më të hulumtuarat e të idealizuarat në studimet letrare. Siç dihet, në veprën e Shekspirit, sonetet kanë një vend të veçantë. Vlerat e tyre estetike e artistike i detyrojnë jo pak famës së autorit – dhe kjo e vështirëson përkthimin e tyre, nëse përkthyesi është stërvitur më tepër me dramaturgjinë shekspiriane, sesa me mjetet me të cilat Shekspiri ngjiz metaforat, veçmas në çështjet e dashurisë, mallit, vuajtjeve, trishtimeve, shndërrimit të përvojave dashurore në vargje. Ukë Zenel Buçpapaj i trajton me përparësi pengesat që hasen në raste të tilla dhe rreziqet që një pasaktësi e vogël të rrënojë krejt ngrehinën poetike. Falë rregullave të sonetit, pengesat dhe joshjet për të mos kuptuar, keqkuptuar apo dëmtuar diçka, shumëfishohen. Autori sjell shembuj nga studiues si Kefford apo Levendovski, por edhe nga vizioni gjenial i Ferdinand de Saussure mbi fjalën dhe gjuhën në të gjitha rrafshet e tyre, dhe rishpreh besimin / bindjen se, pavarësisht pengesave e dallimeve, ndonjëherë thelbësore, - mes gjuhëve apo mendësive letrare e leximore, - përkthimi është gjithmonë i mundshëm. Vështirësitë renditen në monografi pikërisht si një mësim për përkthyesit e rinj: *Përkthimi është i mundshëm, por aspak i lehtë.*

Ukë Zenel Buçpapaj përqendrohet në monografinë e tij edhe mbi aspektet metrik e ritmik të soneteve të Shekspirit, duke nxjerrë në pah dallimet midis metrit cilësor të anglishtes dhe metrit sasior të shqipës.


Me monografinë e tij kushtuar çështjeve themelore e themeltare të përkthimit, Ukë Zenel Buçpapaj njëherazi pasuron studimet e lëmit përkatës dhe sjell risi të padiskutueshme, që mund të jenë shumë të dobishme për përkthyesit e rinj. Jo rastësisht monografia ka për “shtyllë kurrizore” sonetet e Shekspirit – hapësirë ku stili i Shekspirit u afrohet stileve të sonetistëve të shquar evropianë dhe nuk përdor shumë elemente stilistike nga tragjeditë e tij.

Me çiltërsinë e një talenti të rrallë, autori ka bindjen se, pikërisht ngaqë është vetjak dhe i papërsëritshëm, akti i përkthimit ka nevojë për njohuri të thella teorike. Këto njohuri, me kalimin e kohës, pasurojnë dhuntitë dhe bëjnë të mundur që, të paktën gjatë procesit të shndërrimit të gjuhës së huaj në gjuhë pritëse, përkthyesi të jetë mëkëmbësi ose gati vetë autori i (krye)veprës që po shkruhet edhe në një gjuhë tjetër.

Ukë Zenel Buçpapaj njihet si përkthyes i shquar nga shqipja në anglisht, por edhe si poet e njohës rrënjor i gjuhës shqipe. Monografia e tij shkencore, - që shqyrton gjerësisht e bindshëm çështje thelbësore të përkthimit, duke marrë shembull sjelljen në shqip të soneteve të zgjedhura të Shekspirit, - është njëherazi një arritje vetjake, një ndihmesë e mirëfilltë shkencore dhe një mënyrë të menduari e të përjetuari që e ndihmon lexuesin të njohë më mirë veten, tjetrin dhe letërsinë.

Prof. Dr. Elida Tabaku

LIBRA TË RINJ SHKENCORË



PONS Bildwörterbuch Albanisch
Fjalori me figura Shqip- Gjermanisht
Autorë: Anette Dralle, Ema Kristo
Përpunimi gjuhësor: Ema Kristo
ISBN: 978-3-12-516119-1
Viti i botimit: 2021

Fjalori me figura botuar nga shtëpia botuese PONS në Gjermani përmban 16,000 terma dhe fraza në dy gjuhë (shqip-gjermanisht) nga fushat më të rëndësishme të jetës. Çdo fjalë e gjuhës shqipe është e shoqëruar me transkriptim fonetik. Fjalori është i përshtatshëm për fillestarët (A1) dhe të avancuarit (B2)

Duke patur parasysh rolin e rëndësishëm të figurave në memorizimin e fjalëve, ky fjalor lehtëson dhe mbështet të kuptuarit dhe të mësuarit në mënyrë vizuale.

Fjalori përmban fjalë tipike shqipe nga fusha të ndryshme si: kultura, festat, traditat, kostumet popullore, pushimet, arsimit, mënyra e jetesës, gatimet tipike, atraksionet turistike etj. organizuar në 13 kapituj. Në këto kapituj të renditur tematikisht, gjejmë krahas renditjes fjalë-figurë edhe fjali apo shprehje e formula të rëndësishme për situata të zakonshme të jetës së përditshme që shërbejnë për të realizuar një komunikim të suksesshëm në situata komunikuese reale.

Në mënyrë që të shqiptohet saktë çdo fjalë është shoqëruar me një alfabet fonetikor. Një pasqyrë e karaktereve fonetike të përdorura gjendet në faqen e fundit të fjalorit.

Gjithashtu në fund të fjalorit, në një rubrikë të veçantë, gjendet edhe treguesi i fjalëve në rend alfabetik në shqip dhe gjermanisht.

AKTIVITETE SHKENCORE NË FGJ

Departamenti Gjuhës Gjermane
Një aktivitet nga Grupi mësimesor kërkimor „Qytetërim i Gjuhës Gjermane“

Diskussion im Rahmen der Vorlesung
Landeskunde an der Abteilung für Deutsche
Sprache

„EU – So nah, so fern?“
Martin Zickendraht
(Deutsche Botschaft Tirana)

Mi, 10.05.2023
10.30-12.00
FGJH Raum 209



DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

1. Departamenti Gjuhës Gjermane dhe grupit mësimor kërkimor “Qytetërim i Gjuhës Gjermane”.

Në datën 10.05.2023, ora 10.30 – 12.00, në sallën 209, patëm kënaqësinë të mirëprisnim në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja Z. Martin Zickendraht, Atashe Kulturor i Ambasadës Gjermane në Shqipëri, i cili mbajti një orë të hapur me temë “BE - afër apo larg?”.

Z. Zickendraht ofroi për dëgjuesit një panoramë të qartë të sfidave me të cilat do duhet të përballet vendi ynë për t’u bërë pjesë e Bashkimit European.

Ky aktivitet ishte një mundësi e shkëlqyer për studentët e gjuhës gjermane për të pyetur dhe dëgjuar më shumë rreth rrugës së Shqipërisë drejt Bashkimit European, si dhe për të marrë informacion rreth rolit dhe mbështetjes së Gjermanisë në këtë proces.

2. Departamenti Gjuhës Gjermane dhe grupit mësimor kërkimor Didaktikë

Më datë 05.05.2023, grupi kërkimor-mësimor “Didaktikë / Mësimdhënie” i Departamentit të Gjuhës Gjermane, pati kënaqësinë të organizojë në bashkëpunim me Educational Center dhe përfaqësues të Huber-Verlag, Workshopin me temë “Diversiteti mes studentëve – shumëllojshmëria e ushtrimeve dhe metodave tek Schritte International New”.

UNIVERSITY OF TIRANA
FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES
DEPARTMENT OF SLAVIC AND BALKAN LANGUAGES

SCIFA UNIVERSITY
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIS
Univërsiteti i Universitetit
FEHMI AGANI
SLAVOJE

THE INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE

"THE TERMINOLOGY OF HUMAN FIELDS AND ITS REFLECTION IN DICTIONARIES"

konf.term.2023@gmail.com

FACULTY OF FOREIGN LANGUAGES
MAY | 11th | 2023
HALL "EUROPA", 10:00

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

WORKSHOP
"Kundrime letrare"

me rastin e 100 vjetorit të themelimit të marrëdhënieve shtetërore Shqipëri – Turqi

Me pjesmarrjen e:

- Prof. As. Dr. Adriatik Derjaj -Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. As. Dr. Ahmet Yikik -University of Cyprus, Qipro
- Prof. As. Dr. Anila Mullahi -Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Dr. Alban Foçi -Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Ora 11:00 23 Mars 2023

Salla Argjiro, Godina A, Kati 2
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë



DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

**1. KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE,
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE**

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike të Tiranës, Universitetin e Sofies “St. Klement Ohridski”, Bullgari, si dhe me Universitetin “Fehmi Agani” të Gjakovës, organizoi më datën 11 maj 2023 Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë bosht “Terminologjia në fushat humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë”.

Konferenca përfshiu 4 seksione të ndarë. Konferenca shërbeu si një pikë takimi mes terminologëve, gjuhëtarëve, specialistëve të fushave përkatëse, studiuesve, pedagogëve dhe studentëve të interesuar për leksiko-terminografinë e fjalorëve të fushave humane në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Kjo konferencë u shtri me diskutime të ndryshme nga specialistë brenda dhe jashtë vendit.

2. Workshop me temë “Kundrime Letrare”

Me datë 23.03.2023, në sallën Argjiro të Fakultetit tonë, u mbajt një workshop me temë “Kundrime Letrare” me rastin e 100 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve zyrtare Shqipëri-Turqi.

Ky aktivitet u organizua nga Dega e Gjuhës Turke, me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e profesorëve nga Universiteti i Qipros, Nicosia Qipro; nga Departamenti i Letërsisë, FHF; nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, FGJH.

Prof.As.Dr. Ahmet Yikik , i ftuar nderi nga Universiteti i Qipros, u ndal tek letërsia moderne periferike, zhvillimet e tregimit dhe veprat letrare pas periudhës së independencës.

Në përfundim pedagogët pjesëmarrës dhe studentët drejtuan pyetje dhe këmbyen ide mbi vlerat e letërsisë.

3. Tryezë e rumbullakët me temë: “Rusishtja në tregun e turizmit”.

Në kuadër të aktiviteteve të Grupit Mësimor Kërkimor Gjuhësi-Përkthim të Gjuhës Ruse,

më 29 mars 2023, u organizua tryeza e rumbullakët me temë: “Rusishtja në tregun e turizmit”. Me te ftuar : Z. Erind Sula, Business Development, nga kompania Zenith Trave, Znj. Olga Bardhi, si Përfaqësuese e Departamentit të MICE në ATH American Express dhe studentë të Gjuhës Ruse.

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE &
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE &
UNIVERSITETI IONIAN, GREQI
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA PËRKTHIMIT DHE INTERPRETIMIT &
FONDACIONI GREK I KULTURËS

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

**PËRKTHIMI DHE KOMUNIKIMI,
SFIDAT DHE PËRPARËSITË NË
RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR**

 28 PRILL 2023
ORA 09:00 AM

 Salla "EUROPA"
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

departamenti.greqisht@unitir.edu.al

DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE

1. Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë "Përkthimi dhe Komunikimi, Sfidat dhe Përparësitë në rrafshin ndërkombëtar"

Më datë 28 Prill 2023 u mbajt Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë "Përkthimi dhe Komunikimi, Sfidat dhe Përparësitë në rrafshin ndërkombëtar" e organizuar nga Departamenti i Gjuhës Greke në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Angleze, Universitetin Ionian të Korfuzit dhe Fondacionin Grek të Kulturës. Këtë konferencë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre dy profesorë të ftuar të Universitetit Ionian të Korfuzit, Prof. Georgios Kentrotis dhe Lito Alexaki.



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA



Ekipi kërkimor i didaktikës i
Departamentit të Gjuhës Frënge
organizon workshopin me temë:

**KUADRI EVROPIAN I PËRBASHKËT
I REFERENCAVE PËR GJUHËT-
VOLUMI PLOTËSUES DHE
NDËRMJETËSIMI GJUHËSOR**

 Salla e Trajnimeve 215

 DATA 25. 04. 2023

 ORA 10:00



FORUMI VI I GRAVE FRANKOFONE TË SHQIPËRISË

**"INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA
për fuqizimin e gruas**



**"FIGURA E GRUAS NË RRJETET
SOCIALE"**

 7 MARS 2023

 09.30

 Universiteti i Vlorës
"Ismail Qemali"



DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

1. Workshop: Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët: Volumi plotësues shoqëruës – Aktivitet shkencor i Grupit Mësimor Kërkimor Didaktikë e Gjuhës Frënge

Grupi mësimor kërkimor Didaktikë e Gjuhës Frënge realizoi në datën 25 prill 2023, në ambientet e FGJH-së, workshopin me temë: “Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët: Volumi plotësues shoqëruës”.

Aktiviteti shkencor, i cili bëri bashkë dhe specialistë të tjerë të Didaktikës të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, mundësoi njohjen e shpjegimin nga afër të këtij volumi, si dhe ofroi diskutime të rëndësishme lidhur me udhëzimet për sigurimin e kritereve të larta të mësimin të gjuhëve të huaja dhe objektivave të njohurive të studentëve të gjuhëve të huaja. Në vitin 2018 është publikuar edhe volumi plotësues i këtij kuadri, i cili e ka pasuruar më tej atë në lidhje me aftësitë e ndryshme në mësimdhënie/nxënie të gjuhëve të huaja.

2. “Inovacioni dhe teknologjia për fuqizimin e gruas – Figura e gruas në rrjetet sociale”

Më datë 07.03.2023 në kuadrin e pranverës frankofone. u organizua Forumi VI i Grave Shqiptare Frankofone me temë: “Inovacioni dhe teknologjia për fuqizimin e gruas – Figura e gruas në rrjetet sociale

3. Tryezë E Rrumbullakët: »Komunikimi Dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe Shpirtërore«

Në kuadër të muajit të frankofonisë më 21mars 2023, FGJH organizoi në Shtëpinë e Evropës tryezën e rrumbullakët «Komunikimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore» me pjesëmarrjen e studentëve dhe kolegëve të FGJH-së dhe FHF-së.




La traduzione in albanese
della letteratura italiana
per l'infanzia

1° incontro di studio

Buon 140° compleanno, Pinocchio!



Programma:

10:30 – 11:10 Prof. ROSSANA DEDOLA
Geppetto e Collodi all'inseguimento di Pinocchio

11:10 – 11:30 RADIODRAMMA
Il babbo di Pinocchio sono io

11:30 – 12:10 Prof. As. Dr. MIRELA PAPA
Pinocchio in Albania

12:10 – 12:30 Domande e dibattito

📅 24 aprile 2023
🕒 10:30 AM
📍 Aula 309, Facoltà di Lingue Straniere, UT
🌐 <https://meet.google.com/fji-zkgt-kbu>



Prof. Dr. Klara Kodra

studiosa, scrittrice, traduttrice

**Ricchezza di linguaggio e ricchezza di
messaggio in Landolfi: problemi di traduzione**

DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

1. Takim studimor «Buon 140 compleanno, Pinocchio!»,

Më datë 24 prill 2023, ora 10:30, në kuadrin e projektit shkencor «Përkthimi i letërsisë italiane për fëmijë në gjuhën shqipe» dhe me rastin e 140-vjetorit të botimit të kryeveprës për fëmijë «Aventurat e Pinokut» të shkrimtarit italian Carlo Collodi, Departamenti i Gjuhës Italiane organizon takimin studimor «Buon 140 compleanno, Pinocchio!», me pjesëmarrjen e prof. Rosanna Dedola, studiuese, shkrimtare, kritike letrare.

2. Konferencë me titull “PASURIA E GJUHËS DHE PASURIA E MESAZHIT TEK LANDOLFI: PROBLEME TË PËRKTHIMIT”

Më 27 Tetor 2022, në kuadër të manifestimit të javës së XXII të Gjuhës Italiane nëpër Botë, Prof. Dr. Klara Kodra mbajti një konferencë me titull:

“PASURIA E GJUHËS DHE PASURIA E MESAZHIT TEK LANDOLFI: PROBLEME TË PËRKTHIMIT”, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.



**KONFERENCË
NDËRKOMBËTARE**

**“SI TA BËJMË TRASHËGIMINË TONË
KULTURORE TË FLASË?”**

**KREATIVITET DHE NDËRMJETËSIM NË
NJOHJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE**



8-9 Dhjetor 2022



**Universiteti i Tiranës,
Filiali Sarandë, Shqipëri**



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE

Më datë 22 shtator 2022 u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare “Multilingual education in linguistically diverse context (MELDC3)” organizuar nga FGJH në bashkëpunim me MultiLingNet. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm referues nga 19 shtete të botës, profesorë të FGJH-së dhe miq të ftuar.

Më 20-21 tetor 2022, FGJH-UT në bashkëpunim me Universitetin e Poitiers- së organizoi Konferencën Ndërkombëtare “Mësimdhënia e një gjuhe që përdoret dhe mësohet më pak: sfidat në Evropën shumëgjuhëshe”, në kuadrin e një projekti multilateral me pjesëmarrjen e 14 universiteteve partnere.

ATELJE PËR PËRKTHIMIN LETRAR

Atelier de traduction animé par Evelyne Noygues et Saverina Pasho “Les défis de la traduction littéraire – le cas de Mitrush Kuteli”, 25 nëntor 2022



